


**KOMITETI I HELSINKIT PËR TË
DREJTAT E NJERIUT NË SERBI**



**KOMUNITETI
SERB NË
KOSOVË**

KOMITETI I HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË SERBI
KOMUNITETI SERB NË KOSOVË

Hulumtimi dhe publikimi janë përkrahur financiarisht nga
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur



Mendimet, qendrimet dhe konkludimet e shprehura në këtë punim i takojnë Komitetit të Helsinkit dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur.

KOMITETI I HELSINKIT PËR TË
DREJTAT E NJERIUT NË SERBI



Komuniteti Serb në Kosovë

Qershor, 2012

PËRMBAJTJA

Disa fjalë rreth hulumtimit	7
Konkludimet dhe rekomandimet për komunitet ku zbatohet Planit i Ahtisaarit	9
Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror	9
Jeta shoqërore	10
Administrata lokale dhe zbatimi i Planit të Ahtisaarit dhe i ligjeve të tjera	11
Arsimi	11
Mediat	12
Sektori civil	12
Kisha Ortodokse Serbe	13
Komunitet paralele	13
Integritet evropian	14
Qëndrimi ndaj veriut të Kosovës	14
Konkludimet dhe rekomandimet për veriun e Kosovës	15
Konteksti i përgjithshëm dhe ndryshimet në Serbi	19
Marrëveshjet Beograd-Prishtinë	23
Komunitet serbe dhe vendbanimet më përbërje të përzier etnike në Kosovë	29
Komunitet e Klllokotit	29
Komunitet e Parteshit	33
Komunitet e Graçanicës	35
Komunitet e Pejës – Gorazhdëci	39
Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë	43
Komunitet e Istogut – Osojane	47
Komunitet e Shtërpçës	49
Komunitet e Rahovecit	53
Komunitet e Ranillgut	56
Komunitet e Novobërdës	60
Qëndrimi i Beogradit ndaj Veriut të Kosovës - keqpërdorimi i qytetarëve ..	65
Bisedat me banorët e veriut të Kosovës	71
SHTOJCAT	81
Ligji mbi arsimin në komunitet e Republikës së Kosovës	81
Ligji mbi Radio Televizionin e Kosovës	84

Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale	85
Ligji mbi Zonat e Veçanta të Mbrojtura.....	87
Plani i Ahtisaarit dhe të drejtat që burojnë nga ky plan	93
<i>Arsimimi në gjuhën serbe</i>	<i>93</i>
<i>Gjuha dhe identiteti serb</i>	<i>94</i>
<i>Trashëgimia fetare dhe kulturore</i>	<i>96</i>
<i>E drejta për të mbajtur dhe zhvilluar lidhje me Serbinë.....</i>	<i>97</i>
<i>Puna policore dhe komandantët lokalë të policisë.....</i>	<i>98</i>
<i>Pjesëmarrja e komunitetit serb në vendimmarrje.....</i>	<i>99</i>
<i>Të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit.....</i>	<i>102</i>
<i>Sistemi i drejtësisë.....</i>	<i>102</i>
<i>Personat e zhdukur</i>	<i>103</i>
Marrëveshjet Beograd - Prishtinë.....	105
Vulat doganore	105
Regjistri i kadastrave.....	105
Konkluzionet e arritura për Menaxhimin e Integruar të Kufijve	106
Librat Amzë	107
Liria e lëvizjes.....	108
Pranimi i diplomave universitare	109
Fotografitë	110



Disa fjalë rreth hulumtimit

Ekipi i Komitetit të Helsinkit ka zhvilluar një hulumtim mbi efektet e para të zbatimit të Planit të Ahtisaarit në përmirësimin e gjendjes së komunitetit serb në Kosovë. Bisedat me përfaqësues të administratës komunale dhe me sektorin civil janë zhvilluar gjatë disa vizitave njëditore në komunat e Rannillugut, Parteshit, Klllokotit, Novobërdës, Graçanicës dhe Shtërpces. Poashtu kemi vizituar Rahovecin dhe Gorazhdecin ku jeton një numër më i madh i serbëve por ku ata nuk përbëjnë shumicën e popullsisë.

Ekipi i Komitetit të Helsinkit ka vendosur që në hulumtim ta përfshijë edhe pjesën veriore të Mitrovicës pasi që përkundër veprimit dhe ndikimit të fuqishëm të strukturave paralele, në kohën kur po e përfundonim raportin filloi punën e saj administrata komunale e Mitrovicës Veriore në përputhje me Planin e Ahtisaarit. Hulumtimi u zhvillua gjatë periudhës janar - qershor 2012.

Konkludimet dhe rekomandimet e ofruara në hulumtim mbështeten në vizitat nëpër komuna si dhe në disa burime tjera të pavarura. Në një kapitull të veçantë kemi paraqitur fragmente nga bisedat me përfaqësues të administratës dhe shoqërisë civile në komunat e formuara sipas Planit të Ahtisaarit apo në vendbanime me popullsi kompakte serbe.

Hulumtimi u realizua falë përkrahjes nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur.



Konkludimet dhe rekomandimet për komunitet ku zbatohet Plan i Ahtisaarit

Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror

Në komunitet në jug të lumit Ibër, ku serbët përbëjnë popullsinë shumicë, është arritur përparim serioz në fushën e infrastrukturës dhe në përmirësimin e jetës së përditshme, para së gjithash si rezultat i integritetit të këtyre komunitet në institucionet e Kosovës, më konkretisht si rezultat i pranimet të Planit të Ahtisaarit. Ndër mangësitë më të theksuara në komunitet e reja është mosnjohuria e strategjive të qarta ekonomike-shoqërore për zhvillimin e këtyre komunitet. Hartimi i strategjive zhvillimore do të mund të joshite investime të cilat rrjedhimisht do të siguronin vende të punës dhe të ardhme më të mirë jo vetëm për këto komunitet por edhe tërë Kosovën.

Në komunitet e reja, para së gjithash në Kllokot, Partesh dhe Ranillug, janë realizuar projekte të rëndësishme infrastrukturore. Këto janë investimet e para në 40-50 vitet e fundit në infrastrukturën e fshatrave që përbëjnë këto komunitet. Investimet më të mëdha janë bërë në rrugë, kanalizime dhe ujësjellës. Pothuajse në të gjitha komunitet janë rindërtuar apo ndërtuar qendra bashkëkohore të kujdesit mjekësor. Në shumicën e komunitet janë hapur apo së shpejti do të hapen ndërtesat e reja të administratës.

Meqë kryesisht kemi të bëjmë me mjedise fshatare, problemi më i madh i banorëve është plasimi i produkteve bujqësore në tregun vendor si dhe eksportimi i tyre jashtë Kosovës.

Kriteri themelor për lidhjen në mes komunave duhet të jetë kriteri ekonomik dhe jo ai etnik. Komunitet me shumicë serbe duhet të kërkojnë partnerë ekonomik në komunat e tjera të Kosovës pa marr parasysh përbërjen e tyre etnike.

Vëmendje të veçantë kërkojnë komunat me përbërje shumëetnike. Përmirësimi i infrastrukturës në këto komuna nuk është aq i dukshëm sa edhe në komunat e krijuara rishtazi.

Në shumicën e komunave që kemi vizituar u konstatua që të rinjtë janë shtresa më e ndjeshme e popullsisë dhe se ata më së tepërmi bartin mbi supet e tyre gjendjen e rëndë ekonomike dhe mungesën e investimeve serioze në ekonomi. Niveli i papunësisë në mesin e të rinjve është shumë i lartë. Do të ishte mirë të zhvillohen hulumtime rreth nevojave të të rinjve dhe që rekomandimet e këtyre hulumtimeve të përfshihen në programet e ardhshme zhvillimore të komunave.

Jeta shoqërore

Lëvizja e banorëve serbë në Kosovë është përmirësuar dukshëm. Megjithatë, përkundër përmirësimit të dukshëm në integrimin e komunitetit serb në shoqërinë kosovare, nuk është arritur përparim serioz në planin kulturor dhe shoqëror, më konkretisht në komunikimin e përditshëm në mes të anëtarëve të dy komuniteteve, gjë që do t'i forconte lidhjet joformale dhe do të kontribuonte në stabilitetin dhe ndjenjen më të madhe të sigurisë në mesin e qytetarëve.

Të rinjtë nga të dy komunitetet nuk kanë pothuajse asnjë lidhje me njeri tjetrin. Duhet bërë përpjekje më të mëdha në projekte që sjellin ndërveprim më të madh shoqëror në mes pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme dhe ky sipas të gjitha gjasave do të jetë një proces i gjatë. Në këtë drejtim, do të mund të ofronin ndihmën e tyre organizatat e shoqërisë civile nga Kosova dhe Serbia. Në të kundërtën, komunitetet do të izoloohen edhe më tepër brenda vetes.

Administrata lokale dhe zbatimi i Planit të Ahtisaarit dhe i ligjeve të tjera

Pika më e ndjeshme e procesit të decentralizimit është riorganizimi i sistemit gjyqësor dhe themelimi i gjykatave themelore në nivelin komunal. Ankesat e ngritura nga përfaqësuesit komunal dhe shoqëria civile më së tepërmi kanë të bëjnë me themelimin e gjykatave themelore në komunat serbe. Në anën tjetër, ka ngecje të mëdha në zgjidhjen e kontesteve gjyqësore, para së gjithash atyre që kanë të bëjnë me marrëdhëniet pronësore-gjyqësore. Kjo situatë i prek të gjithë banorët njëjloj pa marr parasysh përkatësinë e tyre etnike.

Në shumicën e komunave, ka mungesë të kuadrove të arsimuara. Ky problem vjen posaçërisht në shprehje gjatë përzgjedhjes së komandantëve të policisë, të cilët shpeshherë nuk i përmbushen të gjitha kriteret e parapara me ligj. Kjo gjendje duhet marr patjetër parasysh gjatë emërimit të komandantit të policisë, në mënyrë që të gjinden zgjidhje të kompromisit që janë në interesin më të mirë të banorëve.

Në administratat e komunave serbe në Kosovë, numri i femrave në pozita të larta është jashtëzakonisht i vogël dhe vlen të ceket se asnjë femër nuk mban pozitën e kryetares së komunës në komunat në jug të lumit Ibër. (Kryetarja e parë e komunës është pikërisht Adrijana Hoxhiq e cila udhëheq me administratën e Mitrovicës Veriore). Në këtë drejtim, nevojitet shumë më tepër punë në përmirësimin e pozitës së femrës dhe në barazinë gjinore. Për më tepër, siç ka treguar edhe përvoja e 12 viteve të fundit, femrat janë shumë më të hapura për bashkëpunim dhe më të përkushtuara në ndërtimin e urave në mes të dy komuniteteve.

Edhe pse përdorimi i gjuhës amtare serbe është i garantuar me ligj, përfaqësuesit e komunitetit serb shpeshherë ankohen se ky ligj nuk po zbatohet mjaftueshëm.

Arsimi

Njëra ndër ankesat më të shpeshta të bashkëbiseduesve tonë ishte arsimimi i pamjaftueshëm cilësor në shkollat fillore dhe ato të mesme. Në mesin e mësimdhënësve ka edhe kuadro që nuk i përmbushin në tërësi kriteret e përgatitjes arsimore. Shkollat e mesme janë të stërngarkuara, pasi që disa shkolla të mesme dhe fillore duhet t'i zhvillojnë mësimet në një ndërtesën e njëjtë. Përveç përmirësimit të arsimit, gjatë krijimit të drejtimeve shkollore duhet t'i kushtohet më tepër vëmendje edhe nevojave të mjediseve lokale.

Mediat

Kanali i dytë i Radio Televizionit të Kosovës në gjuhën serbe duhet të filloj me punë sa më shpejt që të jetë e mundur. Ky kanal është i nevojshëm sepse banorët serbë nuk janë të informuar mbi aktivitetet e institucioneve kosovare e as mbi zhvillimet më të rëndësishme për kontekstin më të gjerë në Kosovë. Ata nuk mund t'i marrin këto informata nga mediat serbe me seli në Beograd. Në anën tjetër, meqë komuniteti serb nuk është tërësisht i kënaqur me zgjidhjen ligjore dhe ka dyshime serioze rreth objektivitetit të këtij kanali, puna e tij duhet të jetë sa më transparente dhe duhet të forcohen mekanizmat që do ta parandalonin keqpërdorimin e interesit publik.

Në rastin e mediave të shtypura, banorët serbë të Kosovës informohen në gjuhën amtare vetëm nga gazetatat ditore që botohen në Beograd dhe vetëm atëherë kur kanë qasje në këto gazeta. Disa komuna që i kemi vizituar e kanë shumë të vështirë të sigurojnë kopje të këtyre gazetave. Gjendja është diç më e mirë me mediat elektronike, ku pothuajse çdo komunë e ka radio stacionin e në disa raste edhe televizionin e saj.

Meqenëse banorët serb në jug të lumit Ibër, në masë të konsiderueshme frikësohen për shkak të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës, më konkretisht rreth asaj se a do të zbatohen edhe pas kësaj periudhe ligjet për pozitën e komunitetit serb, mediat lokale duhet të angazhohen sa më tepër në informimin e banorëve mbi zbatimin e ligjeve kosovare dhe mbi mekanizmat ekzistues për përmbushjen e të drejtave të komuniteteve.

Sektori civil

Nevoja për hartimin e programeve të shoqërisë civile të cilat do të përfshinin numër sa më të madh të të rinjve është më se e dukshme. Pothuajse në të gjitha komunat u veçua nevoja për lidhjen e të rinjve nga komunitetet e ndryshme dhe me përkatësi të ndryshme etnike. Megjithatë, pengesat ndaj këtyre programeve shpeshherë vijnë madje edhe nga vet prindërit të cilët bartin tek gjeneratat e reja paragjykime mbi pjesëtarët e komuniteteve të tjera, para së gjithash të komunitetit shqiptar. Bashkësia ndërkombëtare do të duhej të përkrahte më tepër punën me të rinjtë si dhe organizimin e shkollave dhe seminareve alternative të cilat iu ndihmojnë të rinjve t'i tejkalojnë paragjykimet dhe të kqen në shoqëri bashkëkohore.

Puna me të rinjtë në zhvillimin e këtyre programeve paraqet themelin për ndërtimin e shoqërisë multietnike, multikulturore mbi baza të reja.

E lidhur ngushtë me këtë çështje është edhe zhvillimi i institucioneve të kulturës të cilat më së tepërmi janë lënë prapa. Të rinjtë e kalojnë kohën e tyre të lirë kryesisht nëpër kafeteri. Asnjëra prej komunave të reja nuk ka kinema, ndërsa qendrat e kulturës ose janë në gjendje të mjerueshme ose nuk punojnë fare. Njëra ndër mangësitë më serioze është mungesa e hapësirave për aktivitete jashtëshkollore për nxënës të shkollave fillore dhe të mesme.

Kisha Ortodokse Serbe

Disa pjesë të Kishës Ortodokse Serbe, e cila është faktori me ndikimin më të madh në komunitetin serb në Kosovë, kanë qëndrime mjaft të moderuara dhe kërkojnë që mosmarrëveshjet të zgjidhen nëpërmjet kompromisit. Një pjesë e klerit nuk sheh dobi nga ndarja e serbëve në “tradhëtarë” dhe “patriotë” dhe e kundërshton idenë për ndarjen e Kosovës.

Kompromiset janë të nevojshme edhe në rastin e ndërtimit të objekteve afariste, rrugëve dhe zonave rekreative, në afërsi të manastireve dhe kishave të cilat janë nën Ligjin mbi Zonat e Veçanta të Mbrojtura.

Komunat paralele

Roli i administratës së komunave paralele është kryesisht në ofrimin e shërbimeve për banorët në rastin e ndihmës gjatë marrjes së dokumenteve të Serbisë (regjistrat civil, arkivi), marrja e pagave, pensione dhe ndihmave sociale nga buxheti i Serbisë. Meqenëse një numër i madh i banorëve të Kosovës marrin paga nga buxheti i Serbisë (këtu kemi të bëjmë me numrin e madh të nëpunësve të cilët dikur kishin punuar në institucionet dhe firmat e Serbisë), ndërprerja e këtyre të ardhurave do të mund të shkaktonte trazira sociale. Zgjidhja e këtij problemi do të duhej të kërkohej në një kompromis i cili do të merrte parasysh që këto të ardhura të jenë transparente, para së gjithash në sigurimin e dëshmive për pagimin e tatimit.

Një zgjidhje alternative për ata që marrin paga nga buxheti i Serbisë për kryerjen e punëve në sektorin publik, do të mund të ishte punësimi i një pjese të tyre në sektorin publik të Kosovës.

Integrimet evropiane

Integrimet evropiane janë njëloj të rëndësishme për të gjithë banorët e Kosovës. Nisja e procesit të anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian ofron garanci më të forta për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe të drejtave të komuniteteve pakicë. Në këtë drejtim, integrimet evropiane janë jashtëzakonisht të rëndësishme edhe për komunitetin serb. Mungesa e shtetit ligjor në veri të Kosovës është njëra ndër pengesat kryesore në rrugën drejt integriteteve evropiane, jo vetëm për qytetarët e Kosovës por edhe për Serbinë.

Liberalizimi i vizave dhe futja e Kosovës në zonën Shengen do të ishte motivim i mirë edhe për serbët e Kosovës që t'i pranojnë dokumentat, letërnjoftimet dhe pasaportat e Republikës së Kosovës.

Për Qeverinë e Kosovës, rruga drejt integriteteve evropiane duhet të përfshij në vete zbatimin e të gjitha ligjeve që garantojnë të drejtat e pakicave, para së gjithash zbatimin e pakos së Ahtisaarit, si dhe rezultatet e prekshme në përmirësimin e pozitës së pakicave.

Qëndrimi ndaj veriut të Kosovës

Komuniteti serb në jug të lumit Ibër kryesisht e miraton dhe përkrah themelimin e administratës së Mitrovicës Veriore, që mund të jetë edhe përkrahje e rëndësishme për forcat e moderuara në veri dhe për normalizimin e jetës atje. Ulja e tensioneve dhe sundimi i ligjit në veri janë shumë të rëndësishme edhe për serbët në jug të lumit Ibër, meqenëse në Mitrovicë ndodhen qendra kryesore universitare dhe qendra spitalore.



Konkludimet dhe rekomandimet për veriun e Kosovës

Faktori kyç që e pengon normalizimin e gjendjes në veri dhe integrimin në sistemin gjyqësor të Kosovës është krimi i organizuar, i cili para së gjithash mbështetet në tregtinë ilegale që ka strehë të fuqishme në pjesën veriore të Mitrovicës. Kjo u vërejt më së tepërmi gjatë “revolucionit të drunjve” i cili filloi në verë të vitit 2011. Politikanët lokal dhe partnerët e tyre në Beograd, por edhe në Prishtinë, fuqinë e tyre shoqërore dhe politike e mbështesin pikërisht në lidhjet me krimin organizuar. Beogradi dhe Prishtina zyrtare duhet të punojnë drejt shpërbërjes së këtyre lidhjeve.

Zbatimi i sundimit të ligjit në veri të Kosovës është faktor kyç për stabilizimin e tërë rajonit.

Në vend të institucioneve paralele në veri duhet të zbatohen mekanizmat ekzistues që i garantojnë komunitetit serb të drejta në ruajtjen e identitetit dhe në zhvillimin e mëtutjeshëm të komunitetit të tyre. Përkrahja e fuqishme dhe e paluajtur e Prishtinës dhe Beogradit për zyrën administrative në veri të Mitrovicës të udhëhequr nga Adriana Hoxhiq është tejet e rëndësishme për normalizimin e gjendjes në këtë pjesë të Kosovës.

Me qëllim të zbatimit të sundimit të ligjit duhet të formohen sa më parë të jetë e mundur organet gjyqësore.

Puna e Policisë së Kosovës në veri të vendit bazohet kryesisht në regjistrimin e veprave penale. Megjithatë, shumë pak punohet në hetimin dhe zbulimin e dorasve të këtyre veprave. Këtë në masë të madhe e kushtëzohen

gjendja politike rreth veriut të Kosovës. Kjo gjendje duhet të ndryshohet sa më shpejt të jetë e mundur dhe Policia e Kosovës duhet të përfshihet më fuqishëm në zgjidhjen e veprave penale në veri. Duhet bërë çdo gjë që është e mundur për t'i mbrojtur përfaqësuesit e moderuar të serbëve të Kosovës të cilët vazhdimisht marrin kërcënime e madje janë edhe cak i sulmeve nga grupet radikale.

Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me përfaqësuesit e veriut të Kosovës që janë të gatshëm të kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit të tyre siç është rasti i zyres administrative të Mitrovicës Veriore, duhet të hartoj një plan ekonomik për veriun e Kosovës. Ky hap njëkohësisht do të kishte ndikim të fuqishëm në uljen e tensioneve.

Banorët e veriut të Kosovës frikësohen se do t'i humbin të ardhurat e tyre në qoftë se shuhen institucionet paralele që veprojnë në Kosovë. Në këtë drejtim, banorëve duhet t'iu sqarohet mirë se cila është zgjidhja alternative. Njëra prej mundësive është hapja e vendeve të punës në sektorin e ri publik. Kushti i vetëm për vazhdimin e ndihmës financiare nga Qeveria e Serbisë është transparenca dhe pagimi i tatimeve.

Disa institucione që nuk janë nën kontrollin e Qeverisë në Prishtinë, siç është Universiteti dhe Qendra Spitalore në Mitrovicën Veriore, shumë lehtë mund të bëhen legjitime dhe të gëzojnë shkallë të lartë të autonomisë.

Hulumtimet e pavarura tregojnë që banorët e veriut të Kosovës janë tejet pak të informuar për kornizën ligjore që lidhet me komunitetin serb. Në mesin e banorëve dominojnë stereotipe të forta rreth gjendjes aktuale në Kosovë, perspektivës së saj dhe bashkëkombasve shqiptarë.

Është edhe në interesin e banorëve të Serbisë dhe të Kosovës që Beogradi zyrtar t'i jap fund politikës e cila si prioritet ka territoret e vendeve fqinje dhe të mos i shfrytëzoj më institucionet paralele në Kosovë për qëllimet e veta politike. Beogradi zyrtar në disa raste gjatë dy dekadave të fundit i ka sakrifikuar serbët që jetojnë jashtë Serbisë. Gjatë marrjes së vendimeve përfundimtare, banorët e veriut të Kosovës do të duhej të merrnin parasysh këtë politikë të Beogradit pa marr parasysh se cilat parti janë në pushtet në Serbi.

Në vend të financimit të administratës paralele në Kosovë dhe punëtorët e ndërmarrjeve fiktive që nuk punojnë më, Qeveria e Serbisë do të duhej ta ndihmonte realizimin e projekteve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në veri të Kosovës dhe ta fuqizoj potencialin ndërmarrës të banorëve. Në plan afatgjatë, kjo do të ishte shumë e rëndësishme për stabilitetin e rajonit.

Arrestimet e qytetarëve serbë nuk duhet të përdoren për qëllime politike dhe secili rast duhet të trajtohet në mënyrë të veçantë. Duke u nisur nga supozimi se në mesin e të arrestuarve ka edhe persona të pafajshëm, kriminelët dhe njerëzit që i përkrahin ata nuk duhet të fshihen prapa njerëzve që mund të jenë arrestuar gabimisht.

Përvojat e kaluara tregojnë që qytetet e ndara nuk ofrojnë mirëqenie për banorët e asnjërës palë, nëse nuk zhvillohen procese të integritetit dhe nëse nuk ka lëvizje të lirë të njerëzve dhe të mallrave. Në këtë drejtim, duhet përkrahur programet që i lidhin para së gjithash të rinjtë nga të dyja anët e urës në Mitrovicë.



Konteksti i përgjithshëm dhe ndryshimet në Serbi

Në shtator të vitit 2012 përfundon mandati i Zyres Civile Ndërkombëtare në Kosovë (ZCN) e me këtë edhe periudha e pavarësisë së mbikëqyrur. Institucionet e Kosovës tash do të kenë mbi vete përgjegjësi si asnjëherë më parë. Në qershor të vitit 2012, ka filluar verifikimi i përgjigjeve të cilat Qeveria e Kosovës i ka dhënë në pyetësorin e Komisionit Evropian për përgatitjen e studimit të fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit me BE-në. Në kontekstin e përgjithshëm, duhet përmendur që për herë të parë në 30 vitet e fundit, janë arritur disa marrëveshje në marrëdhëniet serbo-shqiptare. Edhe pse në prezencën e ndërmjetësuesit ndërkombëtar, marrëveshjet janë arritur nëpërmjet bisedimeve të drejtpërdrejta në mes Beogradit dhe Prishtinës¹.

Në anën tjetër, sfida më e madhe për zhvillimin e bashkëpunimit racional, që është hapi i parë në rrugën drejt Bashkimit Evropian, janë rezultatet e zgjedhjeve në Serbi dhe opsionet dukshëm të dobësuar pro-evropiane². Edhe pse Partia Socialiste e Serbisë (SPS) dhe Partia Progresive Serbe (SNS), të cilat do ta formojnë qeverinë e re bashkë me përfaqësuesit e Rajoneve të Bashkuara

-
- 1 Bisedimet u intensifikuan tek në periudhën dhjetor 2011 - mars 2012 (me arritjen e rezultateve të para serioze) - në kohën kur Serbia u gjet para presionit të fuqishëm që ta dëshmonte edhe në praktikë gatishmërinë e saj për statusin e kandidatit në Bashkimin Evropian. Kështu vazhdimi i dialogut u arrit falë presioneve të bashkësisë ndërkombëtare, meqenëse për Partinë Demokratike ishte e rëndësishme ta merrte statusin e kandidatit para zgjedhjeve.
 - 2 Partia Socialiste e Serbisë ka fituar dy herë më tepër vota në krahasim me zgjedhjet e kaluara (15 përqind), derisa President i Serbisë u zgjodh Tomislav Nikoliq, udhëheqës i Partisë Përparimtare Serbe, parti kjo konservative dhe populiste.

të Serbisë (URS), nuk janë deklarativisht kundër Bashkimit Evropian, përkushtimi i tyre për integrimin evropian të Serbisë tingëllon tejet jobindës. Të dyja partitë gjatë viteve 1990 kanë pasur vlera dhe politika anti-evropiane, dhe të dyja partitë kanë pasur rol kyç në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë. Kjo është arsyeja kryesore prapa dyshimit që këto dy parti do të vendosin për bashkëpunim rajonal dhe përfundimisht do t'i pranojnë realitetet dhe kufijtë e rinj në rajon.

Asnjëra parti, më konkretisht udhëheqësit e tyre aktual, Ivica Daçiq dhe Tomislav Nikoliq³, nuk kanë folur për politikën shkatërruese të Partisë Socialiste të Serbisë dhe Partisë Radikale Serbe gjatë viteve 1990. Ivica Daçiq i fitoi zgjedhjet në sajë të radikalizimit të politikës ndaj Kosovës – duke qenë i parë që e bëri publike idenë për ndarjen e Kosovës. Të dy partitë janë nën ndikimin e fuqishëm të forcave konservative në Serbi si dhe nën ndikimin e Rusisë e cila nuk dëshiron ta shohë Serbinë në Bashkimin Evropian, e posaçërisht jo në NATO. Përveç kësaj, këto parti me zgjedhjet e tyre të kuadrove do t'i japin goditje të fortë administratës.

Partia Socialiste e Serbisë, që një vit e gjysëm, në veçanti e ka radikalizuar qëndrimin e saj ndaj Kosovës⁴. Ivica Daçiq, lider i Partisë Socialiste të Serbisë, e kushtëzoi krijimin e qeverisë së re në verë të vitit 2012, duke u thirrur pikërisht në politikën ndaj Kosovës. Në fillim, ai kërkoi që përfshirja e Partisë Liberale Demokratike në qeveri të kushtëzohet me ndryshimin e politikës së saj ndaj Kosovës, dhe pastaj haptazi e kundërshtoi hapjen e zyres së Prishtinës në Beograd dhe zyres së Beogradit në Prishtinë. Ai kërkoi që Partia Demokratike (DS) dhe Partia Progresive Serbe të deklarohen kundër kësaj zyreje dhe e kushtëzoi hyrjen e tij në qeveri me cilëndo parti që do të pranonte diçka të tillë. Daçiq ishte poashtu i pari që në pranverë të vitit 2011 propozoi ndarjen e Kosovës në mes Serbisë dhe Shqipërisë. Ndarja e Kosovës nuk është ide vetëm e Ivica Daçiqit dhe SPS-së, sepse këtu bëhet fjalë për një plan në të cilin elita

3 Presidenti i Serbisë Tomislav Nikoliq, gjatë viteve 1990, ishte nënkryetar i Partisë ultranacionaliste Radikale Serbe, e cila kishte grupacionet e saj paramilitare në fushëbetejë dhe njëhej për deklaratat e saj shoviniste dhe ksenofobike kundër pakicave dhe opozitës.

4 Daçiq, si ministër i policisë gjatë fushatës parazgjedhore, haptazi mbronte arrestimin e shqiptarëve të Kosovës që hynin në Serbi si dhe arrestimin e shqiptarëve nga jugu i Serbisë. Mbrojtësit e drejtave të njeriut brengoseshin me faktin që dy banorë të Kosovës u arrestuan pas deklaratës së Ministrit Daçiq që bëhet fjalë për “masa të reciprocitetit për arrestimin e policëve serb në Kosovë”. Poashtu brengosës ishte arrestimi i Hasan Abazit nga Kosova në bazë të fletëarrestit për spiunazh të lëshuar në vitin 1999. Ky ishte fletëarrest nga koha e Slllobodan Millosheviqit kur aktakuzat kundër shqiptarëve të Kosovës ngriteshin mbi baza politike. Pas 5 tetorit të vitit 2000, rreth 2.000 shqiptarë të Kosovës u liruan nga burgjet serbe. Dy ditë para zgjedhjeve, në Bujanoc u arrestuan pesë shqiptarë nën akuzën e kryerjes së krimeve të luftës. Megjithatë, ata u liruan më vonë sepse u morr vesh që ata ishin amnistuar në vitin 2001 si pjesë e marrëveshjes për zgjidhjen e krizës në jug të Serbisë. Këto arrestime vënë në pikëpyetje amnistinë që krijon pasiguri në mesin e qytetarëve.

serbe, përfshirë edhe disa pjesë të Partisë Demokratike, insistojnë që nga vitet 1990, por nuk e përmendin atë publikisht për shkak të qëndrimit mospërkrahës të bashkësisë ndërkombëtare⁵. Realiteti aktual në Kosovë, ndarja e serbëve në jug dhe veri të lumit Ibër, si dhe mungesa e sundimit të ligjit në veri të Kosovës, janë pasoja të politikës për “ndarjen e Kosovës” dhe i pritjes së momentit të duhur për ta zbatuar këtë politikë. Poashtu është dëshmuar që tensioni i vazhdueshëm në mes serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë po shndërrohet në konflikt të ngrirë dhe që kjo gjendje në planin afatgjatë paraqet rreziqe të mëdha.

Përkundër obstrukcioneve të Beogradit i cili manipulon me serbët e Kosovës, në dhjetë vitet e fundit janë arritur suksese të dukshme në përmirësimin e pozicionit të komunitetit serb në Kosovë. Sot, 12 vite pas përfundimit të konfliktit, komuniteti serb në Kosovë gëzon nivelin më të lartë të drejtave të pakicave në rajon. Plani i Ahtisaarit përmban kornizën për zbatimin e këtyre të drejtave (plani gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës) i cili filloi të zbatohet në fund të vitit 2008⁶ dhe është i integruar në Kushtetutën e Kosovës. Ky plan i garanton komunitetit serb në Kosovë autorizime më të mëdha në krahasim me çdo marrëveshje tjetër në rajon për të drejtat e pakicave⁷.

Serbët në masë të madhe marrin pjesë në qeveritë komunale në Ranilug, Klllokot, Partesh, Graçanicë, Shtërpce, që paraqet 20 përqind të vetëqeverisjeve lokale. Në komunën e Novobërdës, kryetari është shqiptar ndërsa shumica e këshilltarëve komunal janë serbë. Edhe në Kuvendin e Kosovës ka ulëse të rezervuara për pjesëtarët e komunitetit serb.

Përveç Planit të Ahtisaarit, komunitetet pakicë në Kosovë i zbatojnë të drejtat e tyre edhe nëpërmjet Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale. Ky ligj megjithatë nuk zbatohet me efikasitet të duhur dhe i përfshin të gjitha komunat pa marr parasysh përbërjen e tyre etnike.

Partia Demokratike po tregon shënja të qarta të ndryshimit të politikës ndaj veriut të Kosovës. Ish-kryetari i Serbisë dhe udhëheqësi i Partisë Demokratike, Boris Tadiq, iu kundërshtoi seriozisht serbëve të Kosovës në

5 Mbi zhvillimin e idesë për ndarjen e Kosovës gjatë një viti e gjysëm të kaluar mund të lexoni më tepër në raportin vjetor të Komitetit të Helsinkit për vitin 2011: “Pengimi i rrugës evropiane” në uebfaqen: www.helsinki.org.rs.

6 Blic <http://www.blic.rs/Vesti/Politika/71784/Euleks-poceo-da-sprovodi-plan-Martija-Ahtisarija>.

7 Në Kosovë për shembull përdorimi i gjuhës amtare është i garantuar në të gjitha nivelet, derisa në Maqedoni për shembull sipas Marrëveshjes së Ohrit kjo është e garantuar vetëm në nivelin lokal. Në Maqedoni, kryetari i komunës nuk e emëron komandantin e stacionit policor, derisa në Kosovë ai e bën këtë. Sipas Planit të Ahtisaarit, Serbia mund t’i ndihmoj financiarisht serbët në Kosovë, derisa shteti amë i Shqipërisë nuk mund t’iu ndihmoj shqiptarëve në Maqedoni.

mars të vitit 2012, kur tha se ata duhet të tërhiqen nga barrikadat. Edhe pse kjo lëvizje ishte bërë për hir të marrjes së dritës së gjelbër për statusin e kandidatit për BE, për disa ditë kjo ndikoi në uljen e tensioneve. Gjendja në veriun e Kosovës më së miri tregoi që Beogradi zyrtar është peng i strukturave paralele në pushtet në veri të Kosovës, të cilat i kishte krijuar vet dhe përkrahur për më tepër se një dekadë.

Duke marr parasysh lidhjen e ngushtë me kriminalitetin i cili praktikisht udhëheq në këtë pjesë, shpërbërja e strukturave paralele nuk do të jetë proces i thjeshtë sepse ato nuk do të heqin dorë lehtë prej përfitimeve që kanë nga gjendja jolegale, kontrabanda dhe korrupsioni.

Shenja të ndryshimeve mund të gjejmë edhe në porosinë e Borko Stevanoviqit, kryesuesit të ekipit negociator të Beogradit, drejtuar Tomisllav Nikolliqit pas inaugurimit të këtij të fundit në postin e Presidentit të Serbisë. Porosia e Stefanoviqit ishte e drejtuar edhe për serbët e Kosovës.

Në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, Stefanoviq tha se duhet të merret parasysh realiteti i ri në lidhje me Kosovën dhe se kthimi në gjendjen para vitit 1999 apo madje edhe 1996 është i pamundur: *“Gabohen rëndë ata që mendojnë se ky është proces nëpërmjet të cilit ne mund të arrijmë zgjidhje që i kemi pasur deri në vitin 1999. Kjo për shkak se UNMIK-u i ka bartur të gjitha kompetencat në duart e autoriteteve kosovare gjatë kohës së qeverisë së Vojislav Koshtunicës. Në kohën e qeverisjes së tyre, Kosova e shpalli pavarësinë e saj (...) Më vjen keq që në Kosovë janë disa serbë që mendojnë se është e mundur të kthehemi në vitet 1996, 1997. I keni udhëheqësit në veri të Kosovës të cilët çdo ditë i lëshojnë alarmet, i bëjnë thirrje popullit të mblidhet, që të dëgjojnë për kushedi të satën herë deklaratat e Marko Jashkshiqit, në vend se të përpiqen që të bëjnë diçka. Sepse keni institucione plotësisht të rrënuara në veri të Kosovës, infrastrukturë të shkatërruar, shërbime të rrënuara komunale. Asgjë nuk funksionon, individët pasurohen, njerëzit që kanë tri, katër banesa në Beograd e Kralëvë lajmërohen për ndihmë sociale dhe marrin drunj dhe ndihma ushqimore nga strukturat komunale. Ky është veriu i Kosovës sot dhe kjo është gjendja të cilën ata zotërinj e fshehin nga publiku. Pastaj thonë që çdo marrëveshje me Prishtinën është e papranueshme. Kjo është e kuptueshme sepse ata dëshirojnë me çdo kusht t'i ruajnë pozitat e tyre dhe privilegjet e fituara nga kriminaliteti. Ata dëshirojnë ta ruajnë këtë sistem plotësisht të rrënuar sepse kështu iu konvenon, derisa në anën tjetër banorët vuajnë më së tepërmi. Ata janë përgjegjës për gjendjen aktuale dhe kjo duhet të thuhet haptazi në mënyrë që njerëzit ta kuptojnë të vërtetën”*⁸.

8 Radio Evropa e Lirë: <http://www.slobodnaevropa.org/content/stefanovic-nema-vracanja-u-devedesete>.



Marrëveshjet Beograd-Prishtinë

Beogradi dhe Prishtina, gjatë një viti (mars 2011 - mars 2012) kanë arritur shtatë marrëveshje. (Janë arritur marrëveshjet për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal, vulat doganore, kadastrën, librat e amzës, lirinë e lëvizjes, diplomat universitare dhe vendkalimet e integruara kufitare). Zbatimi i këtyre marrëveshjeve do të ndikoj jo vetëm në përmirësimin e marrëdhënieve Beograd-Prishtinë por edhe në jetën e përditshme të qytetarëve.

Megjithatë, për shumicën e marrëveshjeve të botuara në uebfaqen e Qeverisë së Serbisë, nuk saktësohet se duhet të filloj zbatimi i tyre, por vetëm nënkuptohet se kur duhet të filloj zbatimi. Pala kosovare, në anën tjetër, pohon që ekziston korniza e saktë kohore për zbatimin e këtyre marrëveshjeve (*bisedë e përfaqësuesve të Komitetit të Helsinkit me anëtarët e ekipit negociator të Prishtinës).

Më 14 qershor, Kosova mori Udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave.⁹ Futja e Kosovës në sistemin e shengenit të bardhë do të ishte motiv i mirë për serbët e Kosovës që të pajisen me dokumente të udhëtimit të Kosovës. Qytetarët e Kosovës, përfshirë këtu edhe serbët, si banorë të vendit të vetëm në rajon që nuk gëzon liberalizim të vizave, kanë pasur arsye të forta të pajisen me pasaporta të vendeve të tjera, për të udhëtuar më lehtë në vendet e Bashkimit Evropian. Përveç kësaj, njëri prej kushteve për liberalizim të vizave për Kosovën është zbatimi i plotë i marrëveshjes për librat amzë.

9 EurAktiv <http://www.euractiv.rs/srbija-i-eu/4238-kosovo-dobilo-uputstva-za-viznu-liberalizaciju..html>.

Marrëveshja për tabelat e regjistrimit është dashur të zbatohet plotësisht deri më 15 qershor 2012¹⁰, më konkretisht deri në atë datë të gjithë banorët e Kosovës është dashur t'i zëvendësojnë tabelat e vjetra me ato të reja. Për dallim nga serbët në jug të lumit Ibër, shumica e të cilëve i kanë ndërruar tabelat, banorët serb në veri të Kosovës refuzojnë ta bëjnë këtë. Kjo ka shkak-tuar reagime nga Policia e Kosovës e cila ka filluar t'i trajtoj këto makina si të paregjistruara dhe ka filluar të zbatoj masa në këtë drejtim. Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Bajram Rexhepi, ka deklaruar se ka vendosur ta shtyj deri më 1 shtator 2012 afatin për ndërrimin e tabelave të regjistrimit të lësh-uara nga MUP-i serb në Kosovë¹¹.

Megjithatë, ajo që i prek qytetarët në të dyja anët e kufirit, përfshirë këtu edhe shqiptarët në jug të Serbisë (Lugina e Preshevës) që e kalojnë kufirin çdo ditë, është pjesa e marrëveshjes që ka të bëjë me pagimin e taksës për sigurim të automjetit. Taksa dyjavore për një automjet kushton 60-70 euro dhe kjo është ngarkesë tejet e madhe për shumicën dërrmuese të qytetarëve. Një zgjidhje e mundshme për tejkalimin e këtij problemi është marrëveshja për pranimin e kartonit të gjelbër i cili ofron qasje në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian. Sipas burimeve të Komitetit të Helsinkit, pala serbe e kundërshton këtë lloj të kompromisit.

Ministri i Brendshëm i Kosovës, Bajram Rexhepi, ka deklaruar që Serbia ka insistuar në këtë zgjidhje. Këto masa financiare posaçërisht i prekin banorët serbë të Kosovës meqenëse ata shumicën e punëve i kanë në Serbi dhe shpesh e kalojnë kufirin (Këto masa i prekin edhe shqiptarët nga jugu i Serbisë të cilët punojnë në Kosovë).

Pronarët e regjistrimeve RKS i kanë ndërruar tabelat në kufi me Serbinë. Atyre iu është mundësuar që në vendkalimet kufitare të paguajnë 3000 dinarë (rreth 30 euro) për një ditë dhe t'i marrin tabelat e përkohshme të cilat sipas fjalëve të ministrit Ivica Daçiq e konfirmojnë statusin neutral të Kosovës. Pronarët e këtyre tabelave paguajnë 400 dinarë (rreth 4 euro) për sigurim në ditë.

Marrëveshja për lirinë e lëvizjes ka filluar të zbatohet në fund të dhjetorit 2011 prej kur qytetarët e Kosovës mund të hyjnë në Serbi me dokumente personale (letërnjoftime të Kosovës)¹².

10 RTS <http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/Politika/1118946/Rampa+za+stare+tablice+15.+juna%3F.html>

11 Po aty.

12 Qeveria e Serbisë, më 22 dhjetor 2011, miratoi Udhëzimin për zbatimin e marrëveshjes për liri të lëvizjes. Ky udhëzim thotë që personat nga Kosova të pajisur me dokumente të lëshuara nga autoritetet e përkohshme në krahinë mund të lëvizin me letërnjoftime në territorin e pjesës qendrore të Serbisë, në vendkalimet administra-

Zbatimi i marrëveshjes për liri të lëvizjes ka rënë nën hijen e arrestimeve të shqiptarëve të Kosovës në bazë të fletëarrestimeve të lëshuara gjatë viteve 1990. Në mesin e të arrestuarve, në mars të vitit 2012, ishte edhe kryetari i Sindikatës së Pavarur të Metalurgëve të Kosovës, Hasan Abazi, i cili ngarkohet me spiunazh sipas aktakuzës së vitit 1999. Fletëarrestimet e viteve 1990 janë problematike sepse janë lëshuar nga policia në kohën e Sllobodan Millosheviqit ekskluzivisht mbi baza politike. Pas ndryshimeve të 5 tetorit, u amnistuan rreth 5000 të burgosur shqiptarë që gjendeshin në burgjet serbe.

Në Bruksel u arrit edhe marrëveshja sipas së cilës autoritetet në Serbi do t'iu dorëzojnë autoriteteve kosovare kopjet e librave amzë gjë që do të duhej t'iu lehtësonte shumë qytetarëve kosovar nxjerrjen e dokumenteve personale. Në disa qytete megjithatë ende nuk ka filluar përpunimi i librave amzë të marra nga komunat kosovare. Në Kragujevc, zyrtarët e sektorit për punë të përgjithshme, ku edhe gjenden librat amzë nga Peja, Istogu dhe Klina, i kanë thënë Radios Evropa e Lirë se po presin udhëzime nga Ministria për Vetëqeverisje Lokale për fillimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave nga librat amzë të tri komunave të Kosovës të cilat që nga viti 2000 gjenden në Kragujevc¹³. Në Qeverinë e Serbisë thonë se nuk mund t'iu japin udhëzime të gjitha qyteteve njëkohësisht dhe që ky proces do të zhvillohet gradualisht. Zëdhënësi i qeverisë në largim të Serbisë, Millivoje Mihajloviq, ka mohuar se Ministria për vetëqeverisje lokale e ka kundërshtuar udhëzimin e Qeverisë dhe shton se ky udhëzim do të zbatohet¹⁴.

Marrëveshja për dorëzimin tek Qeveria e Kosovës e kopjeve të kadas-trës të cilat autoritetet serbe i morën nga Kosova në Serbi në vitin 1999, u arrit në shtator të vitit 2011, por zbatimi i marrëveshjes filloi të shqyrtohej tek në janar të vitit 2012. Atëherë filloi edhe skenimi i librave të kadas-trës. Zyra e kryenegociatorit serb Borisllav Stefanoviq i tha portalit SETimes që zbatimi i marrëveshjes i ndihmon Beogradit që për herë të parë nga viti 1999 të ketë rol në proceset gjyqësore në Kosovë që kanë të bëjnë me pronën. "Kjo marrëveshje i mundëson Serbisë të ketë rol aktiv në zgjidhjen e kontesteve pronësore dhe iu ndihmon qytetarëve tonë të kenë më tepër gjasa për ta kthyer pronën e tyre," u përgjigjen zyrtarë nga kjo zyre¹⁵.

tive të pajisen me dokumentacion për hyrje dhe dalje nga Serbia; Radio Evropa e Lirë, 23 dhjetor 2011.

13 Radio Evropa e Lirë, 23. dhjetor 2011.

14 Radio Evropa e Lirë, 23. dhjetor 2011.

15 <http://www.naslovi.net/2011-09-28/rts/prelazi-van-dnevnog-reda/2839592>.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, disa qytetarë të Kosovës është dashur të shkojnë në Serbi dhe të paguajnë shuma të mëdha parash për tu pajisur me dokumentacion origjinal pa ndonjë garanci se po pajisen me dokumentin e duhur. Drejtori i Agjencionit Kadastral të Kosovës, Murat Meha, thotë se problem tjetër paraqesin parcelat e tokës të cilat shiten në mënyrë joformale apo që janë të regjistruara vetëm me shkrim. Ai poashtu shton që kthimi i librave të kadastrës do t'iu mundësoj qytetarëve të japin përgjigje në kërkesa në të cilat nuk kanë mundur të reagojnë për shkak të mungesës së dokumenteve origjinale¹⁶.

Marrëveshja për vulat doganore u arrit në shtator me ç'rast palët u morën vesh që në dokument të figuroj vetëm "Dogana e Kosovës" pa asnjë shenjë tjetër, dhe që kontrollin doganor ta kryejnë autoritetet kosovare¹⁷. Pranimi i vulave me nënshkrimin "Dogana e Kosovës" ka rezultuar edhe në largimin e embargove tregtare nga të dyja palët. (Kosova në qershor ka shpallur embargo ndaj importit të mallrave nga Serbia. Për një kohë të gjatë ka qenë në fuqi edhe embargoja e Serbisë ndaj mallrave kosovare).

Edhe pse të dyja palët arritën marrëveshjen për pranimin e ndërsjellë të diplomave universitare, kjo marrëveshje nuk u zbatua në Serbi as në fillim të vitit 2012. Qeveria e Serbisë duhej të lëshonte një udhëzim për pranimin e diplomave kosovare. Parashihej që diplomat e lëshuara në Serbi dhe në Kosovë do të verifikohen nga Asociacioni Evropian i Universiteteve. Kryesuesja e ekipit negociator të Prishtinës në bisedime me Beogradin, Edita Tahiri, tha në janar të vitit 2012 që gjatë atij muaji do të fillonte procedura e lëshimit të diplomave në Kosovë. Ajo shtoi që kjo marrëveshje do të mundësonte njohjen e diplomave të studentëve që kishin përfunduar studimet në të gjitha universitetet në territorin e Kosovës, që përfshin edhe universitetin e Mitrovicës Veriore¹⁸. Moszbatimi i kësaj marrëveshjeje më së shumti prek banorët e jugut të Serbisë që kanë përfunduar studimet në Kosovë.

Marrëveshja kryesore me Prishtinën ishte ajo për përfaqësim rajonal (bashkëpunim rajonal) e cila u arrit gjatë raundit të tetë të bisedimeve¹⁹, në

16 <http://www.naslovi.net/2011-09-28/rts/prelazi-van-dnevnog-reda/2839592>.

17 Dialogu në mes Beogradit e Prishtinës u ndërpre në korrik të vitit 2011, më saktësisht bisedimet e caktuara u anuluan mu për shkak të mosmarrëveshjes rreth zgjidhjes për vulat doganore. Pastaj Prishtina i dërgoi njësitë speciale në vendkalimet administrative në Jarinje dhe Bërnjak, ndërsa serbët lokal e penguan marrjen e vendkalimeve duke i bllokuar rrugët.

18 www.danas.rs/danasrs/drustvo/konacnu_rec_daje_evropska_asocijacija_univerziteta_.55.html?news_id=231698.

19 Sipas marrëveshjes, emërtimi që do të përdoret në takimet rajonale është "Kosovo". Fusnota që do të përdoret me emërtimin thotë: "Ky emërtim nuk paragjykon statusin dhe është në pajtim me Rezolutën 1244 dhe me mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi deklaratën për pavarësinë e Kosovës".

prag të marrjes së vendimit për kandidaturën e Serbisë (Serbia fitoi statusin e kandidatit më 1 mars, ndërsa marrëveshja u arrit më 24 shkurt). Beogradi megjithatë shumë shpejt filloi ta shkel marrëveshjen gjë që çoi në situatën ku qoftë delegacioni i Prishtinës (meqë nuk ishte përfaqësuar në mënyrë të duhur), qoftë delegacioni i Beogradit (meqë Kosova ishte përfaqësuar sipas marrëveshjes) i braktisën disa takime rajonale. Mosmarrëveshja kryesisht kishte të bënte me këmbënguljen e Serbisë që teksti i fusnotës të shkontë poshtë ose në vazhdim të emërimit Kosovë*. Ekipi kosovar dhe ndërmjetësuesi ndërkombëtar, Kuper, mendojnë që sipas marrëveshjes vetëm asteriksi mjafton.

E vetmja marrëveshje që ende nuk ka filluar të zbatohet është ajo për menaxhimin e integruar të vendkalimeve kufitare. Duke marr parasysh rëndësinë e kësaj marrëveshjeje, pala kosovare këmbëngul në nënshkrimin e saj gjë që akoma nuk ka ndodhur. (Asnjë marrëveshje tjetër nuk është nënshkruar, por të dyja palët janë zotuar se do t'i respektojnë ato).

Në marrëveshje thuhet se EULEX-i “do të jetë prezent në përputhje me mandatin e tij”. Koncepti i menaxhimit të integruar të vendkalimeve kufitare “do të zbatohet gradualisht, sa më shpejt të jetë e mundur në praktikë”. Në marrëveshje thuhet se pikat e përbashkëta, të integruara, të veçanta dhe të sigurta do të jenë në përputhje me “zonat e përbashkëta të vendkalimeve të integruara”, të shënuara bashkarisht, ku zyrtarët e të dyja palëve do të zhvillojnë kontrollin relevant. Vetëm në zonat e përbashkëta të integruara kufitare, palët nuk do të paraqesin simbolet e juridiksionit të tyre. Kryesuesja e ekipit negociator kosovar, Edita Tahiri, shpjegoi që të dyja shtetet do ta kenë doganën dhe shërbimin e tyre kufitar në vendkalimet që janë nën përgjegjësinë e tyre²⁰.

Përkundër përparimit të dukshëm në fushën e telekomunikimit, në fillim të dialogut çështjet e telekomunikimit dhe të energjisë elektrike kanë mbetur të hapura. Në momentin kur po e përgatisim këtë raport, vazhdimi i dialogut për çështje teknike mvaret nga zbatimi i marrëveshjeve të arritura.

20 Radio Evropa e Lirë, 3. dhjetor 2011.



Komunat serbe dhe vendbanimet me përbërje të përzier etnike në Kosovë

VIZITAT STUDIMORE TË EKIPIT TË KOMITETIT TË HELSINKIT

Në këtë kapitull kemi paraqitur deklaratat e bashkëbiseduesve tanë pa komente dhe vlerësime të drejtpërdrejta nga Komiteti i Helsinkit.

Komuna e Klllokotit

Decentralizimi

Komuna e Klllokotit është komunë me shumicë serbe (75 përqind serbë, 25 përqind shqiptarë) e cila deri në vitin 2009 ishte pjesë e komunës së Vitisë. Serbët, qysh në vitin 2007, morën pjesë në qeverinë komunale të Vitisë, që për ta shënonte edhe fillimin e një periudhe më të qetë. Zyra për komunitetin serb në komunën e Vitisë, e cila deri në vitin 2008 ishte e vendosur në Vërbovc, në vitin 2009 u shndërrua në ekipin përgatitor për krijimin e komunës së re. Në nëntor të vitit 2009 u mbajtën zgjedhjet komunale dhe komuna e re u krijua në vitin 2010. Të rinjtë në masë të madhe morën pjesë në zgjedhjet e para lokale për komunën e re të Klllokotit.

Në kuvendin komunal janë 15 ulëse për këshilltarë: 10 ulëse i takojnë SLS-së (Partisë Liberale Serbe) dhe pesë ulëse i takojnë Lidhjes Demokratike të Kosovës. Këto dy parti janë në koalicion kështu që nuk ka opozitë parlamentare. Komuna ka dy komitete: komitetin politik-financiar dhe komitetin për komunitete që merret me çështjet shëndetësore, shoqërore dhe arsimore. Përfaqësuesit e komunës çdo tre muaj zhvillojnë debate me banorët me ç'rast diskutojnë çështje të rëndësishme të përgjithshme.

Buxheti vjetor i komunës nga Qeveria e Kosovës është 1 milion euro. Buxheti ndahet sipas numrit të banorëve, Klllokoti ka 5050 banorë. Rreth 60 përqind e buxhetit shpenzohet në pagat e nëpunësve në shërbimet komunale dhe publike, €200.000 shpenzohen në investime kapitale, dhe €120.000 shpenzohen në mallra dhe shpenzime të tjera (të nevojshme për punën e institucioneve).

Komuna e Klllokotit akoma nuk e ka ndërtesën e vet dhe ende është me qira. Ndërtesa e re do të duhej të ishte gati në qershor të vitit 2012. Sipas planit, në këtë vit do të duhej të shtrohen me asfalt të gjitha rrugët e komunës.

Në regjistrimin e popullsisë të organizuar nga Qeveria e Kosovës u regjistruan rreth 70 përqind e serbëve, përkundër apelit të Beogradit që serbët ta bojkotojnë këtë proces. Incidente ndëretnike nuk ka pasur që nga viti 2008.

Kryetari i komunës së Klllokotit, Sasha Mirkoviq, thotë që decentralizimi sipas Planit të Ahtisaarit është gjë pozitive. Ai poashtu shton që niveli qendror nuk po bart sa duhet përgjegjësi tek niveli lokal. Klllokoti ende nuk e ka gjykatën themelore edhe pse kjo është paraparë me ligjet e Kosovës. Gjyqtarët e gjykatës së re, sipas Planit të Ahtisaarit, do të duhej të zgjedhen sipas strukturës etnike të komunës. Për momentin, gjykata kompetente për Klllokotin është në komunën e Vitisë dhe aty nuk ka gjykatës serbë.

Në komunën e Klllokotit pohojnë që Ligji për Decentralizimin nuk po zbatohet në tërësi dhe që si rezultat nuk janë bartur të gjitha përgjegjësitë për udhëheqjen e punëve publike-komunale dhe për menaxhimin e tokave. Ata poashtu mendojnë që duhet të formohet edhe shërbimi lokal i zjarrfikësve.

Kryetari i komunës, Markoviq, thotë se ende nuk ka ardhur koha për mbylljen e Zyres Civile Ndërkombëtare në Kosovë.

Komuna e Klllokotit ka bashkëpunim të mirë me komunën amë të Vitisë. Sipas zv.kryetarit Marko Svillanoviq dhe zv.kryetarit për komunitete Refik Halimi, komuna nuk ka kontakt me institucionet në Beograd. Ka pasur pre-

sione nga Serbia mbi serbët lokal që të mos marrin pjesë në krijimin e komunës së re. Sipas Refki Halimit, presione ka pasur edhe nga pala shqiptare. Atij ia kanë hedhur një bombë në makinë. Në fshatin Vërbovc gjendet komuna paralele e Vitisë e përkrahur nga Beogradi dhe me të cilën kanë raporte korrekte.

Ekonomia

Deri në mars të vitit 2012 janë realizuar 60 përqind e projekteve të planifikuara infrastrukturore. Fondet për këto projekte janë ndarë nga buxheti i Qeverisë së Kosovës në shumë prej 1 milion euro. Fonde shtesë prej rreth €300.000 janë dhënë nga organizatat ndërkombëtare siç janë USAID, Logos (Zvicër). Komuna i mbledh edhe të hyrat e veta nga tatimi në pronë dhe taksat komunale në shumë totale prej €100.000. Në mesin e investimeve të qëlluara, Mirkoviq thekson që gjatë dy viteve në komunë janë investuar €16.000.000 (përfshirë këtu edhe investitorët privat) dhe që në ndërtim e sipër është kompleksi i ri rekreativ-pushimor “Nëna Naile”. Në fshatin Shillovë gjendet një zyre e Bankës Komerciale.

Bujqësia është dega kryesore e ekonomisë. Problem kyç në këtë drejtim është plasimi i produkteve. Në komunë thonë se tregu kosovar është i tejngarkuar, dhe se eksporti i mallrave në Serbi është i vështirë për shkak të doganës në mallra, si dhe administratës së ndërlikuar e cila në mes tjerash kërkon edhe verifikimin komunal mbi origjinën e mallit. Kjo ka ndikuar shumë në gjendjen ekonomike në komunë dhe ka çuar në rënien e aktiviteteve ekonomike. Sipas Svillanoviqit dhe Halimit, deri para katër viteve (deri në vitin 2008), Qendra Bashkërenduese për Kosovë dhe Metohi e Republikës së Serbisë i ka blerë produktet bujqësore. Kjo u ndërpre në vitin 2008, ndërsa Qendra Bashkërenduese akoma nuk iu ka paguar mallrat shumë prodhuesve. Shumica e banorëve merren me bujqësi.

Duke mos i llogaritur aktivitetet e lidhura me bujqësi, 900 përqind e banorëve janë formalisht të papunë. Poashtu, pak para krijimit të komunës, Agjencioni për Privatizim i Kosovës i ka shitur 95 përqind të pronës shoqërore të komunës. Kështu, autoritetet e Klllokotit nuk ishin në gjendje të marrin pjesë në privatizim dhe mbetën pa pronë shoqërore. Në mesin e ndërmarrjeve të privatizuara është edhe fabrika e ujit dhe kompleksi “Nëna Naile”. Këto dy ndërmarrje sot kanë rreth 100, përkatësisht 200 punëtorë. Komuna e Klllokotit ka 56 nëpunës: 70 përqind prej tyre janë serbë dhe 30 përqind shqiptarë.

Halimi dhe Svillanoviq theksojnë se papunësia në mesin e banorëve të komunës paraqet problemin kryesor. Të rinjtë ikin jashtë vendit. Komuna dëshiron të aplikoj në Qeverinë e Kosovës për fonde për punë publike në mënyrë që ta lehtësoj pak apo që pjesërisht ta zgjidh problemin e papunësisë.

Shëndetësia

Komuna e Klllokotit ka dy ambulanta - një në Klllokot dhe një tjetër në Vërbovc. Këto dy qendra kanë shtatë punëtorë që paguhen nga komuna e Klllokotit dhe paga e tyre është €300 në muaj. Ata janë futur në punë nëpërmjet konkursit komunal. Përveç tyre, në ambulanta punojnë edhe 15 punëtorë të shëndetësisë të cilët sipas informatave të komunës paguhen nga Qeveria e Serbisë me €400 deri në €500 në muaj. Në mesin e nëpunësve nuk ka shqiptarë.

Arsimi

Të gjithë mësimdhënësit serbë që punojnë në arsim marrin paga nga Qeveria e Kosovës dhe nga Qeveria e Serbisë. Në fshatin Mogillë gjendet një shkollë serbo-shqiptare “Gjon Sereqi/Marko Rajković”. Edhe pse fëmijët serbë dhe shqiptarë shkojnë në shkollën e njëjtë, ata megjithatë vijnë në mësimet e tyre me programe të ndara dhe sistemi nuk punon në ndërveprimin në mes tyre. Fëmijët luajnë bashkë gjatë pushimit (kryesisht lojëra sportive), por nuk mund të komunikojnë meqë nuk e flasin gjuhën e njeri tjetrit.

Sipas kryetarit të komunës së Klllokotit, vetëqeverisja lokale nuk ka fonde për financimin e arsimit dhe shëndetësisë. Nga 18 profesorët e nevojshëm, komuna i financon 12 prej tyre. Komuna i furnizon edhe klasat e mësimet dhe kabinetet. Të gjithë mësimdhënësit i cakton Beogradi, më konkretisht kryetari i departamentit për arsim.

Mediat

Banorët e komunës së Klllokotit mund të informohen nëpërmjet dy medimeve lokale, Radio Klllokotit në gjuhën serbe, dhe stacionit televiziv TV Plus i cili emitohej poashtu në gjuhën serbe nga vendi i quajtur Shillovë në komunën e Gjilanit.

Nebojsa Vesiq, gazetar në Radio Klokot, thotë që ky radio stacion transmeton 4 deri në 6 orë program të vet autorial. Stacioni poashtu transmeton emisionet e Zërit të Amerikës dhe Evropës së Lirë. Radio Klokoti është pjesë e rrjetit medial KOSMA. Vesiq thotë që gazetarët kanë bashkëpunim korrekt me institucionet dhe zyrtarët kosovarë në marrjen e informatave.

Gazetat ditore dhe javore nga Serbia nuk arrijnë në Klokot. Vesiq thotë se banorët informohen me anë të internetit dhe më së tepërmi nga portalet e gazetës ditore Blic, Mondo dhe Radio KiM.

Marrëveshjet Beograd - Prishtinë

Sasha Mirkoviq, kryetar i komunës së Klokotit, thotë se marrëveshjet e arritura në Bruksel në mes Beogradit dhe Prishtinës nuk po zbatohen.

Librat e kadastrës për komunën e Klokotit gjenden në Krushevc. Sipas marrëveshjes Beograd - Prishtinë, komuna është dashur të marr kopje të verifikuara të kadastrës mirëpo kjo ende nuk ka ndodhur. E njëjta vlen edhe edhe për librat amzë që gjenden në Vranjë

Komuna e Parteshit

Decentralizimi

Parteshi ka rreth 5000 banorë, të gjithë prej tyre janë serbë. Institucionet komunale u formuan më 19 gusht 2010, dhe kuvendi komunal ka 15 këshilltarë. Komuna ende nuk e ka ndërtesën e vet, kështu që detyrohet të punoj në një objekt të marr me qira. Ndërtesa e re e komunës po ndërtohet në Pasjanë.

Nenad Cvetkoviq, kryetar i komunës së Parteshit, shpjegon se të gjitha përgjegjësitë janë bartur nga komuna amë e Gjilanit. Parteshi ka disa institucione: stacionin policor, ndihmën e shpejtë, ndërtesën e spitalit (e cila ende nuk është e pajisur dhe nuk funksionon), tri shkolla fillore dhe tri shkolla të mesme (gjimnazi, shkolla e mjekësisë dhe shkolla ekonomike-bujqësore). Parteshi ende nuk ka gjykatë të vetën, prandaj gjykata në Gjilan është ende kompetente për këtë pjesë.

Në seancat e kuvendit komunal shpesh marrin pjesë edhe përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës. Salla ku zhvillohen seancat e kuvendit komunal është e pajisur me mjete bashkëkohore dhe me teknologjinë për transmetimin e drejt-përdrejt të seancave të kuvendit të cilat mund t'i përcjellin edhe ministrat e Qeverisë së Kosovës.

Qeveria e Kosovës i ndan €2 milion për buxhetin e Parteshit. Qeveria ka ndarë edhe 1 milion euro shtesë për investime kapitale: spitali (i ndërtuar, por nevojiten edhe rreth 2 milion euro për pajisje), rregullimi i kanaleve të lumit, ndriçimi i rrugëve dhe rregullimi i disa rrugëve. Është ndërtuar edhe një sallë e sportit brenda shkollës.

Komuna e ka ulur taksën komunale në €2.90. Komuna ndan edhe material për ndërtimin e shtëpive private. Shumica e shtëpive nuk kanë banjo. Banorët mund të aplikojnë në komunë për t'u pajisur me pasaportë kosovare dhe shumica e banorëve të komunës kanë dokumente kosovare.

Komuna nuk ka kontakt me institucionet në Beograd. Komunikim pothuajse nuk ka fare me bashkëkombasit shqiptar, por nuk ka as probleme e konflikte. Komunitat fqinje të Parteshit dhe Gjilanit megjithatë punojnë në projekte të përbashkëta me të cilat aplikojnë te donatorët (p.sh. ndihma e drejtpërdrejt për bujqësi). Bashkëpunimi në mes të këtyre dy komunave është shembull i mirë meqë i tejkalon ndarjet etnike dhe bazohet në interesa ekonomike.

Ekonomia

Rrjeti i dobët rrugor paraqet pengesën më të madhe për zhvillimin e ekonomisë. Në 50 vitet e fundit nuk është bërë asnjë investim në komunë. Infrastruktura e dobët (rrugët, ujësjellësi, kanalizimi) paraqesin problem edhe për joshjen e investimeve, thotë Cvetković.

Bujqësia është aktiviteti themelor në këtë komunë. Përveç bujqësisë, shkalla e papunësisë është rreth 60 përqind. Kjo shkakton probleme të mëdha shoqërore dhe demografike. Rreth 50 përqind të të rinjve janë jashtë vendit (më së tepërmi në Luksemburg). 70 përqind e banorëve janë jashtë vendit. Në komunë punojnë 60 njerëz.

Arsimi

Qeveria e Serbisë i ka lënë prapa shkollat në këtë komunë. Brenda mundësive të veta, komuna ndihmon në fushën e arsimit. Në shkolla mësohet sipas planprogramit serb. Parteshi ka tri shkolla fillore dhe tri shkolla të mesme (gjimnazi, shkolla e mjekësisë dhe shkolla ekonomike-bujqësore).

Mediat

Nga mediat në gjuhën serbe në komunë shikohen dhe dëgjohen TV Plus nga Shillova dhe Radio Laser nga Pasjani. Në këtë komunë nuk ka gazeta në gjuhën serbe.

Sporti dhe kultura

Komuna e financon ndërtimin e Qendrës së Kulturës. Në Partesh punon Qendra Rinore. Klubi futbollistik i Parteshit merr pjesë në Ligën e Kosovës.

Institucionet paralele nën kontrollin e Beogradit

Në Kushqë, në komunën e Gjilanit, gjendet administrata e komunës paralele të Gjilanit e cila e mbulon tërë Anamoravën dhe e cila përkrahet nga Beogradi. Komuna ka rreth 300 këshilltarë të cilët nuk janë zgjedhur përsëri në zgjedhje por ka mbetur struktura e njejtë që nga viti 2008. Cvetković thotë se përfaqësuesit e Parteshit nuk kanë bashkëpunim me komunën paralele.

Komuna e Graçanicës

Decentralizimi

Komuna e Graçanicës, dikur fshat në periferi të Prishtinës, gjatë 12 viteve të fundit është rritur dhe shndërruar në një qytezë. Për shkak të ndërtimeve të mëdha në këtë pjesë të Kosovës, Graçanica me Prishtinën sot pothuajse janë të lidhura. Boban Stojanović, kryetar i komunës së Graçanicës, thotë se

përparimi më i madh është arritur në dy viteve të fundit dhe sot Graçanica është njëra ndër pesë komunat më të suksesshme të Kosovës e cila nuk ka asnjë borxh.

Serbët, sipas kryetarit Stojanoviq, megjithatë frikësohen se pas mbylljes së Zyres Civile Ndërkombëtare në Kosovë, Plani i Ahtisaarit do të ndërpritet me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së re të Kosovës. Ai dyshon në përpjekjet e Qeverisë të Kosovës që deri në fund të pavarësisë së mbikëqyrur të fut në ligjet e saja të gjitha dispozitat e Planit të Ahtisaarit.

Procesi i bartjes së përgjegjësiave tek qeveria komunale pothuajse ka përfunduar, por ekziston një problem me bartjen e përgjegjësiave nga niveli qendror. Plani i Ahtisaarit nuk është plan i decentralizimit, por i riorganizimit të hapësirës së Kosovës, gjë që sipas Stojanoviqit shpeshherë përzihet. Sipas vlerësimit të tij, Qeveria e Kosovës, përkundër decentralizimit të deklaruar, po zhvillon një proces të centralizimit në fushën e shërbimeve komunale, funksionimit të tregut, menaxhimit të pyjeve, politikave fiskale, zhvillimit ekonomik, planit hapësinor, etj. Mungon për shembull shërbimi i zjarrfikësve ose inspeksioni i tregut në nivelin lokal. Stojanoviq thotë se ky nuk paraqet problem vetëm për Graçanicën dhe komunat serbe por për tërë Kosovën.

Stojanoviq poashtu thekson se mungon plani për zhvillim rajonal dhe hapësinor për çka duhet të hartohet sa më parë karta socio-ekonomike e komunës, gjë që nuk është bërë deri më sot. Prandaj, planet dhe strategjitë e rekomanduara nuk janë të zbatueshme. Problemi kryesor është në mospërgatitjen profesionale të njerëzve që merren me këto çështje si dhe në mungesën e fondeve. “Si mund ta di në ç’drejtim ta udhëheq Graçanicën, kur nuk e di se kah po shkon Kosova?” pyet Stojanoviq.

Sipas Stojanoviqit, një problem shtesë për zbatimin e Planit të Ahtisaarit paraqet fakti se asnjë komunë e re nuk e ka gjykatën e saj themelore. Stojanoviq e përmend edhe spekulimin që ulëset e garantuara për serbët në Kuvendin e Kosovës do të barten në kategorinë e ulëseve të “rezervuara” me çka mund të zvogëlohet numri i përfaqësuesve serb në Kuvendin e Kosovës.

Ekonomia

Gjatë dy viteve të fundit, që kur është krijuar komuna e re sipas Planit të Ahtisaarit, Graçanica është veçuar si njëra ndër komunat më të suksesshme në Kosovë. Graçanica nuk ka borxhe, janë realizuar rreth 150 projekte dhe është krijuar atmosferë pozitive për zhvillim shoqëror dhe ekonomik. Komuna meg-

jithatë ka mungesë të fondeve për hartimin e strategjive zhvillimore. Komuna poashtu ka mungesë të programeve për forcimin e kapaciteteve për realizimin e projekteve IPA.

Sipas serbëve lokal, çmimi i një hektari tokë në viset rurale shkon në mes dy dhe tre milion euro. Atraktiviteti i lokacionit (komuna gjendet larg Prishtinës 10-15 vozitje me makinë) ka çuar në rritjen e çmimit të patundshmërisë dhe tokës. Çmimet e larta të tokave, posaçërisht nëse ato gjenden në afërsi të rrugës janë motiv mjaft i fortë për serbët që t'i shesin pronat e tyre, të blejnë patundshmëri në Serbi dhe të largohen nga Kosova. Këto para megjithatë përsëri investohen në patundshmëri dhe kryesisht në Serbi, dhe shumë të rralla janë projektet investuese në ekonomi në vet komunën e Graçanicës.

Stojanoviq thotë që gjykatat kosovare janë joefikase dhe që janë 18.000 lëndë të pazgjidhura të kontesteve pronësore serbo-shqiptare.

Një tjetër brengë e nëpunësve komunal është gjendja me librat e kadastrës. Në fakt, sipas Stojanoviqit, është vështirë të dëshmohet vlefshmëria e kopjeve të librave të kadastrës. (Në marrëveshjen Beograd - Prishtinë thuhet se Beogradi duhet të dorëzoj kopje të kadastrës).

Në Graçanicë mendojnë se ligji mbi përdorimin e gjuhëve nuk po zbatohet sa duhet, dhe që në shitoret e shqiptarëve nuk ka mbishkrime në gjuhën serbe. Në Graçanicë nuk ka as mbishkrime në gjuhën shqipe në ndërmarrjet ekonomike dhe nëpër shitore.

Shëndetësia

Në territorin e Graçanicës funksionojnë katër shtëpi të shëndetit. Të gjithë nëpunësit paguhën nga Republika e Serbisë. Shtëpia e shëndetit Graçanica ka 750 punëtorë, Prishtina 800, Ugljarë 400, Gushtericë e Poshtme 500. Në komunën e Graçanicës është ndërtuar laborator modern për analiza të ndryshme mjekësore. Laboratori ka filluar të punoj pjesërisht (reparti për analizat laboratorike të gjakut) dhe aktualisht po punohet në pajimin e mëtutjeshëm të kësaj qendre (duhet të sigurohen ultrazëri dhe aparatet e tjera). Në laborator punojnë kryesisht të rinj që kanë mbaruar shkollën e mesme të mjekësisë në Graçanicë apo Fakultetin e Mjekësisë në Mitrovicë.

Arsimi

Sistemi arsimor në gjuhën serbe financohet nga Republika e Serbisë.

Sa i përket funksionimit të shkollës, Miljana Kisiq, psikologe e shkollës, thotë se gjendja në këtë drejtim është e vështirë. Mungon hapësira e mjaftueshme (nxënësit e shkollës së mesme janë në ndërrimin e paraditës, ndërsa nxënësit e shkollës fillore në ndërrimin e pasditës); kabinetet, përveç atij të informatikës, janë të pajisur të dobët. Shkollës i mungon edhe shujta ditore për fëmijë. Në fund të vitit shkollor, shkolla ka pasur problem me sigurimin e pakove “lista e dëshirave” e cila është e domosdoshme për nxënësit e shkollave fillore që të regjistrohen në shkollë të mesme. Problemi fillon në kufi ku autoritetet kosovare nuk lejojnë kalimin e pakove më të mëdha se 5 deri në 6 copë. Prandaj, për momentin, vet prindërit angazhohen për t’i siguruar këto pako.

Kryetari i komunës, Bojan Stojanoviq, thotë që gjendja në arsim është e keqe dhe që fëmijët dalin nga shkolla pa mësuar shkrim e lexim. Mungojnë kushtet elementare për arsim dhe përparim akademik. Së bashku me shkallën e lartë të papunësisë, është krijuar një gjendje ku të rinjtë e ndjejnë mungesën e një të ardhme më të mirë. Shkollat në Graçanicë janë poashtu “rascepkane”. Në 18 shkolla, sa veprojnë në Graçanicë, në hapësirat e njëjta mësojnë edhe shkollat fillore edhe ato të mesme, duke e pamundësuar kështu specializimin e arsimit profesional të mesëm.

Komuna e ka miratuar hapjen e Fakultetit e Kombeve të Bashkuara për Media dhe Zhvillim me seli në Graçanicë i cili edhe do të ndërtoj një godinë. Në fillim, mësimet do të zhvillohen me përkthyes, në mënyrë që me zhvillimin e fakultetit mësimet më vonë do të mbahen vetëm në gjuhën angleze.

Sporti dhe kultura

Të rinjtë në Graçanicë njëlloj si të rinjtë në të gjitha komunat tjera e kalojnë kohën e tyre të lirë nëpër kafeteri. Mungojnë programet për fëmijë dhe aktivitetet jashtëshkollore.

Zhvillim pozitiv paraqet ndërtimi i qendrës së sportit ku 180 fëmijë ushtrojnë tenis. Klubi futbollistik i komunës është i suksesshëm dhe garon në ligën e Serbisë.

Meqë në jug të lumit Ibër nuk ka asnjë teatër në gjuhën serbe, në Graçanicë po ndërtohet një teatër. Komuna poashtu çdo vit organizon festivalin e Vidovdanit.

Institucionet paralele

Në territorin e komunës të Graçanicës veprojnë 6 komuna nën kontrollin e Beogradit të cilat menaxhojnë 22 ndërmarrje fiktive publike. Njerëzit që punojnë aty nuk kanë punë e as ndikim. Ata paguhen nga Republika e Serbisë.

Komuna e Pejës - Gorazhdec

Decentralizimi

Në komunën e Pejës, sipas listave zgjedhore, jetojnë rreth 1200 serbë, ndërsa në Gorazhdec rreth 900 serbë. Rreth 12 familje serbe janë kthyer në qytetin e Pejës. Deri në vitin 2002, Zyra për Komunitete funksiononte si pjesë e UNMIK-ut. Më vonë, ajo u fut nën përgjegjësinë e komunës së Pejës. Në aspektin formal, ka përfunduar integrimi i komunitetit në strukturat kosovare.

Njëri ndër prioritetet për banorët është funksionimi i gjykatave. Kryetari i Zyres për Komunitete të Kosovës në Gorazhdec, Slobodan Petroviq, mendon që zgjidhja e kontesteve pronësore duhet të jetë prioritet. Në rajonin e Pejës, sipas tij, ka pasur më së tepërmi manipulime. Rastet e lajmëruara nuk procesohen dhe nuk zgjidhen. Darko Dimitrijeviq, gazetar në Radio Gorazhdec, e veçon mosefikasitetin e gjykatave si problemin kryesor. Sipas tij, edhe policia është joefikase dhe nuk reagon në rastet e lajmëruara. Ka shumë keqpërdorime në marrëveshjet për shitblerje, sidomos në komunën e Klinës. Në konkursin për gjykatës serb në gjykatën themelore në Pejë nuk është lajmëruar asnjë kandidatë me kualifikime të duhura. Askush nuk reagon ndaj prerjes ilegale të pyjeve. Në njësitë e policisë së Kosovës ka edhe pjesëtarë serb.

Zyra ka shërbimin amë ku punojnë një serbe dhe një shqiptar. Në këtë zyre banorët mund të pajisen me çertifikatë të lindjes, vërtetim të nënshtetësisë, të vendbanimit dhe çertifikatën e martesës. Për marrjen e pasaportës dhe letërnjoftimit duhet të shkojnë në Pejë. Këtu edhe lind problemi meqë nuk ka nëpunës që flasin serbisht. Nëpunësit në zyre megjithatë janë të gatshëm t'iu ndihmojnë banorëve dhe të shkojnë me ta në Pejë për t'iu ndihmuar gjatë komunikimit me nëpunësit e administratës.

Gjendja e sigurisë është shumë më e mirë se në të kaluarën. Gjatë trazirave në barrikada në vitin 2011, përfaqësuesit e komunës ishin kundër pjesëmarrjes në ato aksione. Milivoje Zdravkoviq, drejtor i shkollës fillore,

megjithatë siç na treguan në komunë, ka bërë thirrje për të shkuar në barrikada. Ai edhe mori pjesë në barrikada dhe është pjesëtar i Partisë Progresive Serbe. Drejtori i shkollës së mesme, në anën tjetër, ka bërë thirrje për qetësim të situatës dhe e ka kundërshtuar pjesëmarrjen në protesta.

Në këtë komunë u mbajtën edhe zgjedhjet për presidentin e Republikës së Serbisë në vitin 2012. Boris Tadiq fitoi 70 përqind të votave të serbëve nga komuna e Pejës.

Ekonomia

Zyra për komunitete po orvatet të josh donatorët. Ajo poashtu merret edhe me procesin e kthimit dhe iu ndihmon personave të kthyer t'i zgjidhin kontestet pronësore-gjyqësore.

Ndër problemet që i brengosin ata, banorët e kësaj komune përmendin që procesi i privatizimit në Kosovë ka qenë diskriminues ndaj serbëve. 20 përqind nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore do të duhej t'iu jepej punëtorëve. Punëtorët serb megjithatë nuk i morën paratë sepse nuk kanë punuar "deri në ditën e fundit". Dihet qartë që ata nuk shkuan në punë deri në ditën e fundit për shkak të gjendjes së sigurisë sepse ke pasur edhe raste kur njerëzit janë humbur apo edhe vrarë, thotë Petroviq. Ata kërkuar që punëtorët të ofrojnë dëshmi rreth diskriminimit të tyre mirëpo askush nuk pranoi ta bëjë këtë.

Në fushën e infrastrukturës është bërë shumë pak. Zyra i ka realizuar disa projekte të vogla, me ndihmën e investitorëve, për zhvillimin e aktiviteteve sipërmarrëse të disa ekonomive familjare. Problemet pastaj lindin me mungesën e tregut dhe pamundësinë e plasimit të produkteve të tyre.

Shkalla e papunësisë është e lartë sidomos në mesin e të rinjve. Organizatat ndërkombëtare, kryesisht KFOR-i, ofron një numër të vogël të vendeve të punës. Personat e kthyer në qytetin e Pejës janë kryesisht të moshuar. Ata kryesisht marrin pensione dhe ndihma ose punojnë në Patriarkanën e Pejës.

Shëndetësia

Ndërtesa e shtëpisë së shëndetit është përfunduar dhe aty punojnë 12-15 punëtorë, derisa në ndihmën e shpejtë punojnë rreth 20 punëtorë. Ata janë kryesisht çifte të martuara ku asnjë anëtar i familjes nuk ka punuar më herët. Për raste urgjente apo ndërhyrje serioze mjekësore, banorët shkojnë në Pejë, kryesisht tek mjekët privat.

Në Kosovë nuk ka përkujdes shëndetësor pa pagesë. Kontrolli në institucionet shtetërore të mjekësisë kushton rreth 10 euro. Qendrat shëndetësore në mjediset serbe janë të vetmet që ofrojnë përkujdës mjekësor pa pagesë dhe kjo shpesh i josh edhe pacientët shqiptarë.

Arsimi

Gorazhdeci ka një ndërtesë për arsim ku zhvillojnë mësimet tri shkolla fillore dhe tri shkolla të mesme (gjimnazi, shkolla teknike dhe shkolla ekonomike).

Fëmijët në këtë pjesë janë shumë të izoluar. Nuk ka ndërveprim me shkollat e afërta dhe me fëmijët shqiptarë. Nuk ka lidhje as me shkollat serbe në viset e tjera. Profesori i edukatës fizike në shkollën e Gorazhdecit thotë që askush nuk është i gatshëm të financoj takime në mes shkollave, siç është pjesëmarrja në gara sportive, dhe se prindërit dhe mjedisi janë shumë të dyshimtë rreth “shoqërimit të fëmijëve të tyre me fëmijët shqiptarë”. Profesori i edukatës fizike ka inicuar stërvitje për të rinjtë në basketboll dhe ka provuar vet të organizoj pjesëmarrjen e fëmijëve në gara. Këto përpjekje individuale janë të nevojshme për përmirësimin e cilësisë së jetës në këto mjedise dhe duhet të përkrahen fuqimisht.

Fëmijët e Gorazhdecit kryesisht e vazhdojnë shkollimin e tyre në Mitrovicë.

Mediat

Radio Gorazhdeci çdo ditë të punës transmeton programin e mëngjesit prej orës 8 deri në orën 11. Informatat e shërbimeve përbëjnë një orë të programit, pastaj janë lajmet e mëngjesit dhe rubrika e shfletimit të gazetave ditore e cila simbolikisht quhet “për ju që do t’i kishit lexuar gazetatat por nuk keni ku t’i bleni ato”. Ky radio stacion është pjesë e rrjetit KOSMA dhe transmeton ditarin e tyre, thotë Darko Dimitrijeviq, gazetar dhe redaktor i radio stacionit.

Para dy vitesh, në bashkëpunim me organizatën joqeveritare Experimental Studio Group, radio stacioni e ka themeluar produksionin televiziv. Raportet televizive iu dërgohen rrjeteve televizive serbe dhe projekti përkrahet nga qeveria holandeze.

Darko Dimitrijeviq megjithatë mendon se ekziston presion i madh mbi kulturën dhe gjuhën serbe. Në Pejë për shembull nuk ka asnjë mbishkrim në gjuhën serbe, ndërsa nëpunësit e administratës nuk flasin serbisht dhe prandaj serbet nuk kanë qasje në shërbimet e administratës.

Në Gorazhdec nuk ka gazeta ditore nga Serbia, por ka program satelitor dhe internet. Në komunë vepron organizata joqeveritare Experimental Studio Group e cila udhëhiqet nga profesori i gjuhës angleze Sasha Petroviq dhe Darko Milliq.

Sporti dhe kultura

Milosh Dimitrijeviq thotë se në Gorazhdec nuk ka jetë të zhvilluar shoqërore. Aty gjendet Qendra e Kulturës mirëpo ajo nuk punon. Për nevoja të furnizimit, banorët shkojnë në Pejë dhe kjo paraqet mundësi për ndërveprim të caktuar me njerëzit nga viset e tjera.

Institucionet paralele

Zyra për komunitete e cila është nën autoritetin e Komunës së Pejës ka bashkëpunim korrekt me administratën e komunës paralele dhe me komunitetin lokal të cilin e udhëheq Milosh Dimitrijeviq, anëtar i Partisë Demokratike. Me kryetarin e mëhershëm, i cili ishte anëtar i Partisë Demokratike të Serbisë, kishin lindur shumë probleme. Gjysma e fshatit jetojnë të varur nga komuna paralele. Petroviq thotë se për ta motivi për mbajtjen e këtyre institucioneve paralele nuk është politik por shoqëror.

Nga viti 1999 deri në vitin 2007, koordinatorët komunal ishin në Beograd. Në vitin 2008 u mbajtën zgjedhjet lokale dhe komuna u zhvendos në fshatin e Gorazhdecit. Ajo tash është përgjegjëse për tërë komunën e Pejës dhe për të gjithë personat e kthyer që i njohin institucionet e Republikës së Serbisë. Shërbimi amë i kësaj komune paralele gjendet në Kragujevc. Komuna është vetëm dekor. Pasaportat dhe letërnjoftimet poashtu mirren në Kragujevc.

Sipas kryetarit të komunës paralele të Pejës, Milosh Dimitrijeviq, komuna ndan ndihma sociale për rreth 300 njerëz. Këta njerëz marrin prej 40 deri në 90 euro (varësisht nga numri i anëtarëve). Komuna poashtu ndaj material riprodhues për mbjelljet e pranverës dhe vjeshtës. Njerëzit këtu merren kryesisht me bujqësi.

Organizatat e shoqërisë civile

Në Gorazhdec vepron organizata joqeveritare Experimental Studio Group e cila ka pesë anëtarë aktiv. Organizata kryesisht punon me organizatën Olaf Palme nga Suedia, me ambasadën holandeze, si dhe me organizatat e tjera joqeveritare të Kosovës dhe me shqiptarët e Kosovës.

Deri tash organizata ka organizuar debate publike mbi problemet e komunitetit serb në Kosovë. Kjo është organizata e vetme serbe e shoqërisë civile në rajonin e Pejës, Istogut dhe Klinës. Dëshira e tyre është të joshin investime dhe ta formojnë rrjetin e organizatave serbe të shoqërisë civile në këtë rajon, thotë Sasha Petroviq, drejtor në Experimental Studio Group.

Ndërveprimi me shqiptarët ekziston por jo në nivel të mjaftueshëm. Ka rekomandime nga organizatat ndërkombëtare që të rinjtë ta mësojnë gjuhën shqipe, respektivisht gjuhën shqipe. Kursi për mësimin e gjuhës shqipe është në përgatitje e sipër. Experimental Studio Group është e gatshme të punoj në integrimin kulturor, nëse do të kishin fonde për një projekt të tillë.

Bashkëpunimi ndëretnik ballafaqohet me obstrukcione nga të dyja palët, prandaj nevojitet përkrahje e fuqishme politike sepse njerëzit akoma mendojnë në suaza të “bazave etnike”.

Experimental Studio Group ka mbajtur një takim për gjendjen e komuniteteve ku morën pjesë një numër i madh i përfaqësuesve të institucioneve. Edhe Koha Ditore kishte raportuar mbi këtë takim. Menjëherë pas publikimit të lajmit për këtë ngjarje, “Armata Kombëtare Shqiptare” filloi të shpërndaj pamflete kërcënuese.

Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë

Manastiri Deçani i Lartë

Kisha Ortodokse Serbe (KOS) në Kosovë brengoset kryesisht për gjendjen e rëndë ekonomike dhe me statusin e pazgjidhur ligjor. Ati Sava thotë që Kisha brengoset edhe për “mohimin e identitetit serb dhe që si rezultat vjen deri tek interpretimet pseudohistorike të cilat gjejnë vend edhe në librat shqip”. Gjatë bisedimeve në mes Beogradit dhe Prishtinës nuk u tha asnjë fjalë për pozicionin e KOS-it.

Plani i Ahtisaarit përmban Shtojcën V mbi pozitën e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë. Aty thuhet që duhet të formohet një komision për zbatimin e Shtojcës V i përbërë nga përfaqësues të organizatave ndërkombëtare si UNESCO, Zyra Civile Ndërkombëtare në Kosovë dhe OSBE-ja. Kjo megjithatë nuk u realizua për shkak se arrit një zgjidhje e kompromisit - u formua Zyra evropiane për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore serbe.

Ati Sava nga manastiri i Deçanit thotë se të gjitha zgjidhjet e përmendura në Planin e Ahtisaarit duhet të përfshihen në ligjet e Kosovës sa më parë. Është miratuar ligji për zonat e mbrojtura brenda të cilave nuk mund të ndërtohet asgjë pa miratimin e KOS-it. Ligji për Hoçën e Madhe, si dhe Ligji për mbrojtjen e Prizrenit, kanë shkaktuar reagime të fuqishme nga Lëvizja Vetëvendosje, thotë Ati Sava. Ka pasur edhe probleme siç janë ndërtimet e paligjshme rreth Gazimestanit si dhe përpjekjet për ndërtimin e magjistrales drejt Malit të Zi pranë manastirit të Deçanit. Këto probleme tash zgjidhen në suazat e Ligjit për Zonat e Mbrojtura.

Ati Sava thotë se kundërthënësë është ngutia për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur e cila planifikohet të ndodh në fund të vitit 2012. Procesi i bartjes së Planit të Ahtisaarit në ligjet e Kosovës nuk është përafërsisht gati. Sipas Atit Sava, planifikohet që të gjitha ligjet të miratohen me procedurë të shpejtë deri në shtator të vitit 2012. Në korrik do të bëhet vlerësimi përfundimtar për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur. Disa vende po bëjnë presion që ky proces të përshpejtohet derisa disa viende të tjera mendojnë se duhet pritur akoma. Do të futet në fuqi edhe kategoria e “ligjeve me rëndësi të jashtëzakonshme” për miratimin e të cilëve do të nevojitet shumica e dyfishtë (shumica e përgjithshme dhe shumica në mesin e pakicave). Respektimi i Planit të Ahtisaarit do të jetë kush i përhershëm për integrimin e Kosovës në BE.

Të gjitha zgjidhjet që futën në legjislacionin kosovar nën presionin e bashkësisë ndërkombëtare deri në fund të vitit 2012 do të jenë jashtëzakonisht të rëndësishme për komunitetin serb. Ati Sava brengoset që presioni për zbatimin e Planit të Ahtisaarit do të vlej vetëm për veriun e Kosovës, derisa kjo çështje do të anashkalohet në jug të lumit Ibër. Problemi i kufirit, doganës dhe barrikadave nuk është çështje politike por financiare. Ati Sava thotë se veriun është zonë gri dhe vendstrehim i kriminelëve.

Plani i Ahtisaarit është pjesë përbërëse e Kushtetutës së Kosovës dhe siguron shkallë të mirë të mbrojtjes për pakicën serbe. Fakti që serbët kanë mundësi të mbajnë nënshitetësi të dyfishtë është shumë i rëndësishëm. Falë Planit të Ahtisaarit është ruajtur trashëgimia e jonë kulturore, thotë Ati Sava. Ai shton se ky plan është specifik “sepse favorizon vetëm një komunitet - komunitetin serb”.

Sipas Atit Sava, nga viti 1999 në Kosovë janë shkatërruar më tepër se 150 objekte kishtare. Manastiri i Deçanit, sipas tij, ka qenë cak i katër sulmeve të armatosura që nga viti 1999. Njëra ndër marrëveshjet më të suksesshme serbo-shqiptare, sipas Atit Sava, është Marrëveshja e mirëkuptimit në mes KOS-it dhe institucioneve të përkohshme kosovare në vitin 2005, e cila parashihte rindërtimin e objekteve të dëmtuara dhe të rrënuara në mars të vitit 2004. Në bazë të marrëveshjes, deri tash janë rindërtuar rreth 70 përqind të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara.

Ministria e fesë dhe diasporës iu ndihmon murgjeve të varfër. Ata financohen edhe me donacione individuale.

Sipas Atit Sava, në Kosovë jetojnë 90.000-120.000 serbë. Në pjesën lindore të Kosovës, në rajonin e Anamoravës, mbretëron krizë e madhe humanitare. Në anën tjetër, në Zveqan, Svetllana Steviq udhëheq organizatën “Majka devet Jugoviqa” e cila kujdeset për furnizimin dhe mirëmbajtjen e kuzhinave popullore. Dioqeza ka hapur pesë kuzhina popullore ku ushqehen rreth 2000 njerëz. Serbët kanë problem të madh sepse nuk flasin shqip. Shkalla e papunësisë në mesin e shqiptarëve arrin në 70 përqind. Ekziston droja legjitime se nëse Serbia i ndërpret ndihmat financiare për serbët e Kosovës këta të fundit do të shpërngulen. Ndihmat nga qeveria e Republikës së Serbisë kryesisht shkojnë në paga. Numri i fëmijëve serbë në shumë shkolla në pjesën lindore të Kosovës është përgjysmuar.

Qëndrimi i KOS-it rreth çështjes së institucioneve paralele është se nuk guxojmë të ndahemi në patriotë dhe në tradhëtarë.

Patriarkana e Pejës

Deri në mars të vitit 2011, Patriarkana e Pejës ka qenë nën ruajtjen e kontingjentit italian të KFOR-it dhe tash nën ruajtjen e kontingjentit slloven. Në manastir jetojnë 23 motra, disa civilë dhe një murg, në përgjithësi rreth 30 njerëz. Në manastir momentalisht po punon një ekipë e restaurimit nga Beogradi dhe projekti i restaurimit financohet nga UNESCO.

Bashkësia ndërkombëtare më nuk ndërmjetëson në mes manastirit dhe autoriteteve lokale. Murgeshat rrallëherë dalin nga manastiri nga frika e provokimeve. Ato mendojnë që siguria është problemi i tyre kryesor. Që një vit e më tepër nuk kanë përcjell nga KFOR-i. Sipas tyre, policia nuk iu përgjigjet thirrjeve dhe është e njëanshme. Motrat mendojnë që shqiptarët do t'i dëbojnë dhe që nuk mund t'i durojnë personat e kthyer. Rastet e prerjes së pyjeve dhe vjedhjes së prodhimeve bujqësore në pronat e manastirit janë të shpeshta.

Përkundër statusit të zonës së mbrojtur, përreth manastirit është ndërtuar rruga për biçikleta pa miratimin paraprak të manastirit. Komuna nuk ka reagur në ankesat e murgeshave.

Deri në vitin 1999, manastiri ka pasur rreth 60 hektarë tokë: 30 hektarë tokë të punueshme dhe 30 hektarë pyje. Mirëpo murgeshat thonë se nuk mund ta shfrytëzojnë tokën e tyre. Sipas tyre, toka ose është e uzurpuar nga dikush ose është e mbushur me mbeturina. Sipas murgeshave i tërë pylli është prerë.

Manastiri çdo muaj i paguan Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës 1000-1500 euro për shpenzime të energjisë elektrike. Këto tarifa janë më të larta se më parë, meqë manastiri llogaritet si institucion e jo si ekonomi familjare siç ishte llogaritur më parë. Patriarkanës më së shumti i ndihmojnë financiarisht Ministria e fesë dhe diasporës në Qeverinë e Serbisë dhe manastiri i Deçanit.

Një murgeshë e vjetër ankohet që KOS-i e ka harruar manastirin dhe që nuk e marrin më as gazetën e kishës dhe revistën periodike, dhe që askush nuk i thërret më në telefon. Thonë se vetëm familja Kariq gjithmonë iu ka ndihmuar dhe i ka telefonuar.

Kisha në Osojanë

Ndërtimin e kishës në Osojanë e ka financuar kisha ortodokse greke. Kisha ka korin e saj si dhe mban klasë fetare për rreth 20 nxënës nga Vidanje dhe rreth 50 fëmijë nga Osojanë. Ky shembull është dëshmi e mirë që kisha iu ofron hapësirë të rinjve që të angazhohen në ndonjë fushë dhe t'i zhvillojnë talentet e tyre në këndim për shembull. Kisha funksionon me forca vetanake. Para vitit 1999, në shkollën në Osojanë kanë vijuar mësimet rreth 900 fëmijë.

Sa i përket objekteve fetare, prifti Millosh Vukiq paralajmëron se manastiri në Deviq është i kërcënuar. Ky është manastir i femrave që gjendet në komunën e Serbicës. Manastirin më herët e kishin ruajtur forcat e KFOR-it, dhe tash për sigurimin e tij përkujdeset policia e Kosovës.

Decentralizimi

Në komunën e Istogut jetojnë rreth 2300 serbë dhe këtu është shënuar përqindja më e madhe e personave të kthyer në tërë Kosovën. Rreth 400 persona të tjerë po presin zgjidhje në mungesë të fondeve. Për tu formuar komuna e re, sipas Planit të Ahtisaarit, pakica/komuniteti serb duhet të ketë 5000 banorë në një territor. Akoma mbetet shpresa që në Osojanë do të kthehet numër i mjaftueshëm i serbëve në mënyrë që ky territor të mund të shkëputet nga komuna e Istogut dhe të formohet komuna e re. Në komunën e Istogut, para vitit 1999, kanë jetuar rreth 66.000 banorë, në mesin e të cilëve 8700 serbë. Cerkoletë është fshati i vetëm banorët e të cilit nuk janë shpërngulur. Në të gjitha vendet e tjera ka persona të kthyer. Ndërtimi i shtëpive për personat e kthyer është prioritet i Zyres për komunitete. Rreth 90 përqind të serbëve lokal janë pajisur me dokumente të Kosovës.

Vesna Maliković, kryesuese e Zyres për komunitete në Osojanë, thotë se problemi më i madh me të cilin ballafaqohen personat e kthyer janë rastet e vjedhjes. Personat e kthyer jetojnë në fshatra dhe merren me buqësi, dhe atyre më së shumti ju vidhen traktorët dhe bagëtia. Përveç ndjenjës së frikës, banorët mbesin edhe pa mjete themelore për bujqësi dhe për mbijetesë. Rreth 70 përqind e territorit të komunës është pronë e serbëve. Kjo është edhe arsyeja për numrin e madh të personave të kthyer përkundër shumë pengesave. Policia dhe gjykata nuk janë efikase dhe e hedhin përgjegjësinë nga njera tek tjetra. Policia është joprofesionale, e pashkolluar dhe i mungon teknika, dhe poashtu ekziston frika nga reagimet e shqiptarëve, thotë Maliković. Në Klinë ka më shumti persona të kthyer: në Drenoc janë ndërtuar rreth 10 shtëpi për persona të kthyer dhe është planifikuar ndërtimi i dhjetë shtëpive tjera. Në fshatin Dërsnik më parë kishin jetuar rreth 100 familje. Tash atje jetojnë vetëm dhjetë familje dhe anëtarë më ri është 55 vjeçar. Në fshatin Dolac, në Klinë, serbët dhe shqiptarët katolikë jetojnë së bashku dhe kanë raporte të mira, thotë prifti nga Osojani, Millosh Vukiq.

Institucionet paralele

Vesna Maliković thotë se nëse Republika e Serbisë i shuan institucionet e saj në Kosovë, një numër i madh i serbëve do të shpërngulehin nga

Kosova. Fondet nga buxheti i Serbisë i mbajnë serbët e Kosovës dhe përbëjnë burim themelor për këtë komunitet. Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) iu ka ndihmuar shumë personave të kthyer, por më së tepërmi atyre iu ka ndihmuar qeveria e Republikës së Serbisë duke iu blerë dru, farëra, plehra, makineri si dhe pajisje për institucionet arsimore dhe shëndetësore. Banorët e kësaj ane i shesin produktet e tyre kryesisht në Mitrovicë.

Mediat

Në fshatrat serbe të komunës së Istogut nuk ka gazeta ditore serbe. Lidhja me internet është e dobët dhe e shtrenjtë. Aty funksionon Radio Bravo në gjuhën serbe. Institucionet e respektojnë gjuhën dhe shkrimin në gjuhën serbe. Nuk ka jetë shoqërore dhe kulturore.

Arsimi

Është shkolla fillore dhe e mesme ku vijojnë mësimet rreth 90 nxënës. Shkolla është e renovuar dhe në gjendje të mirë. Shkolla ka edhe terrenin sportiv për basketboll.

Shëndetësia

Në Osojanë gjendet institucioni shëndetësor i cili ofron kujdes primar mjekësor. Në shtëpinë e shëndetit punojnë kardiologu, mamitë, mjekët e praksës së përgjithshme dhe motrat medicinale. Shtëpisë së shëndetit i mungojnë barnat dhe materiali mjekësor.

Ekonomia

Me synim t'iu ndihmoj të rinjve të papunë, Zyra kishte hartuar projektin për formimin e ekipeve që do t'iu ndihmonin të moshuarve. Projekti megjithatë nuk u përkrah as nga qeveria e Kosovës e as nga donatorët.

Ekziston problemi me energjinë elektrike për shkak të ujësjellësit të dobët. Sistemi i ujësjellësit është shtruar deri në Osojanë. Pensionistët marrin pensione prej 45 euro. Për disa femra në këto fshatra këto janë të ardhurat e tyre të para në jetë dhe përkundër shumës së vogël kjo ka çuar në emancipimin e

tyre dhe në kundërshtimin ndaj jetës patriarkale ku meshkujt i marrin të gjitha vendimet. Në shumicën e rasteve këto femra disponojnë me këto fonde.

Në Osojanë janë disa ndërmarrje bujqësore. Aty është edhe shtëpia e kulturës e cila nuk funksionon. Nuk ka kontejnerë për hedhjen e mbeturinave. Nuk ka fare shërbime komunale. As rrugët nuk janë të ndriçuara.

Komuna e Shtërpces

Decentralizimi

Në komunë mendojnë që në dy-tri vitet e fundit më së shumti është punuar në infrastrukturë, mirëpo progres i njejtë nuk është arritur edhe në procesin e decentralizimit. Bashkësia ndërkombëtare i ka bartur shumicën e përgjegjësi tek qeveria në Prishtinë. Në komunë, qeverinë e Kosovës e shohin si jostabile, gjë që nuk pasqyrohet mirë në zhvillimin e mëtutjeshëm të komunës ku komuniteti serb e përbën shumicën.

Këshilltari i kryetarit të komunës, Sllagjan Iliq, thotë se kanë bashkëpunim të mirë me përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës në komunë. 70 përqind e popullsisë në këtë komunë janë serbë dhe 30 përqind janë shqiptarë. Vetëm katër fshatra kanë strukturë të përzier etnike.

Në komunë, shumicën e kanë shqiptarët (10 shqiptarë, 9 serbë) për shkak se popullsia serbe pjesërisht i ka bojkotuar zgjedhjet. Kryetari i komunës i cili ka fuqi ekzekutive (për dallim nga sistemi qeverisës në Serbi) është serb. Ekzistojnë probleme me zbatimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe ato kryesisht lidhen me mungesën e gjykatës komunale. Banorët aktualisht duhet t'i drejtohen gjykatës në Ferizaj. Të gjithë gjykatësit janë shqiptarë. Iliq thotë se rrjeti i gjykatave duhet të riorganizohet dhe sistematizohet.

Disa institucione kanë probleme me respektimin e gjuhës së komunitetit pakicë. Korrespondenca me disa ministri kryhet vetëm në gjuhën shqipe.

Komandanti i policisë është serb, mirëpo gjatë emërimit të tij nuk është konsultuar kryetari i komunës. Banorët janë të kënaqur me komandantin e policisë, mirëpo procedura nuk është respektuar.

Në Shtërpce, të gjithë banorët serbë janë të pajisur me dokumente të

Kosovës. Të gjithë janë pajisur me tabela të reja të regjistrimit. Nuk ka probleme me liri të lëvizjes e as incidente ndëretnike. Problemi i vetëm është pagesa e sigurimit në kufirin në mes Serbisë dhe Kosovës.

Zgjedhjet për kuvendin dhe kryetarin e Republikës së Serbisë janë zhvilluar në qetësi. Më herët, derisa Vojislav Koshtunica, kryetar i Partisë Demokratike të Serbisë, ishte në pushtet në Beograd ai i kishte ndarë serbët në Kosovë. Para Koshtunicës, Serbia i njihte edhe serbët që merrnin pjesë në institucionet kosovare, thotë Iliq.

Banorët e Shtërpses nuk janë larguar nga shtëpitë e tyre, mirëpo në komunë ka serbë të zhvendosur nga krahinat e tjera të Kosovës.

Shëndetësia

Qeveria e Kosovës i ka ndarë fondet për ndërtimin e spitalit për kujdes dytësor mjekësor. Punët në ndërtimin e spitalit do të përfundojnë në fund të vitit 2012. Mjekët në Shtërpsë punojnë në ambulantën e financuar nga qeveria e Serbisë. Ka problem me bartjen e këtyre mjekëve në spital meqenëse Republika e Serbisë nuk iu lejon punëtorëve të shëndetësisë të punojnë për dy punëdhënës. Në byro nuk ka mjekë. Në Shtërpsë gjendet shkolla e mesme e mjekësisë. Në Mitrovicë gjendet fakulteti i mjekësisë.

Shtëpia e shëndetit nuk ka fonde të mjaftueshme dhe i mungojnë barnat dhe materiali mjekësor. Mjekja Dragana Mrgjinac thotë se kanë probleme edhe me pajisje meqë në kufi e kërkojnë licencën e Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës.

Shtëpia e shëndetit ka edhe probleme me makinat. Mosha mesatare e makinave është rreth 25 vjeç. Çdo ditë ka raste urgjente të cilat duhet të barten në Nish dhe në Beograd. Këtu bëhet fjalë për pacientët në gjendje më të vështirë. Në Mitrovicë i dërgojnë pacientët në dializë.

Shtëpia e shëndetit ka edhe kirurg si dhe një formë të kujdesit sekondar shëndetësor i cili kujdestaron 24 orë, derisa ndihma e shpejtë punon prej orës shtatë në mëngjes deri në orën shtatë pasdite. Në Drejkoc është një ambulantë ku punojnë serbët dhe shqiptarët. Aty paguhen kontrollet mjekësore sepse ky institucion financohet nga buxheti i Kosovës. Për raste epidemike kujdeset Instituti për Shëndetësi Publike në Mitrovicë. Mitrovica është larg një orë e gjysmë ndërsa Graçanica 40 minuta.

Ekziston problemi me transportin e vaksinave për foshnjat e sapolin-dura. Vaksinat i ofron Instituti Paster nga Parisi nëpërmjet Institutit Torlak nga Beogradi. Ato megjithatë i morën në punktin në Mitrovicë dhe u vendosën në një depo dhe pas kësaj kontrolli mbi to humbi dhe kjo porosi shkoi huq. Në lidhje me këtë rast u informua edhe misioni i OSBE-së mirëpo vaksinat nuk u kthyen. Në kushte ideale afati i vaksinave është katër ditë.

Shtëpia e shëndetit ka pajisje të vjetëruara. Ultrazëri është i prishur. Të gjitha pajisjet janë më të vjetra se 20 vite.

Në Shtërpce, shkalla e natalitetit është më e larta. Serbët martohen shumë të rinj (rreth moshës 20 vjeçare) dhe kanë të paktën nga tre fëmijë.

Arsimi

Sistemi shkollor nuk është i rregulluar. Punëtorët e arsimit dëshirojnë të marin para edhe nga Prishtina, mirëpo pa nënshkruar kontrata me institucionet e Kosovës. Më herët ata kishin nënshkruar kontrata me UNMIK-un, por tash duhet t'i nënshkruajnë ato me Prishtinën. Një numër i vogël i profesorëve i ka pranuar kontratat e reja. Në shkollat serbe, paga është 60.000 dinarë (diç më pak se 600 euro) ndërsa në shkollat kosovare 190 euro. Autoritetet kosovare i njohin shkollat sipas sistemit arsimor serb.

Çdo fshat në komunë ka një shkollë ose së paku një klasë të ndarë. Shkolla fillore dhe shkolla e mesme punojnë në një ndërtesë në Shtërpce.

Numri i orëve për profesorët në Kosovë është 14, respektivisht 16, që është dukshëm më i ulët se norma e orëve në Serbi. Në shkollë punojnë 90 mësimdhënës.

Rreth 10 përqind e mësimdhënësve janë absolvent në fakultetet e tyre. Në shkollë vijojnë mësimet 560 nxënës. Ky numër është tash dy herë më i madh se para 12 vitesh. Drejtimet arsimore në shkollë janë: ekonomik, juridik, hotelierizëm, gjimnazi (me dy drejtime), mjekësor (çdo vit e ndërrojnë profilin), makineri, informatikë, elektroteknik. Më tepër se 50-60 përqind e nxënësve e vazhdojnë shkollimin e tyre. Në 12 vitet e fundit shkollën e kanë përfunduar rreth 1500 nxënës.

Për të rinjtë nuk ka vende të punës. Nuk ka ekonomi e as prodhimtari, thotë Zhivqe Sharkoqeviq, ndihmës i drejtorit të shkollës së mesme në Shtërpce.

Institucionet paralele

Komuna serbe edhe e ka kuvendin komunal i cili zhvillon seancat në sallën e njejtë me kuvendin komunal të Kosovës. Zgjedhjet e fundit për këtë organ u mbajtën më 11 maj të vitit 2008 dhe atij i ka kaluar mandati. Nuk janë mbajtur zgjedhje të reja. Kuvendi komuna është bartur në ndërtesën e ndërmarrjes bujqësore.

Në përbërje të komunës punon qendra për punë sociale, shërbimi amë dhe arkivi. Librat amzë dhe kadastra gjenden në Krushevc. Ende nuk kanë arritur kopjet e vërtetuara të këtyre dokumenteve, sipas marrëveshjes së arritur në mes Beogradit dhe Prishtinës.

Në Shtërpce më tepër se 1300 persona marin paga nga Republika e Serbisë. Edhe 1245 persona tjerë marin paga minimale nga qeveria e Serbisë. Në komunën serbe janë të punësuar 188 persona. Ekziston pasiguri e madhe se çka do të ndodh me gjithë këta njerëz nëse Serbia i ndërpret/tërhek institucionet e saj.

Ekonomia

Në dy-tri vitet e fundit, Qeveria e Kosovës ka investuar rreth 6 milion euro në komunën e Shtërpces, thotë Iliq. Në komunë jetojnë 13.000-14.000 banorë. Shkalla e papunësisë është rreth 50 përqind, ndërsa në mesin e të rinjve edhe më e lartë.

Komisioni Evropian ka ndarë fonde për masterplanin për ndërtimin e qendrës së skijimit në Brezovicë. Plani u publikua në shkurt të vitit 2012. Në shtator të vitit 2012, komuna do të fillojë të kërkojë një investitor të huaj. I tërë mali është në pronësi të komunës. INEX, i cili është pronar i qendrës ekzistuese të rrënuar të skijimit, është ndërmarrje aksionare nga Beogradi me status të pazgjidhur si rezultat i privatizimit të pasuksesshëm. Me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së u ndërpre e drejta e menaxhimit të ndërmarrjes shoqërore gjë që e komplikon edhe më tepër çështjen e pronësisë mbi qendrën e skijimit, thotë Sllagjan Iliq. E tërë qendra e skijimit është në gjendje shumë të keqe. Rruga kryesore Suharekë-Durrës është larg 60 kilometra, por rruga është shumë e keqe. Shpenzimet e vogla jashtë pensionit të turistëve janë shumë të vogla.

Fondi për blegtori është shkatërruar por as në mesin e banorëve nuk ka interesim për zhvillimin e tij. Ky fond dikur kishte 30.000 dele. Sot janë 1000 dele. Ministria e Qeverisë së Serbisë për Kosovë dhe Metohi ka program me komunën për mbjelljen e malinave. Në këtë drejtim, komuna e Shtërpces bashkëpunon me komunën Ariljem nga Serbia. Kontrollat e rrepta të cilësisë i zhvillon Instituti për Pemëtarë nga Çaçaku. Për malina ka pasur më tepër të interesuar sesa fonde. Në 30 hektarë tokë për momentin vjelen deri në 500 tonë malina. Janë edhe dy ftohës privat dhe në eksportin e tyre ndërmjetësojnë afaristët nga Serbia. Tregjet kryesore për to janë në Itali dhe Gjermani. Përveç pemtarisë, banorët meren edhe me tregti të vogël. Produktet ushqimore i blejnë nga shqiptarët nga komunat e rrafshina në afërsi. Banorët meren edhe me mbledhjen e bimëve shëruese, por numri i tyre është gjithnjë e më i vogël.

Parku kombëtar “Mali i Sharrit” e zën një pjesë të konsiderueshme të komunës. Një të tretën e parkut e kontrollon komuna paralele serbe, ndërsa dy të tretat komuna kosovare. Pjesa e parkut kombëtar të cilin e menaxhon komuna kosovare quhet “Parku i Sharrit”.

Komuna kosovare kërkon nga ndërmarrjet tregtare të paguajnë tatim mbi pronë. Këta të fundit e paguajnë paushall. Shërbimet komunale i janë besuar një ndërmarrje serbe. Drujtë blihen nga ndërmarrja “Sharr” ndërsa energjia elektrike nga KEK-u.

Sporti dhe kultura

Shtëpia e kulturës ekziston dhe për dallim nga shumica e komunave ku jetojnë serbët, punon. Ajo organizon koloninë artistike “Vjeshta në Rajonin e Zhupës” dhe shfaqje teatrale nga grupe mysafire.

Komuna e Rahovecit

Decentralizimi

Nga muaji tetor i vitit 2012, në Zyren për komunitete punojnë shtatë persona. Komuniteti serb në Rahovec është komuniteti i vetëm urban serb në Kosovë. Me ardhjen e KFOR-it, serbët nuk kishin asnjë institucion. Shkolla gjendet në qendrën e rinisë, ndërsa në vitin 2001 u ndërtua edhe ndihma e shpejtë dhe qendra për lojëra. Nga viti 2004, kur Vojislav Koshtunica, kryetar i

Partisë Demokratike të Serbisë, erdhi në pushtet në Beograd, gjendja e serbëve në Kosovë u përkeqësua.

Sipas Sllavisha Kollashinac, përfaqësues i Zyres për Komunitete, në qytetin e Rahovecit jetojnë rreth 500 serbë, nga 4000 sosh, që kishin jetuar aty para vitit 1999. Në fshatin e afërt të Hoçës së Madhe jetojnë 500 serbë. Kollashinac pranon se ekziston dëshira për shpërbërjen e institucioneve serbe. Sipas tij, banorët frikësohen nga djegja e mundshme e shtëpive, pas shpërndarjes së fletushkave në Klinë ku serbëve të kthyer i thuhet të kthehen në Serbi. Për shkak të ndjenjës së pasigurisë, mungesës së perspektivës, ushëpimit dhe izolimit në pjesën e epërme të qytetit, asnjë serb nuk ka shkuar në pjesën e përzier të qytetit. Në qytetin e Rahovecit para luftës kanë jetuar rreth 2000 serbë.

Siguria e pronës është njëri ndër problemet kryesore. Vreshtat po shkatërrohen, pullazet dhe materialet e tjera ndërtimore po vidhen nga shtëpitë. Sipas banorëve, policia nuk po ndërmerr asgjë rreth këtyre rasteve. Banorët janë frikësuar edhe pas sulmit ndaj murgut të manastirit Zhoqishtë. Në Zhoqishtë janë ndërtuar 10 shtëpi për persona të kthyer, por ato mbesin të zbrazëta. Sipas Gollub Kujungjiq, kryetar i komunës paralele të Rahovecit, ky kishte qenë vendim i gabuar. Kujungjiq thotë se më mirë do të kishte qenë që këto fonde të përdoren për rindërtimin e disa shtëpive në qytet. Komuna ka ndërtuar katër shtëpi për familje që janë në gjendje të vështirë financiare. Qyteti i Beogradit ka ndarë fonde për ndërtimin e çerdhës. Nga Beogradi arrijnë vetëm thërmija (pjesa dërmuese e fondeve “kapërdihen” në Kragujevc, Kralevë dhe Mitrovicë), thotë Kujungjiq.

Sipas ligjit mbi zonat e mbrojtura, Hoça e Madhe është dashur ta fitoj shkallën e parë të decentralizimit. Ky fshat banohet nga serbët. Shqiptarët e Kosovës brengosen që me këtë ligj do të ndërpriten të drejtat kushtetuese, para së gjithash në fushën e aktiviteteve për shitblerje, më konkretisht në ndalimin e tyre. Kjo pakënaqësi e shqiptarëve ka shkaktuar frikë në mesin e serbëve. Kollashinac thotë që më mirë të mos ekzistoj ky ligj. Ai thotë që ky ligj mund të jetë bllokadë edhe për serbët që jetojnë në Hoçë të Madhe. “Ata duan ta konservojnë Hoçën e Madhe si Hilandarin,” thotë Kollashinac.

Para luftës, në Rahovec është folur një gjuhë e veçantë. “Gjuha e Rahovecit” ishte e folur e dialektit prizrenas-timok me shumë orientalizma në leksikë. Këtë gjuhë e flisnin banorët urban, pa marr parasysh përkatësinë e tyre etnike. As shqiptarët nuk flisnin shqip, e as serbët nuk e flisnin gjuhën letrare serbe. Serbët e parë jetojnë 70 kilometra larg Rahovecit. Rahoveci në Kosovë e ka luajtur rolin e Vukovarit, dhe ishte njëri ndër qytetet e para e përleshjeve në mes ushtrisë dhe policisë serbe dhe pjesëtarëve të UÇK-së. Në Rahovec ka pasur më së shumti viktimë,

rreth 1000 shqiptarë dhe 87 serbë, që sipas përqindjes janë humbje të përafërta për të dy komunitetet. Megjithatë, përkundër kësaj, ende ekziston dëshira që të gjithë të jetojnë së bashku.

Ekonomia

Serbët në Rahovec janë të punësuar në administratë, shëndetësi dhe arsim. Ata i paguajnë detyrimet e tyre rregullisht dhe të gjithë janë të pajisur me dokumente kosovare. Serbët e kësaj ane e shohin të ardhmen e tyre në proceset e integritetit me komunitetin shumicë.

Përveç serbëve që punojnë në administratë, shkalla e papunësisë është e lartë. Ka shumë shembuj të privatizimeve të pasuksesshme. Një shembull i till është vreshta “Orvin”. Para privatizimit aty kishin punuar 1500 punëtorë, ndërsa sot kanë mbetur vetëm 50 sosh. Nga 500 hektarë të vreshtës sot kanë mbetur vetëm pesë përqind.

Në komunën serbe janë të lajmëruar 56 nëpunës, 28 prej tyre vërtetë punojnë, ndërsa 28 të tjerë marin paga minimale nga viti 2003 dhe i marin rreth 11.000 dinarë në muaj (rreth 100 euro). Komuna i ndan ndihmat sociale, pensionet dhe shtesat për fëmijë.

Në Rahovec funksionon shoqata e vreshtave dhe vreshtarëve. Në Hoçë të Madhe gjendet vreshta e Deçanit e cila prodhon verën e famshme. Ekziston ideja që kjo vreshtë e manastirit ta blej rrushin/verën nga banorët e Hoçës së Madhe dhe në këtë mënyrë t’iu ndihmoj rreth plasimit. Pas ishullit kroat të Hvarit, Rahoveci ka më së tepërmi orë me diell. Kjo është shumë e përshtatshme për ndërtimin e prodhimit të verës. Vreshtat e serbëve kryesisht janë të ruajtura dhe të mirëmbajtura, edhe pse ka edhe raste të usurpimeve.

Asnjë ndërmarrje publike nuk e ka punësuar ndonjë serb. Në Hoçë të Madhe dy serbë punojnë në PTT, ndërsa në gjykatë punojnë katër serbë si punëtorë ndihmës.

Arsimi

Komuna e Rahovecit organizon ekskursionet të përbashkëta shqiptaro-serbe në Durrës dhe në Budva. Fëmijët serbë dhe shqiptarë së bashku vijojnë trajnimet për biçiklizëm, respektimin e rregullave të komunikacionit, gjë që ndihmon në integrimin në mes tyre.

Komuna e Ranillugut

Decentralizimi

Zgjedhjet për komunën e Ranillugut u mbajtën më 15 nëntor 2009, dhe më 5 janar 2010 u formua komuna. Kuvendi komunal ka 15 anëtarë dhe të gjithë janë serbë: 11 anëtarë të Iniciativës qytetare për komunën e Ranillugut dhe 4 anëtarë të Partisë për Kosovë e Metohi. Kjo është komuna e vetme serbe në Kosovë të cilën nuk e udhëheq Partia Liberale Serbe e cila ka shumicën në grupin parlamentar serb në Kuvendin e Kosovës. Kryetari dhe zëvendësi i tij janë anëtarë të Lëvizjes Serbe për Ripërtëritje.

Sipas kryetarit të komunës, Gradimir Nikiq, Plani i Ahtisaarit nuk po zbatohet në tërësi. Mungon vullneti politik për zbatimin e plotë të tij. Menaxhimi i pronës është çështje problematike. Gjatë procesit të decentralizimit, toka në pronësi shoqërore në vend se të kalojë nën përgjegjësinë e komunës i është bartur qeverisë qendrore. Si rezultat i moszbatimit të mekanizmave aktual, ekziston mundësia që serbët të tërhiqen nga institucionet kosovare. Për këtë gjendje, sipas Nikiq, janë përgjegjës serbët në qeverinë e Kosovës. Vërejtjet e serbëve lokal për ligjet kosovare, politikanët serbë në Prishtinë i "sakatojnë dhe ndryshojnë deri në pikën ku ato e humbin kuptimin e tyre". Përkundër procesit të decentralizimit, centralizimi është më i fuqishëm, Nikiq thotë.

Komuna e Ranillugut ka rreth 6000 banorë dhe 98.5 përqind prej tyre janë serbë. Megjithatë, 20 përqind e nëpunësve komunal janë shqiptarë. Drejtori i buxhetit komunal dhe financave si dhe shefi i prokurimit në kuvendin komunal janë shqiptarë. Komuna ka bashkëpunim të mirë me policinë e Kosovës. Komuna ka bashkëpunim të shkëlqyeshëm me komunën amë të Kamenicës. Dy komunat kanë nënshkruar memorandum për bashkëpunim të gjithëanshëm dhe ndihmë të ndërsjellë.

Ndërtesa e komunës u shkatërrua gjatë vitit 1999 dhe u renovua në vitin 2001. Ndërtesa gjendet në pronën e komunës. Tash po ndërtohet një ndërtesë e re dhe më e përshtatshme e cila duhet të jetë gati deri në fund të vitit 2012.

Gjykata kompetente për Ranillugun gjendet në Kamenicë. Aty momentalisht nuk punon asnjë gjykatës serb. Gjykatat serbe për Kosovën funksionojnë por janë të shpërndarë nëpër Serbi. Gjykatësit kosovarë kanë paga më të larta se gjykatësit serbë dhe ky është rasti i vetëm kur nëpunësit e institucioneve kosovare kanë paga më të larta se nëpunësit e institucioneve të Serbisë, thotë Nikiq. Ai pret

që nëpunësit e institucioneve të Serbisë do të kthehen në Kosovë dhe se nuk do të mbesin përgjithmonë në Nish, Vranjë e gjetiu.

Qeveria e Kosovës nuk ka plan për integrimin e pjesës veriore të vendit. Nikiq thotë se institucionet në veri të Kosovës duhen legalizuar, ndërsa puna e “cetiri dahije na Severu” duhet të bëhet transparent dhe publik. Ata duhet të japin llogari për punën e tyre dhe t’i nënshtrohen rishikimit, thotë Nikiq. Në komunën e Ranillugut nuk ka pasur asnjë person të shpërngulur prandaj tema e kthimit nuk është aktuale.

Mediat

Në Ranillug është aktiv sinjali nëpërmjet të cilit mund të shikohen kanalet RTS 1 dhe 2. Një serb nga Ranillugu është pronar i rrjetit kabllovik dhe kështu banorët mund të shikojnë edhe TV kabllovik. Gazetat në Ranillug vijnë nga Bujanoci dhe deri tash nuk ka pasur probleme me transportin e gazetave nëpërmjet kufirit. Në Shillovë ka radio stacion dhe televizion, ndërsa komuna ka blerë pajisje për Radio Plus Ranillug dhe ia ka dhënë ato një ndërmarrësi në shfrytëzim me kusht që t’i punësoj tre punëtorë nga Ranillugu. Ndërmarrësi e ka përmbushur kushtin dhe radio stacioni tash funksionon. Në territorin e komunës ka edhe lidhje të internetit ADSL. Në Ranillug janë ruajtur edhe transmetuesit e Telenorit kështu që aty funksionon edhe rrjeti i telefonisë mobile 063. Janë ruajtur edhe rrjetet e vjetra të telefonisë fikse.

Si problem kryesor të mediave, përfaqësuesit e komunës e veçojnë mungesën e përcjelljes së zhvillimeve në Prishtinë në gjuhën serbe. Ekziston kanali RTK 2 në gjuhën serbe mirëpo momentalisht ai transmeton vetëm “kolazh program” i cili në gjuhën serbe raporton rreth një orë në ditë që nuk është e mjaftueshme.

Arsimi

Komuna, në vitin 2010, nuk e nënshkroi memorandumin me Ministrinë për Arsim të Kosovës mbi autonominë e shkollave. Problemi qëndronte në faktin që memorandumit parasheh anashkalimin e komunës dhe ia jep fjalën kryesore qeverisë së Kosovës, gjë që sipas Nikiq, paraqet centralizim.

Nëpërmjet komunës ndahen granti (fondet buxhetore) për arsim. Ndahen pagat për 68 nëpunës, ndërsa të punësuar janë 215. Të tjerët paguhën nga buxheti i Republikës së Serbisë. Fondet nga buxheti i Serbisë paguhën nga komuna paralele e Kamenicës. Mësimdhënësit në Kosovë marin 150 përqind të

pagave të mësimdhënësve në Serbi - rreth 55.000 dinarë (rreth 500 euro). Deri para dy vitesh, ky dallim ishte 200 përqind.

Në territorin e Ranillugut janë dy shkolla fillore, dy shkolla të mesme dhe një institucion parashkollor. Të gjitha 36 fshatrat e komunave të Ranillugut dhe Kamenicës kanë çerdhe dhe dispanserë për fëmijë.

Në komunë është e dukshme nevoja për mësimin e gjuhës shqipe në shkollat serbe dhe anasjelltas. Që nga fillimi i shpërbërjes së Jugosllavisë, para 20 viteve, fëmijët nuk mësojnë në gjuhë të tjera. Për këtë arsye, që nga 1 qershori 2012, komuna e ka nisur kursin për mësimin e gjuhës shqipe. Prioritet i arsimit duhet të jenë gjuha shqipe, gjuha angleze dhe informatika. Në vitin 2009 u organizuan ekskursione të miqësisë ku morën pjesë fëmijë serbë dhe shqiptarë. Në Ranillug nuk ka asnjë shkollë në gjuhën shqipe, mirëpo transporti komunal çdo ditë bart fëmijët deri në shkollën më të afërt shqipe në komunën e Kamenicës. Komuna është në negociata me Oliver Kariq, drejtor i Universitetit BK, për vendosjen e një fakulteti në Ranillug.

Shëndetësia

Komuna ka vetëm kujdes primar shëndetësor. Të gjithë nëpunësit në sektorin e shëndetësisë paguhen nga Ministria e Shëndetësisë e Qeverisë së Serbisë. Komuna e Ranillugut pagan rrogat e disa motrave medicinale. Komuna stimulon natalitetin dhe jep 200 euro për çdo foshnje të posalindur. Prindërit që kanë tre dhe më tepër fëmijë marin nga 30 euro në muaj. Nataliteti në komunë është në rritje e sipër.

Institucionet paralele

Deri më tani nuk ka pasur bashkëpunim me komunën paralele të Kamenicës, mirëpo kjo gjendje po ndryshohet. Komuna serbe ka gjithnjë e më pak kompetenca me të cilat do t'iu ndihmonte njerëzve me probleme konkrete. Në anën tjetër, banorët e komunës shohin dobi nga ekzistimi i institucioneve të Serbisë sepse nëpërmjet tyre marin pagat dhe shtesat sociale. Për banorët e Ranillugut ndërprerja e këtyre do të paraqiste problem të madh.

Ekonomia

Banorët e komunës së Ranillugut meren kryesisht me bujqësi. Ekziston një tjegullore e cila është pronë e një shqiptari dhe aty punojnë serbët dhe shqiptarët (50-50%).

Rreth 90 përqind e buxhetit komunal përcaktohet nga territori i komunës dhe numri i banorëve. Ranillugu në këtë drejtim është në gjendje të palakmuar në krahasim me të kaluarën kur ishte pjesë e komunës dukshëm më të madhe të Kamenicës. Si pjesë e buxhetit është edhe granti themelor, granti për arsim dhe granti për shëndetësi. Është punuar mjaft në përmirësimin dhe ndërtimin e infrastrukturës (rrugët, ngrohja qendrore, ujësjellësi). Komuna planifikon të hartoj projekte si pjesë e Programit për punësimin e përkohshëm të fuqisë punëtore.

Nëse do të ketë sundim të ligjit anembanë Kosovës, për disa vite Ranillugu do të jetë qytezë e bukur, thotë kryetari Nikiq. Në Ranillug së shpejti pritet të filloj ndërtimi i banjës. Sipas Nikiq, investitorët do të investojnë 48 milion euro.

Organizatat e shoqërisë civile

Organizata joqeveritare Qendra për afirmimin shoqëror të të rinjve është organizata e vetme e shoqërisë civile në këtë komunë. Sipas kryetarit të saj, Zoran Stanković, organizatës i është lejuar të përcjell seancat e kuvendit komunal të Ranillugut.

Qendra ka marr pjesë në organizimin e Këshillit Rinor të Ranillugut, i cili ka 7 anëtarë. Këshilli është regjistruar si organizatë e shoqërisë civile edhe pse më herët është konsideruar mundësia që të formohet si organ komunal. Këshilli bashkëpunon me Këshillin Qendror Rinor të Kosovës, i cili u formua nëpërmjet projektit Deutschen Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), OSBE-së dhe Ministrisë për Rini të Kosovës.

Të rinjtë në Kosovë janë ndër grupet më të ndjeshme. Duhet zhvilluar hulumtime mbi nevojat e të rinjve në zonat lokale. Duhet përfshirë edhe komunat dhe organizatat ndërkombëtare në zgjidhjen e këtij problemi. Problemi më i madh gjithmonë janë financat, dhe komuna e Ranillugut nuk ka fonde për t'iu ndihmuar të rinjve dhe shoqërisë civile.

Stanković thotë së kanë bashkëpunim të mirë me Qendrën për Paqë dhe Tolerancë në Graçanicë dhe që janë pjesë e Rrjetit Kosovar për Veprim (i cili përfshin rreth 90 përqind të OJQ-ve serbe). Nuk ka kontakt e as bashkëpunim me organizatat nga veriu i Kosovës. "Bashkëpunimi në mes organizatave joqeveritare serbe dhe shqiptare ekziston vetëm si rezultat i presionit nga bashkësia ndërkombëtare," thotë Stanković.

Sporti dhe kultura

Qendra për afirmimin shoqëror të rinjve ka nisur teatrin amator serb të Anamoravës së Kosovës me rreth 30 aktorë amatorë dhe shoqërinë kulturore-artistike me rreth 180 anëtarë. Këto organizata meren me kulturë dhe kanë dytri shfaqje në vit. Ato marín pjesë në festivalin e teatrove amatore të Serbisë i cili mbahet çdo vit në Mali Crniq të Pozharevcit. Qendra e Kulturës, ku këta të rinj i zhvillojnë aktivitetet e tyre, praktikisht është në gjendje të përdorshme, pa banjo, ngrohje dhe është plotësisht i shkatërruar. Atyre iu mungojnë fondet, ndërsa jeta shoqërore është pothuajse joekzistente. Stanković thotë se duhet të ketë më tepër programe për arsimin joformal të të rinjve.

Komuna e Novobërdës

Decentralizimi

Komuna e Novobërdës u formua në vitin 1989 në hapësirë prej 92 kilometrave katrorë dhe 70 përqind e banorëve ishin serbë. Kjo është komuna e parë në Kosovë ku pas vitit 1999 serbët dhe shqiptarët filluan të punojnë së bashku. Çdo vit, numri i serbëve që iu bashkuan institucioneve është në rritje. Në zgjedhjet e vitit 2003, serbët fituan shumicën në kuvendin e komunës (nga 17 këshilltarë, 10 ishin serbë). Serbët i bojkotuan zgjedhjet e vitit 2007, për shkak të fushatës kundër zgjedhjeve të udhëhequr nga Beogradi. Këtë mos-përputhje të strukturës etnike të komunës dhe rezultateve zgjedhore e zgjidhi Joachim Ruecker, shef i atëhershëm i UNMIK-ut. Sipas vendimit të tij, Bajrush Imeri u emërua kryetar i komunës, ndërsa këshilltarëve serbë nga përbërja e kaluar (10) iu zgjat mandati dhe atyre iu shtuan edhe shtatë përfaqësues të sapozgjedhur shqiptarë në proporcion me rezultatet e zgjedhjeve.

Territori i komunës në vitin 2009 u zgjërua duke i përfshirë fshatrat serbe nga komunat fqinje: nëntë kadastrale dhe përfshin 204 kilometra katrorë dhe më prurjet e reja është zgjeruar për 120 përqind. Serbët nuk morën pjesë as në zgjedhjet e vitit 2009. Serbët të cilët morën pjesë e përkrahën Radovan Deniq, i cili sot është nënkryetar i kuvendit komunal. Në kuvendin komunal janë 15 këshilltarë (10 shqiptarë dhe 5 serbë).

Serbët përbëjnë shumicën në polici. Deri para një viti, komandanti i policisë ishte serb, ndërsa tash ushtruesi i detyrës së komandantit është shqiptar.

Procesi i emërimit të komandantit të ri është në zhvillim e sipër dhe ai sipas të gjitha gjasave do të jetë serb.

Një i ri serb nga Novobërda ka aplikuar në Forcën e Sigurisë së Kosovës (ushtria). Komuna ia ka siguruar transportin deri në Ferizaj ku ai merr pjesë në stërvitje. Sipas Imerit, ai kurrë deri sot kurrë nuk e ka ndjerë vetën të diskriminuar në FSK për shkak të përkatësisë së tij etnike. Imeri thotë që në këtë komunë nuk ka pasur raste të dhunës që nga marsi i vitit 2004.

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka dhënë një milion euro për këtë komunë dhe këto fonde për shfrytëzohen për ndërtimin dhe renovimin e infrastrukturës. Këto fonde ishin pjesë e programit të Qeverisë së Kosovës nga i cili u ndan fonde për komunat e reja të formuara sipas Planit të Ahtisaarit, thotë Imeri. Në Stanishar, Pasjak dhe Labjan janë hapur tri zyra komunale. Në të tri zyret, sipas ditëve të caktuara të javës, punon një shqiptare dhe një serb. Ata meren me lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve.

Me ndihmën e aktivitetit të komunës dhe këtyre zyreve, rreth 90 përqind e banorëve janë pajisur me dokumente të Kosovës.

Në Novobërdo nuk ka gjykatë komunale. Gjykata kompetente për këtë komunë gjendet në Prishtinë dhe atje punojnë edhe gjykatës serb, ndërsa zonat e reja kadastrale iu takojnë gjykatave që iu kanë takuar edhe më herët (Gjilani, respektivisht Kamenica). Reforma e rrjetit të gjykatave është në proces e sipër. Rrjeti do të ndahet në pesë rajone, ndërsa gjykatat themelore do të veprojnë në shtatë qendrat kryesore të vendit. Këto gjykata do të kenë degë në komunat fqinje të rajonit të tyre. Sot në Novobërdë vepron Zyra për bashkëpunim me gjykata, aty punojnë dy serbë, mirëpo askush nuk i drejtohet kësaj zyre që një kohë për shkak të mungesës së rreziqeve ndaj sigurisë.

Komuna kosovare i organizon edhe zgjedhjet në fshatra. Në 33 fshatra do të mbahen zgjedhjet nga të cilat do të emërohen këshillat dhe kryetarët e fshatrave.

Ekonomia

Edhe para luftës (1999), Novobërda ka qenë komunë pa industri të zhvilluar. Banorët kryesisht meren me bujqësi dhe blegtori. Ata i shesin produktet e tyre në tregjet e gjelbra. Në Labjan gjendet tregu i përbashkët serbo-shqiptar.

Komuna ka rreth 10.000 banorë. Numri i të papunëve është i madh. Në këtë kategori, të rinjtë janë në pozitën më të keqe.

Qeveria komunale ka organizuar linjë të autobusit pa pagesë nga Novobërdo në Prishtinë tri herë në ditë. Kjo lehtëson lëvizjen e personave që punojnë në komunat fqinje apo të atyre që kryejnë punë administrative në Prishtinë apo në Graçanicë.

Sporti dhe kultura

Novobërda ka skuadër multietnike të futbollit. Deri tani nuk ka pasur incidente me motive etnike. Lojëtarët dhe tifozët, serbë dhe shqiptarë, së bashku shkojnë në lojë jashtë dhe së bashku e përkrahin skuadrën e tyre. Ndeshjen e zhvilluar në Prishtinë e ndoqën së bashku lojëtarët dhe tifozët nga të dyja komunitetet.

Arsimi

Komuna e ka ndërtuar shkollën e mesme ekonomike e cila do të duhej të ishte multietnike. Megjithatë nuk ka pasur nxënës të interesuar edhe pse qeveria britaneze i kishte ndarë fondet dhe mësimdhënësit veçmë ishin përzgjedhur nëpërmjet konkursit.

Qeveria në Prishtinë jep donacione për rindërtimin e shkollave të të gjitha komuniteteve etnike. Për renovimin e një shkollë të rrënuar serbe, qeveria në Prishtinë kishte dhënë 32.000 euro.

Profesorët dhe mësimdhënësit që paguhen nga buxheti i Qeverisë së Kosovës kanë normë shumë më të lartë se kolegët e tyre që punojnë sipas planit serb. Në shkollat serbe punojnë 274 nëpunës, dhe 139 prej tyre marrin paga edhe nga buxheti i Kosovës. Ata që paguhen edhe nga Prishtina gjendeshin në listat e vjetra si në Novobrdë, ashtu edhe në pjesën rishtazi të pranuar të Gjilanit dhe Kamenicës.

Komuna mund të financoj më së tepërmi 339 nëpunës nga buxheti i saj. Në ndihma të shpejta punojnë shumë mjekë dhe nëpunës që paguhen nga buxheti i Serbisë. Sektori i arsimit dhe i shëndetësisë do të duhet të racionalizohen dhe ta ulin numrin e nëpunësve të tyre në nivel të pranueshëm.

Institucionet paralele

Sreten Ivanoviq kishte qenë drejtor i komunës paralele të Novobërdës deri në vitin 2008. Pastaj në maj të vitit 2008, administrata paralele u bart në fshatin Prekovc. Komuna kosovare e injoron aktivitetin e administratës paralele, por kanë raporte të mira. Nëpunësit e dy komunave kanë punuar së bashku deri në vitin 2008. Kryetari Imeri e përmend rastin e një këshilltari të komunës serbe i cili është njëkohësisht edhe anëtar i kuvendit komunal kosovar. Imeri dhe Deniq thonë se institucionet serbe do të shuhen vetvetiu.

Qëndrimi i Beogradit ndaj Veriut të Kosovës – keqpërdorimi i qytetarëve

Veriu i Kosovës aktualisht është pikë neuralgjike për tërë Ballkanin Perëndimor. Beogradi zyrtar është përpjekur me ndarjen e Kosovës ta bëjë rikompozimin e Ballkanit, para së gjithash Bosnjes e pashmangshëm edhe Maqedonisë. Me qasjen e tij, Beogradi edhe një herë ka dëshmuar që më tepër është i interesuar në territore sesa në serbët e Kosovës. Prioritet i Beogradit është Republika Serbe, dhe Kosova shërben si argument për të drejtën e njëjtë në vetëvendosje të Republikës Serbe. Deklarata e pavarësisë së Kosovës ka qenë hyrje në radikalizim si në Kosovë ashtu edhe në Republikën Serbe. Milorad Dodik, brenda katër viteve ia doli të shkatërroj të gjitha arritjet në integrimin e Bosnjes dhe Hercegovinës dhe të vëjë në pyetje ekzistencën e Bosnjes dhe Hercegovinës si shtet.

Politika për vazhdimin e gjendjes ekzistuese të cilën Beogradi e negocoi që nga viti 1999 në veri, u rrënuar në vjeshtë të vitit 2011 kur bashkësia ndërkombëtare e bëri të qartë që kjo më nuk ishte e mundur dhe kur përkrahu aksionin e njësive speciale të policisë së Kosovës (ROSU) në vendkalimet kufitare me Serbinë. Megjithatë, politikën e status kuos vazhdojnë të përkrahin disa struktura të caktuara në mesin e të cilave është pjesa dërrmuese e akterëve nga veriu i Kosovës dhe disa OJQ serbe në Kosovë²¹. Sipas këtyre ideve, zgjidhja e statusit të veriut do të duhej të shtyhej për disa dekada. Kjo është taktika e pritjes së “momentit të duhur” për rihartimin e kufijve, dhe pritjes së momentit kur bashkësia ndërkombëtare e rraskapitur nga angazhimi në Ballkanin Perëndimor t’i lëshoj pe serbëve. Ka gjithnjë e më tepër shenja që një skenar i tillë do të ishte i paqëndrueshëm nga këndvështrimi i sigurisë së njerëzve, sundimit të ligjit dhe lirisë së lëvizjes së njerëzve dhe mallrave. Edhe pse Beogradi zyrtar insiston në statusin e autonomisë së veçantë për veriun e Kosovës, ka gjithnjë e më tepër shenja se politikanët në Serbi po e kuptojnë realitetin e kufirit me Kosovën.

Banorët e Serbisë dhe të Kosovës janë peng i gjendjes në veri të Kosovës. Qeveria e Kosovës nuk ka mundësi ta qeveris një pjesë të territorit të saj, derisa me anë të përkrahjes së udhëheqësve radikal serb në veri Serbia dukshëm e ka ngadalësuar procesin e integritetit të saj evropian.

21 Biseda e përfaqësuesit të Komitetit të Helsinkit me përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë

Në Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan nuk ka sundim të ligjit dhe Komiteti i Helsinkit ka dëgjuar nga shumë qytetarë të këtyre viseve se ata jetojnë në frikë. Pjesëmarrja në barrikada praktikisht është shndërruar në detyrim dhe kjo po i largon njerëzit nga aktivitetet e tyre të përditshme dhe po e vendos jetën e tyre në rrezik. Përfaqësuesit e moderuar politik dhe organizatat e shoqërisë civile nuk mund të punojnë në veri të Kosovës. Banorët iu kanë ankuar Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut për sulme të shpeshta fizike (përfshirë këtu edhe vendosjen e mjeteve shpërthyes) ndaj atyre individëve që i kundërvihen politikës së udhëheqësve radikal serb apo që kanë kontakte me përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare ose të institucioneve kosovare.

Para së gjithash nën ndikimin e mediave me seli në Serbi, banorët e veriut të Kosovës i shikojnë me mosbesim institucionet kosovare. Në anën tjetër, forcat policore të Kosovës nuk mund të veprojnë në këtë rajon me kapacitet të plotë dhe aktivitetet e tyre kryesisht reduktohen në regjistrimin e veprave penale siç janë vjedhjet dhe dhuna ndaj banorëve. Autoritetet policore në Mitrovicë i thanë Komitetit të Helsinkit në vjeshtë të vitit 2011 që politika ka ndikim të madh në punën e tyre dhe që qendra e policisë në Prishtinë me kujdes i shmanget reagimeve të fuqishme të forcave të saj policore në mënyrë që të mos vij tek eskalimi i konfliktit.

Përveç kësaj, ka edhe shqiptarë që dëshirojnë të kthehen në pronat e tyre në veri të lumit Ibër, mirëpo akoma nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë.

Serbia në mënyrë implicite ka dashur gjatë dialogut për çështje teknike ta imponoj edhe çështjen e zgjidhjes politike për veriun e Kosovës, mirëpo nuk ia doli për shkak të konsensusit në bashkësinë ndërkombëtare (BE dhe SHBA) që çështja e veriut nuk mund të jetë në agjendën e këtyre bisedimeve.

Nën presionin e fuqishëm të bashkësisë ndërkombëtare, kriza në veri të Kosovës dëshmoi lidhjet e dobëta në mes Beogradit (para së gjithash Partisë Demokratike) dhe udhëheqësve serb të veriut të Kosovës. Për shembull, Qeveria e Serbisë nuk përkrahu udhëheqësit serb në veri të Kosovës në organizimin dhe mbajtjen e referendumit (15-16 shkurt 2012) ku u deklaruan për (mos) pranimin e institucioneve kosovare. Sipas zyrtarëve në Beograd, kjo ishte herë e parë që serbët e Kosovës nuk i pranuan sugjerimet e Beogradit. Referendumi “A i pranoni institucionet e ashtuquajtura të Republikës së Kosovës” u mbajt në shkurt të vitit 2012, pa përkrahjen e Qeverisë së Serbisë, në katër komunat e Mitrovicës Veriore, Zveqanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit. Edhe pse kryetari i komunës së Leposaviqit, anëtar i Partisë Demokratike, ishte udhëheqësi

i vetëm në veri që e kundërshtoi referendumin, edhe në këtë komunë u votua. Ministri serb për Kosovë dhe Metohi, Goran Bogdanoviq, deklaroi që kjo ishte hera e parë që “serbët nga Kosova nuk e dëgjuan qeverinë e Serbisë”²². Sipas vlerësimit të tij, referendumi është i panevojshëm “sepse do ta vështirësoj procesin negociator”. Duke përdorur shprehje se kjo është e “rrezikshme”, “fatale” dhe se bëhet fjalë për “lojë me vullnetin e popullit”, Bogdanoviq e shprehi qëndrimin që rezultatet e referendomit “nuk do të kishin peshë politike as për këtë qeveri dhe as për asnjë qeveri të ardhshme”. Dihet paraprakisht, thotë ai, që “jo 90 dhe 95 përqind, por 100 përqind e serbëve në veri të Kosovës janë kundër institucioneve kosovare”.

Përveç kësaj, Qeveria e Serbisë, e udhëhequr nga Partia Demokratike, vlerësonte se do të pësonte humbje të madhe politike në planin e integriteteve evropiane nëse do të insistonte në mbajtjen e zgjedhjeve lokale në maj të vitit 2012 në Kosovë dhe nëse do të merrte pjesë në organizimin e tyre. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që Qeveria e Serbisë në tërësi ka hequr dorë nga përkrahja e institucioneve paralele në veri të Kosovës, sepse është paralajmëruar strategjia e re-e vjetër e qeverisë serbe: formimi i kuvendeve të përkohshme komunale pa zgjedhje. Edhe në mungesë të përkrahjes formale nga Beogradi zyrtar, zgjedhjet lokale u mbajtën edhe për komunat paralele. Beogradi nuk i njohu rezultatet e votimeve të organizuara nga vet serbët në Zubin Potok dhe në Zveqan.

Gjatë vitit të kaluar për herë të parë filloi të vërehet dallimi në mes udhëheqësve politik të serbëve në veri të Kosovës dhe Qeverisë në Beograd, më konkretisht Partisë Demokratike. Në tetor të vitit 2011, ministri për Kosovë dhe Metohi Goran Bogdanoviq i akuzoi se po flasin diçka në takim me kryetarin (e Republikës) dhe se po thonë diçka krejt tjetër para gazetarëve. Entuziazmi të cilin Beogradi e shfaqti fillimisht (edhe me përkrahjen e madhe të mediave) për bllokimin e rrugëve dhe vendkalimeve kufitare me Kosovën, u shua pas rekomandimit të Komisionit Evropian që Serbia ta merrte statusin e kandidatit (12 tetor). Atëbotë shiheshin qartë lëkundjet serioze në raportet në mes udhëheqësve nga Kosova dhe negociatorit në dialogun me Prishtinën, Borisllav Stefanoviq. Avokatët që përfaqësojnë udhëheqësit serb nga Kosova parashtruan kallëzim penal ndaj Stefanoviqit për shkelje të Kushtetutës.

Udhëheqësit politik të katër komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës e pritën në barrikada vendimin e Komisionit Evropian për dhënien e statusit të kandidatit Serbisë.

22 Dnevnik, 13 shkurt 2012.

Ata e treguan mosbesimin e tyre ndaj Beogradit edhe nëpërmjet petitionit ku kërkuan nënshetësi ruse. Peticionin (me më shumë se 20.000 nënshkrime) ia dorëzuan ambasadorit rus në Beograd, Aleksandar Konuzin²³, me kërkesën për nënshetësi ruse. Dmitrij Rogozin ishte zyrtari i vetëm rus që përkrahi kërkesën e tyre, duke iu ofruar strehim në Rusi nga siç e quajti ai “burgut shqiptar kosovar” sepse, siç shtoi, “kemi aq shumë fshatra, qytete dhe territore të braktisura të cilat duhet t’i fitojmë. Prandaj a nuk mund t’ia lejojmë vetes t’i pranojmë 20.000 njerëz, t’iu japim nënshetësi dhe t’i fusim jo në programin e migrimit por në programin e riatdhesimit”²⁴. E gjithë kjo zgjati deri në momentin kur Presidenti i Rusisë, Dmitrij Medvedev, personalisht tha që sipas ligjit rus mbi nënshetësinë serbët nga Kosova nuk mund të marrin nënshetësi ruse, por mund të llogarisin në përkrahje dhe ndihmë humanitare²⁵.

Një ide tjetër që qarkulloi për një kohë të shkurtër ishte shpallja e pavarësisë së territoreve të katër komunave serbe. Propaguesi i “zonës autonome”, kryetari i komunës paralele të Mitrovicës, Radenko Nedeljković tha që “kjo do të arrihet” “nëse vazhdohet me presionin dhe terrorin ndaj serbëve si gjatë tre muajve të fundit”²⁶.

Kryetari i ri i Qeverisë së Serbisë, në atë kohë zëvendës kryeministër dhe ministër për punë të brendshme, Ivica Dačić, akoma i përkrahte zgjidhjet radikale, prandaj deklaroi që absolutisht e përkrah qëndrimin e serbëve në krahinë që nuk dëshirojnë të jetojnë në Kosovën e pavarur: “Kush mund t’ua mohoj këtë të drejtë atyre? Pse iu kanë pranuar këtë të drejtë shqiptarëve që nuk dëshirojnë të jetojnë në Republikën e Serbisë?”²⁷

Orkestrimi i serbëve në Kosovë ta përkujton orkestrimin e serbëve në Kroaci dhe në Bosnje e Hercegovinë prapa së cilit qëndronte e tërë elita serbe, përveç Partisë Liberal-Demokratike (LDP), disa partive më të vogla dhe një pjesë e shoqërisë civile. Poashtu duhet marr parasysh edhe Rusinë e cila formalisht nuk e kundërshton anëtarësimin e Serbisë në BE (vija e saj e kuqe është anëtarësimi në NATO) por e ka me rëndësi strategjike që të mbetet prezente në rajon.

23 Kjo ishte iniciativë e Ambasadës Ruse me qëllim që të tregonte se Boris Tadić nuk gëzon besimin e serbëve të Kosovës.

24 Politika, 17 nëntor 2011.

25 Rusia dërgoi ndihmë humanitare që përbante çadra dhe pajisje për kamping.

26 Politika, 21 nëntor.

27 Po aty.

Porositë e Angela Merkel gjatë vizitës së saj në Beograd në gusht të vitit 2011, më së shumti i kanë prekur “përgjegjësit për Kosovën” në qeverinë e Serbisë dhe udhëheqësit serb në veri të Kosovës. Zyrtarët e Ministrisë për Kosovë dhe Metohi pohojnë që në rrethanat aktuale nuk ka zgjidhje alternative për strukturat “paralele” sepse ato sipas tyre janë garancioni i vetëm për mbijetesën e serbëve në Kosovë. Udhëheqësit politik të serbëve në veri të Kosovës, Marko Jakshiq dhe Milan Ivanoviq, pohojnë që kërkesat e Merkel janë të papranueshme për serbët në veri si dhe për serbët në tërë territorin e Kosovës. Në rast se qeveria në Beograd lëshon pe ndaj presionit të Perëndimit, ata paralajmërojnë rezistencë jo të dhunshme dhe “betejë politike institucionale jo vetëm të serbëve nga veriu por edhe forcave nacionale në mbarë Serbinë”²⁸.

Qëndrim diametralisht të kundër më qëndrimin e udhëheqësve serb në veri ka zëvendës kryeministri i Kosovës, Slllobodan Petrovqi, i cili thotë që shteti i Serbisë duhet t’i ketë interesat e veta në mesin e të cilave ndër më të rëndësishëm është anëtarësimi në BE: “Jam i bindur që autoritetet në Serbi do ta kuptojnë që në këtë rrugë është e rëndësishme për ta që t’i ndërprejnë strukturat paralele të pushtetit në veri”²⁹.

28 Danas, 24 gusht 2011.

29 Politika, 24 gusht 2011.



Bisedat me banorët e veriut të Kosovës

Përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit kanë biseduar me politikanë, zyrtarë, gazetarë, përfaqësues të organizatave joqeveritare, si dhe me banorë të veriut të Kosovës, gjatë periudhës janar - qershor 2012. Këta akterë nga veriu i Kosovës i takuam në raste të ndryshme, në tryeza të rrumbullakëta, në seminare, në konferenca, dhe në disa raste qëndruam në pjesën veriore të Mitrovicës³⁰. Disa banorë të Mitrovicës Veriore dhe të vendeve tjera në këtë rajon dyshojnë se mund të kalojnë sigurtë urën dhe të shkojnë në pjesën jugore të Kosovës. Prandaj ata zakonisht kërkonin që t'u sigurohej transporti në pjesët jugore të Kosovës, që të udhëtojnë së bashku me dikë tjetër "sepse ashtu ndihen më të sigurt". Shumica e këtyre takimeve ishin të mbyllura për publikun, më konkretisht zhvilloheshin sipas rregullave "Chatham House Rules". Prandaj, në këtë hulumtim, Komiteti i Helsinkit nuk do t'i përmend emrat dhe organizatat e bashkëbiseduesve.

Meqenëse tema kryesore e këtij hulumtimi është zbatimi i Planit të Ahtisaarit, duhet marr parasysh që kjo është pjesa e vetme e Kosovës ku edhe në qershor të vitit 2012 kjo zgjidhje akoma nuk është zbatuar dhe ku ka kundërshtim të fuqishëm ndaj zbatimit të planit. Prandaj, në këtë pjesë të Kosovës, puna e hulumtuesve u orientua në mundësinë e zbatimit të Planit të Ahtisaarit në të ardhmen e afërt. Edhe pse përfaqësuesit e serbëve edhe në veri të Kosovës edhe në Beograd, para së gjithash politikanët, mediat, përfaqësues të caktuar të shoqërisë civile dhe analistë, pohojnë që Plani i Ahtisaarit nuk ka

30 Megjithatë, shumica e bashkëbiseduesve treguan bojazan që të bisedojnë me ne në territorin e Mitrovicës Veriore duke u arsyetuar me reagimin negativ të banorëve të tjerë dhe të grupeve radikale.

asnjë perspektivë në veri, hulumtimi jonë megjithatë flet për një realitet diçka më të ndryshëm.

Ka shenja që zgjidhja alternative për institucionet paralele në veri të Kosovës është formimi i komunave sipas Planit të Ahtisaarit.

Në fakt, ka kohë që në veri të Kosovës veprojnë institucione që nuk janë të financuara nga buxheti i Serbisë dhe të cilat punojnë në përmirësimin e jetës së përditshme të banorëve në kontakte të drejtpërdrejta me qeverinë kosovare në Prishtinë dhe me bashkësinë ndërkombëtare. Gjatë gjithë kohës së ekzistencës së tyre, banorët në veri të Kosovës si dhe ata në Serbi kanë pasur shumë pak njohuri rreth aktiviteteve e madje edhe vet ekzistencës së këtyre institucioneve.

Kështu, një numër i vogël i serbëve të Kosovës në veri (si dhe në Serbi) janë të njohur me punën e ekipit përgatitor për zbatimin e Planit të Ahtisaarit në Mitrovicën Veriore. Në qershor të vitit 2012 përfundoi punon ekipi përgatitor dhe nisi punën Zyra Administrative për Mitrovicën Veriore, më konkretisht administrata komunale e Mitrovicës Veriore e formuar sipas Planit të Ahtisaarit.

Për momentin, zyra administrative e Mitrovicës Veriore do të ketë buxhet vjetor prej 4 milion euro për shërbime bazike për komunitetin dhe objektet infrastrukturore në pjesën veriore të Mitrovicës (burim: Radio Evropa e Lirë, 21 qershor 2012).

Adriana Hoxhiq, e cila më parë ishte kryesuese e ekipit përgatitor, u zgjodh kryetare e zyrës më 20 qershor 2012. Zyra administrative ka për detyrë të ofroj shërbime për banorët dhe të bashkërendoj investimet në këtë pjesë të Kosovës, përgjegjësi të cilat për dy vite i kishte pasur ekipi përgatitor. Formimi i zyrës së re hap mundësi të reja për banorët e veriut të Kosovës.

Në konkursin për 55 vende të punës në këtë zyre u lajmëruan më tepër se 1000 kandidatë, gjë që dëshmon interesimin e madh në mesin e banorëve për t'u inkuadruar në rrjedha normale, në punën e institucioneve dhe në sundim të ligjit. Nga numri i përgjithshëm i 1000 kandidatëve, 200 prej tyre janë nga Mitrovica Veriore. Në kohën e formimit të ekipit përgatitor, i cili ishte pararendës i administratës komunale, 90 banorë aplikuan për punë në këtë ekip. Edhe kjo rritje në numrin e kandidatëve për vende të punës është dëshmi për ndryshimet e qarta në pjesën veriore të Kosovës. Kohë më parë është përfunduar edhe ndërtesa e re e administratës së Mitrovicës Veriore.

Përfaqësuesit e Qeverisë së Serbisë e shohin hapjen e zyres si provokim³¹, derisa udhëheqësit lokal serb i dërgojnë edhe mesazhe kërcënuese administratës së re.

Gjatë pjesëmarrjes së serbëve në barrikadat në veri në qershor të vitit 2012, kryetari i Alternativës Demokratike Dejan Radojeviq deklaroi “nuk ka serb, nëse nuk i llogarisim këtu ata të cilët që një kohë të gjatë iu janë bashkuar institucioneve kosovare, që nuk është i gatshëm ta jap jetën në mbrojtje të Mitrovicës Veriore sepse e dimë që me rëniën e saj do të rrënohej çdo gjë serbe në Kosovë dhe Metohi”. “Përkundër kundërshtimit tonë, e ashtuquajtura qeveri e Kosovës po e vazhdon prezencën e saj dhe ndërtimin e ndërtesës së komunë së ardhshme të Mitrovicës Veriore dhe në këtë mënyrë po provokon incidente,” tha Radojeviq³². Ai poashtu shtoi që përveç vendimit për “gjendje të jashtëzakonshme”, shtabi komunal i krizës i ka paralajmëruar të gjithë serbët që do të bartin pasoja nëse i pranojnë 55 vendet e lira të punës në zyren e komunës kosovare të Mitrovicës Veriore.

Përkundër deklaratave injoruese e madje edhe kërcënuese të zyrtarëve dhe udhëheqësve lokal serb të përkrahur nga Beogradi, ka pasur indikacione që në fund të mandatit të tyre përfaqësuesit e Qeverisë së Serbisë (Partisë Demokratike) filluan t’i përmirësojnë raportet e tyre me (nga biseda e përfaqësuesit të Komitetit të Helsinkit) përfaqësuesit e zyres kosovare në Mitrovicën Veriore, pa marr parasysh barrikadat dhe problemet që i shkaktojnë ato. (Për lëshimin pe të Beogradit flet edhe fakti që njëri nga kandidatët për kryesues të zyres së Mitrovicës Veriore ishte përfaqësuesi i një partie me seli në Beograd e cila do të jetë pjesë e qeverisë së re).

Udhëheqësit serb në jug të lumit Ibër e përkrahin administratën e re në Mitrovicën Veriore. Sipas informatave të Komitetit të Helsinkit, administratën e re e përkrahin edhe disa pjesë të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, njëra ndër institucionet më të rëndësishme për serbët e Kosovës. Njëra prej udhëheqësve të serbëve të Kosovës dhe drejtoreshë e Shtëpisë së Shëndetit në Graçanicë, Rada Trajković, pas emërimit të Adriana Hoxhiq si kryesuese të zyres, deklaroi në media që “duhet të ketë përkrahje dhe përgjegjësi ndaj personit të emëruar sepse ajo megjithatë është banore e veriut të Kosovës, ajo

31 Ministri në largim për Kosovë dhe Metohi, Goran Bogdanović, e vlerësoi si provokim të radhës nga ana e Prishtinës faktin që Qeveria e Kosovës e hapi zyren e saj në pjesën veriore të Mitrovicës dhe emërimin e Adriana Hoxhiq si kryesuese të zyres. “Disa herë ka pasur përpjekje të hapet kjo zyre dhe kjo është në pajtim me Planin e Ahisaarit, mirëpo kjo nuk do të thotë që serbët duhet ta pranojnë këtë zyre,” Bogdanović i tha Radio Televizionit të Serbisë. Bogdanović përkujtoi që disa herë kishte thënë që “ne poshtë (në veri të Kosovës e Metohisë) kemi vetëqeverisjen tonë lokale”. E marr nga uebfaqja e gazetës ditore Blic: <http://www.blic.rs/Vesti/Politika/329218/Imenovanje-sefa-Kancelarije-kosovske-vlade-u-Mitrovici>.

32 <https://www.vesti-online.com/Vesti/Srbija/229964/Branicemo-Severnu-Mitrovicu-zivotima> .

sigurisht do të punoj në përkrahje dhe me përgjegjësi në drejtim të normalizimit të gjendjes”³³.

Duhet të kihet parasysh që Zyra e ekipit të përkohshëm është pothuajse institucioni i vetëm në veri të Kosovës e cila në dy vitet e fundit ka funksionuar suksesshëm brenda kornizës ligjore. Ky mekanizëm që kishte realizuar disa projekte³⁴ u injorua nga udhëheqësit serb në veri. Anëtarët e ekipit gjithmonë kanë qenë nën presion dhe në qendër të ngacmimeve. As Beogradi zyrtar nuk e ka përkrahur këtë trup. Ekipi përgatitor në korrik të vitit 2011 i është drejtuar për ndihmë kryetarit të Serbisë Boris Tadiq duke e lutur atë që t’i “përmbaj” strukturat lokale serbe nga “pengimi i punës së ekipit”³⁵.

Letra drejtuar kryetarit Tadiq më 25 gusht 2011 (pak pas vizitës së kancelarës gjermane Angela Merkel) dëshmon për ekzistencën e alternativës serioze për grupet radikale në veri të Kosovës. Aty thuhet: “Ne kemi ndikim shumë të vogël mbi të ardhmen politike të Mitrovicës veriore, por sinjerisht besojmë që mundësia e zgjedhjes së strukturave udhëheqëse duhet t’i besohet vet banorëve, pa frikësime dhe pa presione dhe sigurisht pa dhunën e politikaneve të cilët gjatë 12 viteve të fundit në masë të madhe kanë përfituar nga gjendja e status kuos në veri të Kosovës”. Tadiqit poashtu iu shpjegua që “ekipi përbëhet nga 12 anëtarë - serbë, boshnjakë dhe shqiptarë”, të cilët janë “të ngopur nga vetëqeverisja lokale, e cila nuk përfaqëson asgjë tjetër përveç keqpërdorim të fondeve qeveritare nga buxheti kosovar dhe buxheti serb, presione dhe kërcënime nga ana e forcave radikale për të siguruar pajtueshmëri dhe për t’i shmangur mospajtimet, pastaj pjesëmarrje të dhunshme në protesta politike nën kërcënimin e largimit nga puna dhe më tepër se një dekadë të dhunës e cila mbetet e pazgjidhur”. Ekipi përgatitor dëshiron të “krijoj alternativë më të drejtë, më demokratike dhe më transparente për strukturat udhëheqëse lokale aktuale” dhe në letër përmend veprimet që ka bërë deri më tani në pjesën veriore të Mitrovicës - parkun e ri të qytetit, asfaltimin e rrugës, ngjarjet kulturore³⁶.

Në tekstin e njejtë³⁷ ku citohet letra që i është dërguar Tadiqit, përfshihet edhe deklarata e Radenko Nedeljković, kryetar i qarkut të Mitrovicës

33 Radio Evropa e Lirë, 21 qershor 2012.

34 Ekipi përgatitor për shembull ka ndërtuar parkun për fëmijë, ka ndarë drunj për ngrohje, ka siguruar projekte për ndihmë sociale, ka dekoruar qytetin për Vitin e Ri, ka siguruar projekte në fushën e kulturës. Ekipi poashtu ka punuar në vendosjen e kontakteve në mes shoqërisë civile nga veriu dhe donatorëve potencial në Kosovë. Ekipi gjatë gjithë kohës ka qenë i hapur ndaj rekomandimeve të banorëve për përmirësimin e infrastrukturës dhe jetës në Mitrovicën veriore.

35 Danas, 29 gusht 2011.

36 Letra, më saktësisht disa pjesë të saj, janë cituar në bazë të tekstit të botuar në Danas, më 29 gusht 2011, nën titullin “Përmbani forcat serbe”.

37 Danas, 29 gusht 2011.

dhe funksioner i Partisë Demokratike, i cili thotë se nuk e ka të qartë për çka shqetësohen dhe ankohen anëtarët e Ekipit përgatitor, “sepse askush nuk i nguc ata”. Nedeljković thotë që “problemi qëndron aty se këta njerëz i morën fondet, duke pohuar që mund ta realizojnë programin e Piter Fejth, por tash kërkojnë alibi meqë nuk e kanë përkrahjen e banorëve”. Me animositet dhe ton të njejtë, Nedeljković si dhe udhëheqësit e tjerë në veri folën për Ekipin përgatitor edhe në vitin 2010³⁸.

Nëpunësit e Ekipit përgatitor u desh të bëjnë përpjekje të mëdha për t’i informuar banorët për projektet e realizuara dhe hap pas hapi pas shumë pengesave të fillojnë ta fitojnë besimin e banorëve. Në këtë drejtim është arritur përparim i dukshëm.

Projektet infrastrukturore që Ekipi përgatitor i propozoi në bazë të kërkesave të vet banorëve i financoi bashkësia ndërkombëtare.

Kundërshtimi ndaj Planit të Ahtisaarit para së gjithash vjen nga udhëheqësit e komunitetit serb në Kosovë si dhe nga Beogradi zyrtar. Sipas hulumtimit të Zyres Civile Ndërkombëtare në veri të Kosovës³⁹, gjatë kohës së barrikadave, 80 përqind e të intervistuarve serbë të Kosovës në këtë rajon nuk e kanë lexuar Planin e Ahtisaarit. Ata informohen për këtë plan vetëm nga mediat e Beogradit⁴⁰, që për pasojë sjell qëndrim tejet negativ ndaj kësaj zgjidhje.

38 Kur u themelua Ekipi përgatitor për Mitrovicën Veriore, udhëheqësit lokal serb që shikojnë kah Beogradi si dhe mediat në Beograd fuqishëm insistuan që t’i diskualifikojnë anëtarët e ekipit. Kryetari i qarkut të Mitrovicës dhe zyrtari i Partisë Demokratike, Radenko Nedeljković, deklaroi për gazetën ditore beogradase Politika (botuar më 2 shkurt 2010) që motivi i anëtarëve të këtij ekipi janë paratë dhe që bëhet fjalë “për serbë me të shkuar kriminale, në mesin e të cilëve më së tepërmi janë nga komuna e Zveqanit, pastaj komuna e Leposaviqit dhe poashtu ka edhe nga pjesa veriore e Mitrovicës”. “Ata janë aty për përdorim afatshkurtër. Edhe nëse ia dalin të realizojnë synimet e bashkësisë ndërkombëtare, në bashkëpunim me të ashtuquajturën qeveri të Kosovës, pas kësaj ata do të jenë të panevojshëm,” Nedeljković tha. Kryetari i Këshillit Kombëtar Serb, Millan Ivanović, foli për administratën e re si për mercenarë duke i akuzuar ata se po i “shërbejnë ekstremistëve shqiptarë dhe Perëndimit dhe se po i tradhëtojnë interesat shtetërore dhe kombëtare”. Në pyetjen e gazetarit të Politikës si e vlerëson faktin që një numër i madh i serbëve ka aplikuar për punë në ekipin që e zbaton Planin e Ahtisaarit, sekretari shtetëror në Ministrinë për Kosovë dhe Metohi, Oliver Ivanović, thotë që ky numër është i “trilluar” për të krijuar përshtypjen e interesimit të madh. “Dhe ky interesim nuk është aq i madh sepse aty janë zgjedhur edhe njerëz nga vende të tjera, që do të thotë se nuk ka pasur mjaft të interesuar nga Mitrovica veriore,” Ivanović tha. Ai pohon që paratë janë motivi i vetëm sepse anëtarët e ekipit paguhën 550 euro në muaj dhe premtimin për realizimin e projekteve infrastrukturore e shohin si rast të mirë për të fituar edhe më tepër para. “Ne nuk ua vëmë veshin, sepse ata nuk kanë fare peshë politike. Ata nuk do t’ia dalin ta bindin askend në komunitetin serb, me kusht që në zgjedhjet e jashtëzakonshme (në fund të prillit apo në maj) të zgjedhim figura kredibile të cilët në mënyrë të denjë mund ta përfaqësojnë komunitetin serb dhe vetëqeverisjen lokale,” thotë sekretari shtetëror. Deklaratat janë cituar nga artikulli i gazetës Politika i datës 16 shkurt 2010.

39 Hulumtimi “Mysafirë në shtëpinë e tyre”: Rekomandim gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit dhe komunitetit serb në veri të Kosovës” u zhvillua nga 30 shtatori deri më 29 dhjetor 2011.

40 Kjo para së gjithash vlen për mbajtjen e shpresës së rrejshme që çdo gjë do të jetë “si dikur”, ose që Beogradi, si garantuesi i vetëm i sigurisë së tyre ekzistenciale, do të merret me zgjidhjen e të gjitha problemeve të tyre. Mediat prodhuan mosbesimin ndaj qeverisë së Kosovës dhe institucioneve të saj.

Mediat serbe flasin shumë pak për Planin e Ahtisaarit dhe përqendrohen në temat e barrikadës dhe fitimin e statusit special për veriun e Kosovës.

Më tepër se 9000 banorë të veriut të Kosovës janë pajisur me dokumente kosovare në Zyren e Mitrovicës Veriore, derisa rreth 400 banorë gjatë nëntorit-dhjetorit 2011 janë pajisur me tabelat kosovare të regjistrimit me shenjën RKS⁴¹. Përfaqësuesit politik të serbëve të Kosovës të cilët nuk e njohin qeverinë e Kosovës, shpesh edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile nga veri i Kosovës, i fshehin këto të dhëna gjatë bisedave me përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare dhe me anëtarë të Komitetit të Helsinkit. Ata shumë negativisht e pranuën afatin për regjistrimin e sërishëm të makinave, duke thënë që nuk dëshirojnë t'i regjistrojnë sërish makinat e tyre dhe se me këtë po iu shkelen të drejtat e njeriut dhe po iu kërcënohet siguria.

Një ndër argumentet kryesore kundër Planit të Ahtisaarit është që nëse zbatohet ky plan një numër i madh i banorëve do të mbesin pa të ardhura. Sipas vlerësimeve të botuara në hulumtimin “Mysafirë në shtëpinë e tyre”, Serbia finanson rreth 20.000 banorë që janë në listën e pagave të strukturave paralele në Kosovë. Në botimin e njejtë thuhet që ka serbë të Kosovës të cilët pohojnë që ky numër është shumë më i madh dhe që e tejkalon 60.000, dhe që ky vlen vetëm për veriun e Kosovës. Plani social për këta nëpusi për nëpunës në të ardhmen mund të paraqes sfidë si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë duke marrë parasysh krizën ekonomike. Ky poashtu nuk është problem vetëm i veriut por edhe i komunave tjera me shumicë serbe.

Me ndërtimin e barrikadave në veri të Kosovës, shumica e rrugëve kanë pësuar dëme serioze. Ura kryesore që e lidh pjesën veriore me atë jugore të qytetit, sipas vlerësimeve të mitrovicasve, është dëmtuar rëndë me ngritjen e barrikadave.

Ndër kundërthëniet më të mëdha është edhe kush e ka financuar ndërtimin e rrugëve alternative dhe materialin për barrikada (beton, drunj, zhavorr). Në mesin e atyre që kanë ndërtuar rrugë përmenden banorët (me punë vullnetare dhe me kontribute në material), kompanitë e afaristëve kontravers si dhe ndërmarrjet publike nga Serbia⁴².

41 Të dhëna nga hulumtimi “Mysafirë në shtëpinë e tyre”.

42 Politika (11 tetor 2011) shkruan se si “makineria e rëndë ndërtimore ditë e natë hap rrugë të reja në veri të Kosovës dhe Metohisë. Përfaqësuesit e serbëve në veri të Kosovës pohojnë që të gjithë punojnë në hapjen e rrugëve, nga nëpunësit e shërbimeve publike komunale, ndërmarrësve privat e deri të qytetarët e thjeshtë ... “Kryetari i komunës së Mitrovicës Veriore, Krstimir Pantiq, i thotë Politikës së po hapen rrugë të reja dhe po riparohen rrugët e vjetra”. Pronarët privat të pompave të benzinës po japin benzinë falas, banorët vullnetarisht i shkelin pyjet, derisa banorët e fshatrave nga kalojnë rrugët po përgatisin ushqim për punëtorët. Në komunën e Zubin Potokut po punohet në rregullimin e rrugëve fshatare dhe malore përtej Mokra Gorës në mënyrë që të arrihet

Kufiri i vërtetë në mes Kosovës dhe Serbisë gjithmonë ka qenë shumë poroz, dhe kontrolli i importit dhe eksportit të mallrave pothuajse nuk ka ekzistuar fare gjë që iu ka mundësuar individëve nga veriu i Kosovës që të pasurohen në tregun gri. Të dyja shtetet, Kosova dhe Serbia, kanë humbur nga pamundësia që të vjelin tatime dhe doganë për mallrat e importuara. Emisioni hulumtues i televizionit B92, Insajder, e ka hapur këtë temë, duke paraqitur që në lajmërim të emisionit një seri të shembujve dhe dëshmime. Megjithatë, edhe pse ky emision u lajmërua në pranverë të vitit 2012, ai kurrë nuk u transmetua në TVB92. Sipas lajmërimit të fundit emisioni do të duhej të transmetohej në shtator. Ka spekulime të ndryshme rreth arsyeve për mostransmetimin dhe shtyerjen e vazhdueshme të emisionit. Udhëheqësit serb nga pjesa veriore dhe ajo qendrore e Kosovës kanë qëndrime të ndryshme ndaj transmetimit të emisionit. Në veri të Kosovës, edhe akterët e moderuar janë kundër transmetimit të emisionit, ndërsa në pjesën qendrore të Kosovës mund të dëgjohen zëra që transmetimi i emisionit do të ishte gjë e mirë sepse do të shihej rrjedha e parave në veri dhe kush është i përfshirë në punë ilegale. Disa struktura dhe individë të caktuar në pushtet në Beograd poashtu kanë interes ta pengojnë transmetimin e emisionit sepse edhe ata kanë hisën e tyre në rrjedhen e të hollave në veri të Kosovës.

Këtu u pa qartë se nuk është vetëm sovraniteti në pyetje, por edhe përfitim të caktuara financiare për disa grupe nga Serbia dhe të ashtuquajturit afaristë kontravers. Serbia ka kohë që nuk e lejon importin e mallrave nga Kosova, derisa mallrat e saj hyjnë të papenguara në Kosovë. Qeveria e Vojislav Koshtunicës, në vitin 2005, e heqi tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) për mallrat që hynin nga Serbia në Kosovë. (këtë udhëzim mbi heqjen e tatimit e nënshkroi nënkryetari i qeverisë dhe zyrtari i G17, Miroljub Labus). Qeveria e Mirko Cvetković e ktheu në fuqi TVSH-në tek në shtator të vitit 2011 në përfundim të mandatit të saj. Sipas të dhënave zyrtare të botuara në lajmërimin

nga Kollashini i Ibrit në Novi Pazar ose deri në Ribariq dhe tutje në Mal të Zi. Kryetari i komunës së Zubin Potokut, Sllavisha Ristiç, thotë që këto rrugë kanë ekzistuar edhe më herët por që nevojitet kohë, para dhe fuqi punëtore për t'i vënë sërish në funksion. "Të gjithë po marrin pjesë në ndërtimin e rrugëve. Rrugët po i hapim me makineritë e komunës". Branko Niniç, kryetar i komunës së Leposaviqit, thotë "u tregua që rrugët e dhive tash po i përdorin të gjithë që punojnë në pjesën qendrore të Serbisë ... po përpiqemi t'i rregullojmë në mënyrë që aty të mund të kalojnë të gjitha makinat".

Megjithatë, zyrtari i lartë i Partisë Përparimtare Serbe, Aleksandar Vuçiq, pohon që "shteti e ka angazhuar kriminelin Branko Miljković i cili pastaj i tërheqi makinat e tij dhe në vend të tij u angazhua makineria e Veselinovićit". Vuçiq thotë që Miljković "bashkëpunon me regjimin në Serbi". Është përmendur edhe që Srbija Sume po merr pjesë në ndërtimin e rrugëve. Zoran Drobnjak, drejtor i Puteva Srbije, thotë që firma Kosmet i mirëmban rreth 115 kilometra rrugë në Kosovë. Kjo ndërmarrje aksionare u angazhua për kryerjen e punëve të financuara nga Putevi Srbije, së bashku me firmën MBA e ndërton rrugën Vraçevo-Batnik, në rrugën alternative drejt Rashkës, Novi Pazar. Drobnjak thotë që për mirëmbajtjen e rrugëve dhe ndërtimin e rrugës alternative prej 12 kilometrave, Putevi Srbije ka ndarë rreth 5 milion euro, Politika, 11 tetor 2011.

e emisionit të Insajder nën titullin “Plaçkitja patriotike” në TVB92, për gjashtë vite e gjysmë në Kosovë janë futur mallra në vlerë prej më shumë se 2 miliard euro. Kjo do të thotë që nga Serbia në Kosovë çdo ditë janë futur mallra në vlerë më shumë se 840.000 euro. Sipas hulumtimeve të Insajder, pjesa dërrmuese e këtyre mallrave nëpërmjet rrugëve alternative është kthyer në Serbi ose është kontrabanduar në pjesën jugore të Kosovës. Për dhjetë vite, sipas hulumtimeve të Insajder, kjo i ka kushtuar banorëve të Serbisë rreth 500.000 euro në ditë. Vladimir Joviq, zëvendës i kryesuesit të ekipit negociator (në qeverinë e kaluar të Serbisë) në bisedime me Prishtinën, ka deklaruar për Politika (www.B92.net) se mospagimi i TVSH-së “në veri të Kosmetit gjatë tri viteve të fundit ka qenë burimi kryesor i pasurimit të individëve”.

Mungesa e sundimit të ligjit dhe e organeve gjyqësore, si dhe aktiviteti i vogël i policisë së Kosovës dhe EULEX-it, në veri të Kosovës i ka hapur dyert për grupet kriminale që merren me vepra të rënda penale siç është tregtia me narkotikë.

Udhëheqësit serb shpeshherë i keqpërdorin arrestimet e banorëve serb në Kosovë, duke e akuzuar policinë e Kosovës për shkelje të ligjit dhe për arrestimin e njerëzve gjoja të pafajshëm. Në mesin e të arrestuarve sigurisht ka edhe persona që nuk kanë kryer vepra penale dhe në këto raste institucionet kosovare duhet ta korrigjojnë këtë padrejtësi. Secili rast megjithatë duhet të trajtohet në mënyrë të veçantë në mënyrë që arrestimi eventual i personave të pafajshëm të mos lidhet me kriminelët dhe të mos keqpërdoren për lirimin e atyre banorëve serb që janë seriozisht të përfshirë në vepra të rënda penale.

Vet banorët e veriut të Kosovës ballafaqohen me shkelje të përditshme të ligjit si dhe me detyrime shtesë për shkak të mungesës së sundimit të ligjit. Shembulli më i mirë për këtë janë tabelat e regjistrimit. Banorët i ndërrojnë tabelat në makinën e njejtë para syve të policisë e cila deri vonë plotësisht e ka toleruar këtë. Disa banorë të Kosovës, për shkak të çmimeve më të lira, blejnë sasi më të mëdha të benzinës në pompat në veri të Mitrovicës, mirëpo kur kalojnë në pjesën jugore duhet të paguajnë dënime të mëdha dhe iu konfiskohet benzina për shkak se bëhet fjalë për mall të patatimuar.

Mungesa e sundimit të ligjit në veri i godet edhe serbët që jetojnë në pjesët tjera të Kosovës, meqë në pjesën veriore të Mitrovicës gjendet edhe Universiteti dhe Qendra Spitalore që përfaqësojnë qendrën kryesore arsimore dhe shëndetësore për serbët e Kosovës. Prandaj është shqetësues fakti që edhe qendra spitalore edhe universiteti janë nën kontrollin e udhëheqësve radikal dhe praktikisht nën detyrimin që të dalin në barrikada⁴³.

43 Bisedë e Komitetit të Helsinkit me banorët e veriut të Kosovës.

Gjatë bisedave me përfaqësues të Komitetit të Helsinkit, banorët nga veriu i Kosovës pohojnë që nëse zbatohet Plani i Ahtisaarit, Qeveria e Kosovës do të ndikoj në planprogramin e universitetit në Mitrovicë. Sipas kornizës ligjore të Kosovës, Universiteti vet e harton statutin me të cilin e rregullon organizimin e brendshëm dhe menaxhimin, procedurat dhe bashkëpunimin me autoritetet publike në komunën kryesore të Mitrovicës Veriore.

Ligji për Arsim në komunat e Republikës së Kosovës ⁴⁴ parasheh që Universiteti në Mitrovicën Veriore të jetë institucion i pavarur publik për arsim të lartë; Universiteti ka të drejtë të përdor tekste shkollore dhe të punoj sipas planprogrameve të Serbisë, mirëpo ato duhet të jenë në përputhje me ligjet e Kosovës. Rreth përputhjes me ligjet e zbatuara, vendos komisioni i Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të Kosovës, dhe në rastin e fundit, komisioni i pavarur. Komisioni i pavarur përbëhet nga tre përfaqësues të zgjedhur nga Ministria e Arsimit, tre përfaqësues të zgjedhur nga Universiteti dhe një përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare. Komisioni vendos me shumicë të votave. Komuna e Mitrovicës Veriore ka autoritet të marr përsipër përgjegjësinë për universitetin në gjuhën serbe, në pajtim me ligjin në fuqi të Republikës së Kosovës. Bordi i universitetit përbëhet nga dy anëtarë të emëruar nga komuna, pesë anëtarë të emëruar nga organet e fakulteteve ose atyre studentore të universitetit, dhe dy anëtarë emërohen në mënyrën që e përcakton statuti i universitetit. Qeveria e Serbisë mund të vazhdoj ta financoj universitetin, dhe kushti i vetëm është që ky financim të jetë transparent dhe në pajtim me ligjet e Kosovës. (shih Shtojcën: Ligji për Arsim në komunat e Republikës së Kosovës).

Në mesin e serbëve që jetojnë në veri të Kosovës janë të rrënjosura thellë stereotipet që pengojnë zbatimin e tij, e këto janë pasojë e raportimeve të njëanshme të mediave në Beograd mbi gjendjen në Kosovë si dhe e propagandës së udhëheqësve radikal nga veriu i Kosovës. Në mesin e stereotipeve janë edhe ato që është e pamundur të zbatohet Plani i Ahtisaarit, që me përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur komuniteti serb në jug të lumit Ibër do t'i humb të drejtat e fituara në ndërkohë, që pranimi i planit do të thotë pranim të pavarësisë së Kosovës, që të gjithë nëpunësit e sektorit publik do të mbesin pa punë, që Serbia më nuk do të guxoj t'iu ndihmoj financiarisht serbëve të Kosovës ...

Këto stereotipe mund të luftohen vetëm nëpërmjet informimit objektiv mbi mekanizmat për mbrojtjen e komunitetit serb në Kosovë dhe për ruajtjen e identitetit të tij. Këtë rrugë e ka ndjekur komuniteti serb në jug të lumit Ibër, edhe pse para disa vitesh ishte skeptik rreth integritetit në shoqërinë kosovare. Rezultatet konkrete dëshmojnë që ai nuk ka gabuar.

44 Ligji nr. 03/L-068.

Shtojcat

Ligji i Arsimit në Komunitet e Republikës së Kosovës

Burimi:

 http://www.masht-gov.net/advCms/documents/09_2008_03_L068_sr.pdf

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-
REPUBLIC OF KOSOVO

Kuvendi - Skupština – Assembly

Kreu V - Arsimimi në gjuhën serbe

Neni 12. Arsimimi në gjuhën serbe

- 1) Komunitetet kanë kompetenca për krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve edukativo-arsimore në gjuhën serbe.
- 2) Shkollat të cilat japin mësim në gjuhën serbe mund të përdorin plan programe apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë pas njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës.

- 3) Plan programet apo tekstet shkollore përkatëse të Republikës së Serbisë nuk do të përdorën për mësimdhënie para njoftimit të MASHT-it; nëse pas këtij njoftimi, MASHT-i brenda tre muajve nuk paraqet ndonjë kundërshtim (në mënyrë që t'i ofrohet kohë e mjaftueshme Ministrisë të shqyrtoj plan programet apo tekstet shkollore në fjalë), ai material mund të përdoret.
- 4) Në rast të paraqitjes së kundërshtimit nga ana e MASHT-it për përdorimin e ndonjë plan programi apo teksti shkollor të caktuar në gjuhën serbe, çështja i dërgohet komisionit të pavarur, i cili themelohet në bazë të nenit 13 të këtij ligji, për të shqyrtuar plan programin apo librin shkollor në fjalë, për të siguruar përputhshmërinë e tij me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi. Plan programi mësimor i caktuar ose teksti shkollor nuk mund të përdoren për mësimdhënie pa vendosur komisioni i pavarur

Neni 13. Komisioni i pavarur

- 1) Komisioni i pavarur për shqyrtimin e materialeve mësimore në gjuhën serbe përbëhet nga shtatë (7) anëtarë:
 - a) tre (3) përfaqësues nga MASHT-i;
 - b) tre (3) përfaqësues të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, të cilët mbajnë ulëse të rezervuara apo garantuara për komunitetin serb të Kosovës, dhe
 - c) një (1) anëtar ndërkombëtar, i zgjedhur nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar dhe përfaqëson atë.
- 2) Të gjitha vendimet e Komisionit merren me shumicë votash.
- 3) Kryesimi i Komisionit bëhet përmes rotacionit në mes përfaqësuesit të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe përfaqësuesit e zgjedhur nga MASHT-i çdo vit.

Neni 14. Kompetencat e zgjeruara të Komunës së Mitrovicës Veriore

Kompetencat e poshtëshënuara janë kompetencat komunale për arsimin e lartë në Mitrovicën Veriore:

a) Universiteti i Mitrovicës Veriore është institucion publik autonom i arsimit të lartë;

b) Universiteti miraton statutin që saktëson organizimin dhe qeverisjen e brendshëm të tij si dhe procedurat dhe ndërveprimin me autoritetet publike, në pajtim me legjislacionin kornizë qendror të Republikës së Kosovës, i cili do të shqyrtohet nga një komision i pavarur;

(i) komisioni i pavarur përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve;

(ii) tre (3) përfaqësues të përzgjedhur nga MASHT-i;

(iii) tre (3) përfaqësues të zgjedhur nga universiteti, dhe

(iv) një (1) anëtar ndërkombëtar, i përzgjedhur nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar i cili edhe e përfaqëson atë.

(v) komisioni i merr vendimet me shumicë votash;

(vi) kryesimi i komisionit bëhet përmes rotacionit në mes të përfaqësuesit të zgjedhur nga Universiteti dhe një përfaqësues i përzgjedhur nga MASHT-i.

c) Vendimet për pajtueshmërinë e statusit me legjislacionin kornizë qendror, standardet dhe praktikat më të mira evropiane si dhe për çështjet që kanë të bëjnë me akreditimin e universitetit brenda sistemit universitar të Kosovës merren nga komisioni i pavarur i themeluar sipas nenit 14b të këtij ligji;

d) Komuna e Mitrovicës Veriore ka kompetencat për këtë universitet publik në gjuhën serbe, në pajtim me ligjin në fuqi të Republikës së Kosovës;

e) Universiteti do të ketë Bordin e përbërë nga nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy të caktohen nga komuna dhe pesë (5) do të zgjidhen nga fakulteti apo nga organi i studentëve të Universitetit dhe dy (2) anëtarë të tjerë do të zgjidhen në mënyrën e përcaktuar në statutin e Universitetit;

f) Komuna gjithashtu do të sigurojë që Universiteti të ketë objekte dhe financim adekuat për veprimtarinë e tij nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe burimet tjera institucionale. Fondet për universitetin nga Republika e Ser-

bisë duhet të jenë transparente dhe të bëhen publike, në pajtim me ligjet e Kosovës;

g) Veprimet dhe burimet buxhetore që i ofrohen Universitetit të Mitrovicës Veriore duhet të jenë në pajtim me ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në legjislacionin që hyn në fuqi deri më 1 janar 2009, dhe

h) Komuna e Mitrovicës Veriore mund të bashkëpunojë me çdo komunë tjetër për drejtimin e universitetit.

Këtë ligj mund ta gjeni në uebfaqen e Gazetës Zyrtare të Kosovës:

 http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=155&Itemid=56&lang=sr

Ligji për Radio Televizionin e Kosovës

Sipas Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës, të miratuar më 29 mars 2011, ky sistem informativ ka dy kanale televizive: RTK në gjuhën shqipe dhe RTK 2 në gjuhën serbe (Neni 8). Të dy kanalet janë të obliguara të ndajnë 15 përqind të skemës programore për transmetimin e programeve në gjuhët e komuniteteve tjera të Kosovës.

Menaxhmenti dhe Bordi i Radio Televizionit të Kosovës duhet ta siguroj funksionimin operacional të RTK 2 (kanalit në gjuhën serbe) më së voni 12 muaj pas miratimit të ligjit (Neni 8, Pika 7).

Çdo vit, RTK do të ndaj 10 përqind nga buxheti i tij për kanalin në gjuhën serbe. Kjo shumë në fillim do të përdoret për sigurimin e hapësirës, mobileve, teknikës dhe pagave të punëtorëve. Kur RTK 2 të bëhet funksional, ligji thotë që këto fonde të përdoren për mbulimin e shpenzimeve të funksionimit të kanalit si dhe për prodhimin e programeve specifike në gjuhën serbe. Ligji thotë që këto fonde mund të përdoren vetëm për qëllime të sigurimit të funksionimit administrativ, teknik dhe editorial të kanalit në gjuhën serbe (neni 21, pika 4).

Bordi drejtues i Radio Televizionit të Kosovës përbëhet nga 11 anëtarë. Të paktën dy anëtarë të Bordit emërohen nga komuniteti serb (neni 25). Anëtarët e Bordit të RTK-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës (neni 26).

Tekstin e plotë të Ligjit mund ta gjeni në uebfaqen e Kuvendit të Kosovës:

Ligji mbi vetëqeverisjen lokale

Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 20 shkurt 2008, dhe u shpall me dekretin e miratuar nga Presidenti i Kosovës më 15 qershor 2008.

Me këtë ligj, komunat e Mitrovicës Veriore, Graçanicës dhe Shtërpces fituan përgjegjësi të shtuara në fushën e kujdesit sekondar shëndetësor. Këto komuna janë të autorizuar të sigurojnë kujdes sekondar shëndetësor, përfshirë këtu regjistrimin dhe licensimin e institucioneve shëndetësore, punësimin e punëtorëve të shëndetësisë, pagimin e pagave dhe trajnimin e punëtorëve të shëndetësisë dhe të nëpunësve në administratë (neni 20).

Komuna e Mitrovicës Veriore fitoi përgjegjësi të shtuara në fushën e arsimit të lartë. Komuna është e autorizuar të ofroj arsim të lartë, përfshirë këtu regjistrimin dhe licensimin e institucioneve arsimore, nëpunësimin e kuadrove mësimdhënësve, pagimin e pagave dhe trajnimin e kuadrove mësimdhënësve dhe atyre administrative (neni 21).

Të gjitha komunat e banuara me shumicë serbe janë autorizuar të merren me çështje në fushën e kulturës, përfshirë këtu mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe dhe tjetër në territorin e komunës, si dhe përkrahjen e komuniteteve lokale fetare në pajtim me ligjin në fuqi (neni 22).

Të gjitha komunat e banuara me shumicë serbe kanë përgjegjësi të shtuara në fushën e të drejtave të pjesëmarrjes në përzgjedhjen e komandantit të policisë në pajtim me ligjin mbi policinë (neni 23).

Ligji parasheh që partneritetet në mes komunave të Republikës së Kosovës duhet të kenë të drejtë në raporte të drejtpërdrejta me institucionet e Republikës së Serbisë vetëm në shkallën e nevojshme për realizimin e aktiviteteve praktike të partneritetit (neni 30, pika 7).

Anëtarët e kuvendeve komunale dhe përfaqësuesit e komuniteteve do të jenë anëtarë të komisionit për komunitete. Çdo komunitet që jeton në komunë do të përfaqësohet së paku me një përfaqësues në komisionin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve do të përbëjnë shumicën në komisio-

nin për komunitete. Komisioni për komunitete është përgjegjës për sigurimin e respektimit të drejtave nga autoritetet komunale dhe trajtimin e rregullave, praktikave dhe aktiviteteve komunale për t'u siguruar që të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen në tërësi dhe t'i rekomandoj kuvendit komunal masa të cilat i konsideron si të nevojshme për sigurimin e zbatimit të të drejtave për nevojat e komunitetit për promovimin, realizimin, ruajtjen dhe zhvillimin e identiteteve të tyre etnike, kulturore dhe fetare, si dhe për sigurimin e mbrojtjes adekuate të të drejtave të komuniteteve në komunë.

Në ato komuna ku të paktën 10 përqind e popullsisë i takon komuniteteve që nuk janë shumicë në këto komuna, ulësja e kryesuesit të kuvendit komunal për komunitete do të jetë e rezervuar për përfaqësuesit e këtyre komuniteteve. Ulësja e zëvendës kryesuesit të kuvendit komunal për komunitete do t'i takoj kandidatit të komunitetit joshumicë i cili ka fituar më së shumti vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje të kuvendit komunal.

Zëvendës kryesuesi i kuvendit komunal për komunitete do të promovoj dialog në mes komuniteteve dhe do të shërbej si lidhje zyrtare për trajtimin e problemeve dhe interesave të komuniteteve pakicë në seancat dhe në punën e kuvendit komunal. Zëvendës kryesuesi i kuvendit komunal për komunitete është përgjegjës për trajtimin e kërkesave të komuniteteve apo anëtarëve të tyre që procedurat apo vendimet e kuvendit komunal i shkelin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Zëvendës kryesuesi i kuvendit komunal për komunitete ia përcjell këto çështje kuvendit komunal për rishikim të procedurave apo vendimeve. Në rast se kuvendi komunal vendos të mos i rishikoj proceset apo vendimet e veta apo nëse zëvendës kryesuesi i kuvendit komunal për komunitete mendon që rezultat i rishikimit përsëri përbën shkelje të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ai mund t'ia përcjell këto çështje drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese e cila pastaj vendos nëse do ta pranoj rastin për rishikim (neni 53, 54 dhe 55).

Tekstin e plotë të Ligjit mund ta gjeni në uebfaqen e Kuvendit të Kosovës: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_sr.pdf

Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura

Neni 1. Qëllimi i Ligjit

Ky ligj do të sigurojë mbrojtjen e Manastireve Ortodokse Serbe, Kishave, vendeve të tjera fetare, si dhe vendeve historike dhe kulturore të një rëndësie të veçantë për Komunitetin Serb si dhe për komunitetet e tjera në Republikën e Kosovës, nëpërmjet themelimit të Zonave të Veçanta të Mbrojtura.

Neni 2. Zonat e Veçanta të Mbrojtura

“Zonë e Veçantë e Mbrojtur” do të jetë një zonë e përcaktuar me hartë, ose me një zonë të përcaktuar që rrethon një monument, ndërtesë, grup ndërtësash, tërësi, fshat, ose qendër historikë të qytetit që mbrohet nga çdo zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtoj kontekstin e tij historik, kulturor, arkitektural apo arkeologjik, mjedisin natyror apo kuadrin vizual estetik.

Neni 3. Objektivat

Objektivat e Zonave të Veçanta të Mbrojtura janë:

- a) të sigurojnë ekzistencën dhe funksionimin paqësor të vendeve që do të mbrohen dhe të ruajnë mënyrën monastike të jetesës së klerikëve;
- b) të ruajnë karakterin dhe pamjen e vendeve që do të mbrohen, në veçanti, kontekstin historik, kulturor, arkitektural dhe arkeologjik, mjedisin natyror dhe kuadrin vizuel estetik, dhe
- c) të parandalojnë zhvillimet e pafavorshme rreth vendeve që duhet të mbrohen, ndërkohë që sigurojnë kushtet më të mira të mundshme për zhvillimin e harmonizuar dhe të qëndrueshëm të komuniteteve që banojnë në zonat rreth këtyre vendeve duke rregulluar zhvillimin dhe aktivitetet e tjera.

Neni 4. Këshilli Zbatues dhe Monitorues

Këshilli Zbatues dhe Monitorues (më poshtë i përmendur si “KZM”) do të themelohet, ndër të tjera, për të monitoruar dhe lehtësuar implementimin e këtij ligji. Detyrat relevante të KZM-së sipas këtij Ligji do të përfshijnë:

- a) mbikëqyrjen e vijëzimit të Zonave të Veçanta të Mbrojtura në terren dhe implementimin e tyre;
- b) rekomandimin e ndryshimeve të kufijve administrativë të Zonave të Veçanta të Mbrojtura, dhe kufizimet që do të aplikohen në to, nëse ashtu e kërkojnë rrethanat;
- c) ndërmjetësimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes Kishës Ortodokse Serbe dhe autoriteteve qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës për sa i përket implementimit të dispozitave të këtij ligji, dhe
- d) këshillimin e agjencive të zbatimit të ligjit dhe institucioneve tjera relevante të Republikës së Kosovës mbi çështjet e lidhura me sigurinë që kanë ndikim mbi vendet e trashëgimisë fetare dhe kulturore.

Neni 5. Aktivitetet e Ndaluara brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura

Çdo aktivitet i ri në fushat e mëposhtme do të ndalohet:

- a) ndërtiet apo zhvillimet industriale, të tilla si eksplorimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale dhe ndërtimi i digave, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave dhe fabrikave dhe rrugëve tranzite në zonat rurale, dhe
- b) ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit.

Neni 6. Aktivitetet e Kufizuara brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura

Çdo aktivitet i ri nga lista e mëposhtme e aktiviteteve mund të kufizohet nëse e kërkojnë rrethanat. Para se të kryhen aktivitete të tilla në fushat e mëposhtme, komuna përkatëse do të kërkojë marrëveshjen e Kishës Ortodokse Serbe. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje, palët do t’ia referojnë çështjen KZM-së për shqyrtim, në pajtueshmëri me pikën c të nenit 4 të këtij ligji:

a) ndërtimet apo zhvillimet komerciale të tilla si: strukturat ose godinat më të larta se manastiri/kisha/monumenti kulturor që duhet të mbrohet; ndërtimi i rrugëve; ndërtimi i magazinave, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafeterive, hoteleve/moteleve, tezgave dhe kioskave ushqimore, stacioneve të furnizimit me karburant dhe riparimit të automjeteve, supermarketeve, klubeve të natës, apo ndonjë ndërtimi tjetër në shkallë më të gjerë në zonat rurale;

b) tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike, dhe

c) urbanizimi i tokës bujqësore.

Neni 7. Klasifikimi i Zonave të Veçanta të Mbrojtura

7.1 Zonat e Veçanta të Mbrojtura do të definojnë për vendet e mëposhtme, si në hartat e bashkangjitura:

a) Manastiri i Deçanit, Deçan: (Kjo Zonë e Veçantë e Mbrojtur është identike me “Zonën e Posaçme” të krijuar më herët);

b) Patriarkana e Pejës, Pejë;

c) Manastiri i Graçanicës, Prishtinë;

d) Kisha e Shpalljes së Virgjëreshës, Lipjan;

e) Manastiri i Devičit, Skënderaj;

f) Manastiri i Gorioçit, Istog;

g) Manastiri i Budisavcit, Klinë;

h) Manastiri i Sokolicës, Zveçan;

i) Manastiri i Draganacit, Gjiilan;

j) Manastiri i Arkangjelit të Shenjtë, Prizren;

k) Manastiri i Banjskës, Zveçan;

l) Manastiri i Zoqishtës, Zoqishtë, Rahovec;

m) Fshati Hoqë e Madhe, Hoqë e Madhe, Rahovec;

n) Manastiri Duboki Potok, Zubin Potok;

o) Kisha e Shën Gjergjit, Gornjasellë, Prizren;

- p) Manastiri i Soçanicës, Leposaviq;
- q) Kisha e Heremitëve, Uljaricë, Klinë; dhe
- r) Vetmia e Petrit të Shenjtë, Korishë, Prizren.

7.2 Zona e Veçantë e Mbrojtur për Manastirin e Sokolicës, Zveçan dhe Kompleksi Memorial i Isa Boletinit janë Zona të Veçanta të Mbrojtura si në hartën e bashkangjitur. Komuna përkatëse do të kërkojë marrëveshje nga Kisha Ortodokse Serbe dhe Administrata e Muzeut të Isa Boletinit për çdo aktivitet të ri ashtu si parashikohet nga neni 6 i këtij ligji.

7.3 Për Zonat e mëposhtme të Veçanta të Mbrojtura të përkufizuara në hartat e bashkangjitura në rastin e ndonjë aktiviteti të ri të përshkruar në nenin 6 të këtij ligji, komuna përkatëse do të konsultohet drejtpërsëdrejti me KZM-në:

- a) Monumenti Memorial i Gazimestanit dhe Tyrbja e Bajraktarëve, Obiliq do të përfshihen në të njëjtën Zonë të Veçantë të Mbrojtur;
- b) Kështjella Mesjetare e Zveçanit, Zveçan;
- c) Qyteti Mesjetar i Novobërdës, Novobërdë; dhe
- d) Ura Mesjetare/e Vjetër e Vojnoviqëve, Vushtrri.

7.4 Zonat e Veçanta të Mbrojtura për vendet e cekura më poshtë do të kufizohen me një hapësirë prej 100 metrash rreth perimetrit të tyre dhe do të identifikohen nga Agjensioni Kadastral i Republikës së Kosovës në bashkëpunim me komunat përkatëse në hartat që do t'i bashkangjiten këtij ligji të cilat do të formojnë një pjesë integrale të këtij ligji dhe do të miratohen para përfundimit të periudhës së tranzicionit:

- a) Manastiri i Premtit të Shenjtë, Leposaviq;
- b) Manastiri i Shëruesve të Shenjtë, Leposaviq;
- c) Manastiri i Virgjërëshës së Shenjtë të Hvosnos, Istog;
- d) Manastiri i Markut të Shenjtë, Korishë, Prizren;
- e) Manastiri i Treshit të Shenjtë, Mushtisht, Suharekë;
- f) Kisha e Virgjërëshës së Shenjtë, Sredskë, Prizren;
- g) Manastiri i Uroshit të Shenjtë, Nerodime, Ferizaj; dhe
- h) Manastiri i Binaçit, Buzovik, Viti.

7.5 Zonat e Veçanta të Mbrojtura për vendet e cekura më poshtë do të kufizohen me një hapësirë prej 50 metrash rreth perimetrit të tyre dhe do të identifikohen nga Agjensioni Kadastral i Republikës së Kosovës në bashkëpunim me komunat përkatëse në hartat që do t'i bashkëngjiten këtij Ligji, të cilat do të formojnë një pjesë integrale të këtij ligji dhe do të miratohen para përfundimit të periudhës së tranzicionit:

- a) Manastiri i Dollcit, Klinë;
- b) Kisha e Shën Nikollës, Gjurakoc, Istog;
- c) Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë në Hodegetri, Mushtisht, Suharekë;
- d) Kisha e Nikollës së Shenjtë, Shtërpce;
- e) Kisha e Teodorit të Shenjtë, Biti e Poshtme, Shtërpce;
- f) Kisha e Nikollës së Shenjtë, Gotovushë, Shtërpce;
- g) Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë, Gotovushë, Shtërpce;
- h) Kisha e Shën Gjergjit, Biti e Epërme, Shtërpce;
- i) Kisha e Nikollës së Shenjtë, Mushnikovë, Prizren;
- j) Kisha e Nikollës së Shenjtë, Bogoshevc, Prizren;
- k) Kisha e Nikollës së Shenjtë, Drajciq, Prizren;
- l) Kisha e Nikollës së Shenjtë, Sredskë, Prizren;
- m) Kisha e Apostujve të Shenjtë (ose Premtit të Shenjtë), Mushnikovë, Prizren, dhe
- n) Kisha e Shën Gjergjit, Sredskë, Prizren.

Neni 8. Themelimi i Zonës së Veçantë të Mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit

8.1 Zona e Veçantë e Mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit do të themelohet nga organet komunale të Prizrenit në bashkëpunim me KZM dhe do të përfshijë objektet e Kishës Ortodokse, objektet otomane, katolike, laike dhe objektet e tjera të rëndësishme të veçantë historike dhe kulturore. Objektet e mëposhtme kulturore dhe fetare serbe do të përfshihen në Zonën e Veçantë të Mbrojtur: Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë të Levishës; lagja e vjetër “Mëhalla Marash”; Kisha e Shpëtimtarit të Shenjtë; Shkolla Ortodokse për Priftërinj e Kirilit dhe Metodit të Shenjtë; dhe Kompleksi i Rezidencës Epis-

kopike (që përfshin rezidencën e Peshkopit, Katedralin e Gjergjit të Shenjtë, Kishat e Gjergjit të Shenjtë (Runovic) dhe Nikollës së Shenjtë (Tutic).

8.2 Aplikimi i nenit 6 të këtij ligji për çdo aktivitet të ri në Zonën e Veçantë të Mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit do të përcaktohet me një ligj.

Neni 9. Dispozitat e Veçanta për Fshatin Hoqa e Madhe

9.1 Fshati i Hoqës së Madhe, i përshkruar në pikën m) paragrafi 1 i nenit 7 të këtij ligji do të ketë të drejtën, në konsultim me komunën e Rahovecit, që të ushtroj autoritet të kufizuar mbi aktivitetet nga fusha e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe fetare, dhe nga fusha e planifikimit rural duke respektuar Zonën e saj të Veçantë të Mbrojtur, në përputhje me dispozitat relevante të legjislacionit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe parimet e Deklaratës Universale të UNESCO-së mbi Diversitetin Kulturor. KZM-ja do të lehtësojë konsultime të tilla.

9.2 Aplikimi i nenit 6 të këtij ligji për çdo aktivitet të ri në Zonën e Veçantë të Mbrojtur për fshatin e Hoqës së Madhe do të përcaktohet me një ligj.

Neni 10. Planifikimi Hapësinor

10.1 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të sigurojë që planet hapësinore për sipërfaqet brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura të jenë në pajtueshmëri me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të këtij ligji dhe në pajtueshmëri me nenet 12, 13, 14 të Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor.

10.2 Autoritetet lokale do t'i përmbahen plotësisht dispozitave të nenit 10.1

Neni 11. Dispozitat Përfundimtare

11.1 Ky Ligj do të zëvendësojë çdo dispozitë të ligjeve në fuqi që nuk është në pajtueshmëri me të. Zonat e Veçanta të Mbrojtura gjithashtu gëzojnë plotësisht mbrojtjen e përcaktuar nga Ligji mbi Trashëgiminë kulturore dhe ndryshimet e tij të mëtutjeshme.

11.2 KZM bashkëpunon me Këshillin e Republikës së Kosovës për Trashëgimi Kulturor, ashtu si parashikohet në paragrafin 8 të nenit 4 të ligjit mbi Trashëgiminë Kulturor mbi çdo çështje tjetër që ka lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore në Republikën e Kosovës.

11.3 KZM do të punojë për së afërmi me Komisionin e Implementimit të Rindërtimit për Vendet Fetare Ortodokse në Republikën e Kosovës.

11.4 Dispozitat e këtij Ligji në asnjë mënyrë nuk do të paragjykojnë apo ndryshojnë ndonjë detyrim ekzistues të ndërmarrë në lidhje me ndonjë vend të përcaktuar nën Konventën e UNESCO-s që ka të bëjë me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturor dhe Natyrore Botërore.

11.5 Dispozitat e këtij Ligji nuk do të paragjykojnë të drejtat e pronësisë mbi pronat e ndodhura brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura.

Neni 12. Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji nr. 03/L-039

20 shkurt 2008

Burimi: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&iid=146&Itemid=56&lang=bh

Plani i Ahtisaarit dhe të drejtat që burojnë nga ai

Botimi "Njihu me të drejtat e tua në Kosovë - Plani i Ahtisaarit i shpjeguar më thjeshtë" nga Zyra Civile Ndërkombëtare në Kosovë.

Arsimimi në gjuhën serbe

Plani përcakton se komuniteti serb ka të drejtë në shkollim publik në gjuhë serbe në të gjitha nivelet (përfshirë edhe universitetin autonom në gjuhën serbe në Mitrovicë) dhe që në ato shkolla të përdorin planprogramet dhe tek-

stet shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë. Në mënyrë specifike, pjesëtarët e komunitetit serb mund:

- Të pranojnë arsimim publik parashkollor, primar dhe sekondar në gjuhën e tyre, deri në masën e parashikuar me legjislacion, ku pragu për themelimin e paraleleve apo shkollave të veçanta për këtë qëllim do të jetë më i ulët se ai që zakonisht parashihen për institucionet arsimore;

- Themelojnë dhe menaxhojnë institucionet private të arsimit dhe trajnimit për të cilat mund të jepet ndihma financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare

- Në shtator 2011 janë aprovuar zyrtarisht planprogramet në gjuhën serbe për shkollat fillore dhe të mesme si dhe materialet mësimore.

Dhe sa i përket Universitetit të Mitrovicës

- Universiteti do të miratojë statutin që do të saktësojë organizimin dhe qeverisjen e brendshëm të tij si dhe procedurat dhe ndërveprimin me autoritetet publike – kryesisht në komunën e Mitrovicës Veriore.

Gjuha dhe identiteti serb

Plani thekson se komuniteti serb ka të drejtë të shpreh, mbajë dhe zhvillojë kulturën e vet dhe të ruajë elementet thelbësore të identitetit të tyre, d.m.th, fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën. Ai jo vetëm që e përkufizon gjuhën serbe si një prej gjuhëve zyrtare, por edhe përcakton se çka nënkupton kjo në jetën publike dhe private. Për shembull, ai u mundëson serbisht folësve:

- Të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre lirisht në jetën private dhe publike;

- Të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre në marrëdhëniet e tyre me autoritetet komunale ose zyrat lokale të autoriteteve qendrore në zonat ku ata përbëjnë një përqindje të mjaftueshme të popullsisë. Shpenzimet e shkaktuara për shkak të përdorimit të përkthyesve ose interpretëve do të mbulohen nga autoritetet kompetente.

- Të përdorin dhe shfaqin simbolet e komunitetit serb në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;

- Të kenë emra personale të regjistruar në formën e tyre origjinale dhe me shkronja në gjuhën e tyre si dhe kthimin e emrave origjinal të cilët janë ndryshuar me forcë.

- Të kenë emra lokale, emra të rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë të cilët pasqyrojnë dhe janë të ndjeshëm ndaj karakterit shumetnik dhe shumë-gjuhësor të zonës në fjalë;

- Qasje të garantuar në, dhe përfaqësim të veçantë në mediat e transmetimit publik si dhe në programet në gjuhën e tyre, në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;

- Të drejtën për të krijuar dhe përdorur mediat e tyre, përfshirë edhe ofrimin e informatave në gjuhën e tyre dhe përdorimin e numrave të rezervuar të frekuencave për mediat elektronike, në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;

- Të kenë kontakte të papenguara mes vete brenda Kosovës dhe të krijojnë dhe mbajnë kontakte të lira dhe të qeta me njerëzit në cilindo shtet, veçanërisht me ata me të cilët ndajnë të njëjtin identitet etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar, ose trashëgimi të përbashkët kulturore, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;

- Të kenë kontakte të papenguara dhe të marrin pjesë pa diskriminim në aktivitetet e organizatave joqeveritare lokale, rajonale dhe ndërkombëtare;

- Të themelojnë asociacione të kulturës, artit, shkencës dhe arsimit si dhe asociacione shkollore dhe të tjera për të shprehur, kultivuar dhe zhvilluar identitetin e tyre.

Dhe, të gjitha komunat në të cilat komuniteti serb do të jetë shumicë, kanë:

- Autoritetin që të ushtrojnë përgjegjësinë për çështje kulturore, përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore serbe dhe trashëgimisë tjetër fetare dhe kulturore brenda territorit të komunës si dhe mbështetjen për komunitetet fetare lokale.

Trashëgimia fetare dhe kulturore

Plani i ofron Kishës një pozitë të veçantë dhe të mbrojtur në Kosovë – përfshirë edhe garancitë për pronën e Kishës dhe për mënyrën e jetës së murgjve, murgeshave dhe priftërinjve. Përveç kësaj, 45 lokaliteteve me rëndësi fetare ose kulturore për komunitetin serb u është dhënë statusi i Zonave të Veçanta të Mbrojtura. Kisha në Kosovë po ashtu është e lirë për të marrë donacione nga Serbia – në mënyrë transparente.

Në mënyrë specifike:

- Kosova do t'i ofrojë Kishës Ortodokse Serbe privilegje doganore dhe tatimore, krahas atyre privilegjeve të cilat i gëzojnë të gjitha fetë në Kosovës, për aktivitetet ekonomike të Kishës që janë specifike për vetë-qëndrueshmërinë financiare, siç janë, të qëndisurat dhe veshjet fetare, qirinjtë, pikturimi i ikonave, punimet e drurit dhe zdrukthëtarisë, verërat, konjak, mjalti dhe produktet tjera të bletës. Këto privilegje do të përfshijnë, importimin dhe blerjen e produkteve relevante, materialeve, makinerisë dhe veglave; dhe eksportimin e produkteve të cilat rezultojnë nga aktivitetet e lartpërmendura.

- Janë krijuar Zona Mbrojtëse për 45 monumente, duke përfshirë: Manastirin Visoki Deçani, Patrikanën e Pejës, Manastirin e Graçanicës, Kisha e Shpalljes së Virgjërshës, Lipjan, Manastiri i Deviçit, Manastiri i Gorioçit, Manastiri i Budisavcit, Manastiri i Sokolicës, Manastiri i Draganacit, Manastiri i Arkangjelit të Shenjtë, Manastiri i Banjskës, Manastiri i Zoçishtës, Fshati Hoqë e Madhe, Manastiri Duboki Potok, Kisha e Shën Gjergjit, Gornjasellë, Manastiri i Soçanicës, Kisha e Hermitëve, Uljaricë, Monumenti memorial i Gazimestanit, Kështjella Mesjetare e Zveçanit, Qyteti Mesjetar i Novobërdës, Ura Mesjetare e Vojnoviqëve, Vetmia e Petrit të Shenjtë, Korishë.

- Në Zonat e Posaçme të Mbrojtura ndalohen disa aktivitete të caktuara të reja – për shembull, ndërtimet ose zhvillimet industriale, siç janë: shfrytëzimi i resurseve minerale, ndërtimi i centraleve për prodhimin e energjisë ose rrjetit të energjisë elektrike, furrave dhe fabrikave, ndërtimet ose zhvillimet që shkaktojnë shpyllëzimin ose ndotjen e mjedisit.

Për çdo aktivitet tjetër të ri zhvillimor (të kategorizuar si aktivitete të kufizuar) në Zonat e Posaçme të Mbrojtura, para se të ndërmerren këto aktivitete komuna përkatëse duhet të konsultohet me Kishën Ortodokse Serbe. Për shembull, duhet mbrojtur strukturat ose godinat më të gjata se manastiri

/ kisha / monumenti nën mbrojtje; përdorimi i materialeve të rrezikshme në çdo ndërtim të ri (duke përfshirë objektet banesore): rrugë tranzite, pompa të benzinës dhe qendra të riparimit të automjeteve; supermarket; klube nate.

E drejta për të mbajtur dhe zhvilluar lidhje me Serbinë

Plani ofron mundësinë për lidhje me Serbinë, si në aspektin e financimit të komunave ashtu edhe në lidhjet politike me komunat e Serbisë. I vetmi kusht ka të bëjë me atë se Kosova duhet të informohet dhe financimi duhet të jetë transparent. Çdo financim nga Serbia do të jetë si shtesë e financimit nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe nuk do t'i nënshtrohet tatimit. Plus, njerëzit prapë mund të vazhdojnë të mbajnë pensionet e tyre të Serbisë.

- Komunat do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë, brenda kompetencave të tyre, me komunat dhe institucionet, përfshirë agjencitë qeveritare, të Republikës së Serbisë.

- Komunat do të njoftojnë Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal të Kosovës paraprakisht për çfarëdo qëllimi për t'u angazhuar në një bashkëpunim të tillë. Njoftimi do të përfshijë draft marrëveshjen ndërmjet komunës dhe institucionit të propozuar partner të Serbisë. Draft marrëveshja e bashkëpunimit do të përkufizojë fushat e bashkëpunimit të paraparë, ofrimin e stafit dhe pajisjeve, nivelin e financimit dhe mekanizmat e vet përpunues dhe aranzhimet tjera relevante procedurale në pajtim me kërkesat e menaxhimit të financave publike që janë të zbatueshme për të gjitha komunat.

- Qëllimi i tillë për të bashkëpunuar dhe draft marrëveshja e cila e shqëron atë mund t'i nënshtrohen shqyrtimit nga Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal të Kosovës për pajtueshmërinë e saj me legjislacionin kornizë qendror. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 6.1 të këtij Aneksi, Ministria në përputhje me shqyrtimin e tillë mund të urdhërojë ndryshimet në draft marrëveshjen e bashkëpunimit apo nëse shkelja e rëndë e ligjit nuk mund të trajtohet me mjete juridike ndryshe, Ministria mund të pezullojë bashkëpunimin e synuar. Komuna mundet të sfidojë veprimin e tillë të Ministrisë në gjykatën e qarkut kompetente për territorin e komunës. Partneritetet ndërmjet komunave të Kosovës do të kenë të drejtë për marrëdhënie të drejtpërdrejta me institucionet e Republikës së Serbisë vetëm deri në masën e nevojshme për zbatimin praktik të aktiviteteve të partneritetit.

- Çdo donacion financiar për komunat e Kosovës nga Republika e Serbisë do të jetë i kufizuar në qëllimin e vet në ushtrimin e përgjegjësisë të komunës në fushat e kompetencave të tyre vetanake dhe do të jetë transparent dhe do të publikohet duke i raportuar këto donacione së bashku me shpenzimet gjegjëse në buxhetet e tyre komunale.

- Bazuar në parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, komunat do të kenë të drejtë të formojnë dhe marrin pjesë në asociacionet e komunave të Kosovës për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të tyre të përbashkëta.

Puna policore dhe komandantët lokalë të policisë

Përbërja etnike e policisë në komunë, për aq sa është e mundur, do të pasqyrojë përbërjen etnike të popullsisë së asaj komune. Kjo do të thotë se në zonat me shumicë serbe, shumica e policëve do të jenë pjesëtarë të komunitetit serb. Pastaj, komandantët e stacioneve lokale do të zgjidhen nga komuna me shumicë serbe. Ndonëse me planin e Ahtisarit parashihet zinxhiri i unifikuar komandues për shërbimin policor në tërë Kosovën, kufijtë e rretheve të stacioneve policore janë të njëjtë me kufijtë administrativë të komunave, me këshilla të veçanta lokale (të kryesuar nga kryetari i komunës) për të diskutuar me komunitetin për çështjet që kanë të bëjnë me punën e policisë. Detajet janë si vijon:

- Këshillat e përbërë nga përfaqësuesit komunal dhe të policisë duke përfshirë edhe komandantët e stacioneve do të bëhen plotësisht funksional në mënyrë që të lehtësojnë bashkëpunimin në mes të Shërbimit Policor dhe autoriteteve komunale / udhëheqësve lokal të komunitetit. Këshillat udhëhiqen nga Kryetarët e Komunave

- Komandantët e Stacioneve Lokale informohen paraprakisht për operacionet nga forcat policore qendrore apo speciale brenda perimetrit të stacioneve policore locale përveç nëse kërkesat operacionale kërkojnë ndryshe.

- Në komunat me shumicë serbe në Kosovë, komandantët e stacioneve lokale zgjedhen sipas procedurës në vijim: Kuvendi Komunal propozon së paku dy emra për komandant stacioni të cilët i përmbushin kërkesat minimale të profesionit ashtu siç është paraparë në legjislacionin e Kosovës. Ministria e Punëve të Brendshme mund të emëroj një kandidat nga kjo listë brenda 15 ditëve të pranimit të listës. Në rast se asnjëri nga kandidatët nuk pranohen

nga ministria, Kuvendi Komunal do të sigurojë listën e dytë me së paku dy kandidatë të ndryshëm për shqyrtim nga ministria, të cilët janë nga radhët ekzistuese të Shërbimit Policor të Kosovës dhe të cilët përmbushin të gjitha kërkesat minimale të profesionit ashtu siç kërkohet nga legjislacioni i Kosovës. Ministria pastaj obligohet që të emëroj një kandidat nga lista e dytë brenda 15 ditëve të pranimit saj.

Pjesëmarrja e komunitetit serb në vendimmarrje

Në zgjedhje, do ketë ulëse të garantuara në Kuvend për komunitetin serb, kështu që zëri i komunitetit serb gjithmonë do të dëgjohet. Dispozitat e hollësishme janë si vijon/ versioni i shkurtër:

- Komuniteti serb i Kosovës do të ketë një numër të përgjithshëm të ulëseve të fituara përmes zgjedhjeve, dhe së paku 10 ulëse të garantuara nëse numri i ulëseve të fituara është më i vogël se 10).

Janë edhe një numër ligjesh që nuk mund të ndryshohen pa pajtimin e shumicës së anëtarëve serbë. Këto ligje janë:

- Ligjet për ndryshimin e kufijve administrativë të komunave, për krijimin ose heqjen e komunave, për përcaktimin e kompetencave të komunave dhe për pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe ndërkufitare; Ligjet për zbatimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre; Ligjet për përdorimin e gjuhëve; Ligjet për zgjedhjet lokale; Ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; Ligjet për lirinë fetare dhe për marrëveshjet me komunitetet fetare; Ligjet për arsimin; Ligjet për përdorimin e simboleve dhe për festat publike.

Plani i Ahtisarit po ashtu parasheh krijimin e komunave të reja me popullsi shumicë serbe. Kjo mundëson që zëri i komunitetit serb të dëgjohet më shumë lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me nevojat dhe me administratën e tyre lokale. Pesë prej këtyre komunave tashmë janë themeluar (Graçanica, Ranillugu, Klllokoti, Novobërda dhe Parteshi) dhe katër prej tyre kanë kryetar serb. Po ashtu është propozuar edhe krijimi i komunës së re të Mitrovicës Veriore. Këto komuna të reja kanë më shumë autonomi se sa komunat e tjera, në fushat si arsimi dhe shëndetësia, dhe në çështjet e tyre financiare. Plus, ngjashëm me komunat e tjera të Kosovës ato:

- kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për çështjet me interes lokal,

duke respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi në këto fusha (më tej në theks këtyre ju referohemi si kompetenca vetanake të tyre):

- a. Zhvillim ekonomik lokal
- b. Planifikim urban dhe rural
- c. Shfrytëzim dhe zhvillim të tokës
- d. Zbatimi i rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve të kontrollit të objekteve
- e. Mbrojtja e mjedisit lokal
- f. Ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugët lokale, transporti lokal dhe skemat lokale të ngrohjes
- g. Reagimi në emergjencat lokale
- h. Ofrimi i shkollimit para-fillor, fillor dhe të mesëm, përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, punësimin, dhënien e pagave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve
- i. Ofrimi i kujdesit primar shëndetësor
- j. Ofrimi i shërbimeve për familje dhe shërbimeve të tjera sociale, siç është përkujdesja njerëzit në gjendje të vështirë, kujdestaria për fëmijët, përkujdesja për fëmijët, përkujdesja për të moshuarit, përfshirë edhe regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave të përkujdesjes, punësimin, dhënien e pagave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale
- k. Banimi kolektiv
- l. Shëndetësia publike
- m. Licencimi i shërbimeve dhe objekteve lokale, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore dhe të kohës së lirë, ushqimin, fjetjen, tregjet, shitësit lokalë, transportin publik dhe taksitë

n. Emërtimi i rrugëve dhe hapësirave të tjera publike

o. Ofrimi dhe mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike

p. Turizmi

q. Aktivitetet kulturore dhe të kohës së lirë

r. Çdo çështje e cila nuk përjashtohet në mënyrë ekskluzive nga kompetenca e tyre ose që nuk i është përcaktuar ndonjë autoritetit tjetër

Përveç kësaj, disa kompetenca të caktuara u janë deleguar komunave me shumicë serbe edhe në fushën e:

1. Shënimeve kadastrale

2. Regjistrave civilë

3. Regjistrimit e votuesve

4. Regjistrimit dhe licencimit të bizneseve

5. Shpërndarjes së pagesave të asistencës sociale (duke përjashtuar pensionet)

6. Mbrojtjes së pyjeve

Për më tepër, Plani i Ahtisarit garanton që pjesëtarët e komunitetit serb do të kenë qasje edhe në punësimin e sektorit publik:

- Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe në ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë në mënyrë të veçantë në shërbimin policor në zonat e banuara nga komuniteti përkatës, duke respektuar në të njëjtën kohë rregullat lidhur me kompetencat dhe integritetin që rregullon administratën publike.

Të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit

- Të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit nga Kosova kanë të drejtë të kthehen në vendin e tyre dhe të rimarrin pronën dhe gjërat e tjera personale në posedim bazuar në vendimet vullnetare dhe të informuara mirë – në një vend që ata e zgjedhin, jo vetëm në vendbanimin e tyre të mëparshëm.

Sistemi i drejtësisë

Gjyqësori në Kosovë qeveriset nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Ai është plotësisht shumetnik dhe i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij për të siguruar një sistem të integruar, të pavarur, profesional dhe të paanshëm të drejtësisë. Ai ofron garanci se sistemi i drejtësisë në Kosovë të jetë gjithëpërfshirës dhe të pasqyrojë në tërësi natyrën shumetnike të Kosovës dhe që komunitet serb të jetë i përfaqësuar. prandaj:

- Gjykata Supreme siguron zbatimin e njëtrajtshëm të ligjit duke vendosur mbi ankesat e paraqitura në pajtim me ligjin. Së paku pesëmbëdhjetë për qind (15%) të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por në asnjë rast më pak se tre (3) gjyqtarë, do të jenë nga komunitetet joshumicë në Kosovë. E njëjta vlen edhe për Gjykatat e Qarkut, ku i vetmi dallim është se kërkohet që së paku 2 gjyqtarë të jenë nga komunitetet joshumicë. Për përmbushjen e përgjegjësisë të veta në këtë drejtim, KGJK, mes tjerash, në mesin e kandidatëve me kualifikime të barabarta për funksionin e gjyqtarit dhe prokurorit, do t'i jep përparësi pjesëtarëve të komuniteteve të nënpërfaqësuar. Dhe, në komunat me shumicë serbe, vetëm kandidatët serbë të caktuar nga anëtarët serbë të emëruar në KGJK mund të caktohen si gjyqtarë në gjykatat themelore. Vetëm nëse nuk shfrytëzohet kjo mundësi, atëherë KGJK-ja në përbërje të plotë do të vendos për ato pozita.

Personat e zhdukur

- Kosova dhe Serbia, në pajtim me normat dhe standardet vendore dhe ndërkombëtare do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të përcaktuar dhe ofruar informata lidhur me identitetin, vendndodhjen dhe fatin e personave të zhdukur, në bashkëpunim të plotë me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) dhe partnerët e tjerë të rëndësishëm ndërkombëtarë.

Marrëveshjet Beograd - Prishtinë

➔ Marr nga uebfaqja e Qeverisë së Serbisë: <http://www.srbija.gov.rs/kosovo-metohija/?id=164576>

Vulat doganore

Palët do të bëjnë çdo gjë për të siguruar lirinë e lëvizjes së mallrave në përputhje me marrëveshjen e CEFTA-së;

Do të pranohet vula doganore, me mbishkrimin 'Kosovo Customs' / "Doganat e Kosovës", siç është e konfirmuar për të gjitha vendet anëtare të CEFTA-së;

Dokumentacioni dhe komunikimi përcjellës poashtu do ta pasqyrojnë këtë përdorim;

Regjistri i kadastrave

Për mbrojtjen e të drejtave të personave me kërkesa legjitime pronësore, palët do të bëjnë përpjekje të përbashkëta për themelimin e kadastrit plotësisht të besueshëm në Kosovë;

Grupi zbatues trepalësh, i përbërë nga ekspertët e kadastrit nga të dy palët dhe me kryesimin e BE-së, do të mbikëqyr punën e agjencionit teknik (të cilin do ta për zgjedh BE-ja pas konsultimeve me të dyja palët), roli i të cilit do të jetë verifikimi i mangësive në regjistrin origjinal të kadastrit nga viti 1999;

Përfaqësuesi special i BE-së do të marr kopje të regjistrave origjinale të kadastrit nga periudha para vitit 1999, të larguara nga Kosova. Sipas kërkesës, përfaqësuesi special i BE-së do të ofroj informata konkrete nga Kosova;

Agjencioni teknik, i përmendur në pikën 2, do të krahasoj të gjitha kopjet origjinale të regjistrit të kadastrit të pronave private⁴⁵ të periudhës para vitit 1999, me kadastrin e rikonstruuar të Kosovës. Ato raste të cilat dëshmojnë se nuk janë identike, grupi zbatues trepalësh do t'i bart tek autoriteti përgjegjës

⁴⁵ Kjo do të përfshijë evidencën kadastrale të pronave private, pronave private komerciale dhe pronave private të kishës.

në Kosovë. Ky mekanizëm do të vendos përfundimisht se cili shënim kadastral është i saktë.

Shkallën e parë të mekanizmit për vendime gjyqësore do të shpall Komisioni i përbërë nga ekspertët ndërkombëtar dhe kosovar për kadastrë dhe pronë. Shumicën e ekspertëve do t'i emëroj përfaqësuesi special i BE-së, duke i marr parasysh interesat e të gjitha komuniteteve të interesuara;

Paneli ndërkombëtar i gjykatësve në Gjykatën Supreme të Kosovës do të veproj si shkallë e dytë e apelit për këtë mekanizëm. Vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës i merr këshilli gjyqësor ku gjykatësit ndërkombëtar do ta përbëjnë shumicën, këto vendime do të jenë finale dhe nuk do të jenë subjekt i apelit;

Mbi vendimet e mekanizmit të lartpërmendur do të informohen të gjitha palët e interesuara. Agjensioni Kadastral i Kosovës do t'i merr vendimet finale para mekanizmit të lartpërmendur për marrjen e vendimeve gjyqësore ashtu që do t'i realizoj ndryshimet e nevojshme në kadastrin e Kosovës;

Grupi zbatues do të mbikëqyr realizimin dhe funksionimin e shpejtë të aranzhimit të lartpërmendur dhe në baza të rregullta do t'i raportoj procesit të Dialogut mbi përparimin e arritur.

Konkluzionet e arritura për Menaxhimin e Integruar të Kufijve⁴⁶

Në pajtim me Marrëveshjen e Lisbonës dhe legjislacionin relevant të BE-së⁴⁷, dhe duke marr parasysh që të dyja palët janë pjesë e Agjendës së BE-së për Ballkanin Perëndimor, palët do të duhet gradualisht ta harmonizojnë legjislacionin e tyre me ligjet e BE-së, dhe posaçërisht ta zbatojnë konceptin e MIK-së.

Në interes të realizimit më të shpejtë dhe efikas, palët nën udhëzimet e përgjithshme të BE-së do ta zbatojnë konceptin e MIK-së.

Palët synojnë që gradualisht të zbatojnë pika të përbashkëta të integruara në të gjitha vendkalimet e përbashkëta MIK. Ky bashkëpunim do ta ndjek praktikën më të mirë evropiane sipas udhëzimit të vazhdueshëm të Komisionit

46 Kjo do të përfshijë evidencën kadasatrale të pronave private, pronave private komerciale dhe pronave private të kishës.

47 Siç përcaktohet në mënyrë specifike me ligjin e Shengenit mbi kufijtë, Frontex rregullores, rregullorja mbi transportin ndërkufitar, rregulloren VIS dhe ligjin e komunitarë mbi viza.

Evropian. Prioriteti më i lartë do të jetë puna, projektet do të identifikohen dhe zbatohen bashkërisht në momentin që kjo të jetë e mundur në praktike. Pikat e përbashkëta, të integruara, të veçanta dhe të sigurta do të gjenden në kufijtë e vendkalimeve të përbashkëta MIK, ku zyrtarët e të dyja palëve do t'i zbatojnë kontrollet respektive. Në veçanti dhe vetëm në zonat e përbashkëta MIK, palët nuk do të shfaqin simbolet e juridiksioneve të tyre.

Aranzimet përfshijnë prezencë të balancuar, në pajtim me kërkesat, të organeve relevante të të dyja palëve, siç janë dogana, policia, etj, dhe do të përfshijnë çështje siç janë lokacioni i kalimit, natyra e objekteve, orari i punës, etj. Në pajtim me dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij⁴⁸, në vendkalimet Jarinjë/Rudnicë dhe Bërnja, kjo prezencë do të përfshijë edhe zyrtarët e EULEX. EULEX-i poashtu do të jetë prezent edhe në vendkalimet në Konçull, Merdarë, Mutivodë dhe Muçibabë.

Në bazë të aranzhimeve do të qartësohet edhe detyra e bartjes së përgjegjësi dhe obligimeve ligjore në juridiksionet e secilës palë.

Do të themelohet grupi zbatues trepalësh me kryesim të BE-së për zbatimin e aranzhimit të lartpërmendur sa më shpejt që kjo të jetë e mundur në praktike. Në këtë drejtim, do të hartohet dhe nënshkruhet Protokoli Teknik, sipas nevojës ndaras nga BE-ja, i cili do të marrë parasysh mendimet e ndryshme të palëve rreth çështjes së statusit. Implikimet e këtyre konkluzioneve do të merren parasysh gjatë zbatimit të lirisë së lëvizjes.

Kjo marrëveshje nuk përfshin asnjë çështje të përgjithshme apo të veçantë doganore apo fiskale.

Librat Amzë

1. Të gjitha palët do të bëjnë përpjekje të përbashkëta për themelimin e regjistrimit plotësisht të besueshëm civil në Kosovë;

2. Do të themelohet 'Komisioni i përbashkët' trepalësh, që do të përfshijë nga një ekspert në fushën e regjistrimit civil të secilës palë dhe një ekspert të EULEX-it, me ç'rast ky i fundit do të jetë kryesues, me qëllim të verifikimit të mangësive në regjistrat civil nga periudha para vitit 1999;

3. EULEX-i do të vërtetojë kopjet origjinale të të regjistrave civil nga Kosova, nëpër komuna, sipas nevojës në konsultim me ekspertët e të dyja

⁴⁸ Siç është definuar Këshilli për Veprime të Përbashkëta 2008/124 CEFSP, neni 3, seksioni a.

palëve. EULEX-i do të përpunoj kopjet e vërtetuara me qëllim të themelimit të regjistrimit plotësisht të besueshëm civil në Kosovë.

4. Sipas kërkesës, EULEX-i do të jetë i gatshëm të ofroj informata konkrete nga Kosova.

Liria e lëvizjes

1. Banorët e të dyja palëve duhet të jenë në gjendje të lëvizin lirshëm brenda ose nëpër territorin e palës tjetër;

2. Secila palë do të zbatoj, sa më shpejt që kjo të jetë e mundur në aspektin operacional, sistemin e letërnjoftimeve për udhëtimin tejkuftar/tejadministrativ të banorëve të palës tjetër;

3. Secila palë mund të zbatoj sistemin sipas të cilit letërnjoftimet do të përcjellen me dokumente të shkruara 'hyrje/dalje'⁴⁹ për banorët e palës tjetër të cilët dëshirojnë të kalojnë tranzit në një vend të tretë;

4. Si zgjidhje e përkohshme, secila palë do t'iu mundësoj banorëve të palës tjetër blerjen e sigurimit kufitar/administrativ. Nën udhëheqjen e Bashkimit Evropian, palët do të vazhdojnë të punojnë në arritjen e aranzhimit komercial për mbulimin e dyanshëm të sigurimit të automjeteve, në mënyrë që të mbulohen të gjitha automjetet në të dyja anët e kufirit/vijës administrative sa më parë që të jetë e mundur;

5. Secila palë do të marr të gjitha masat e nevojshme për t'iu mundësuar banorëve të palës tjetër të udhëtojnë lirshëm brenda ose nëpër territorin e palës tjetër duke përdorur lejet e vozitjes të lëshuara nga autoritetet e tyre;

6. Si masë e përkohshme, autoritetet në Kosovë do ta shtyjnë fillimisht për pesë vite afatin e tabelave të regjistrimit KS, dhe pas kësaj periudhe palët përsëri do ta shqyrtojnë këtë çështje (me ndërmjetësimin e BE-së nëse është e nevojshme);

7. Të gjithë pronarët e automjeteve me vendbanim në Kosovë do të përdorin tabelat e regjistrimit RKS ose KS (në pajtim me pikën 6). Tabelat e regjistrimit do t'i lëshojnë autoritetet përgjegjëse në Kosovë, dhe do të shpërndahen me ndërmjetësimin e EULEX-it aty ku është e nevojshme. Secila palë do të bëjë përpjekje maksimale për të siguruar zbatimin e pikës.

⁴⁹ Të gjitha dokumentet hyrje/dalje do të përmbajnë gjuhë neutrale.

8. Si masë e përkohshme, autoritetet në Beograd do t'iu mundësojnë automjeteve nga Kosova me tabela të regjistrimit KS të udhëtojnë lirshëm në ose nëpër territorin e saj;

9. Si masë e përkohshme, sipas kërkesës së pronarëve të automjeteve, do të lëshohen tabela të përkohshme të regjistrimit në vendkalimet kufitare/administrative relevante;

10. Sa i përket riatdhesimit, dhe marr parasysh detyrimet e Prishtinës në këtë fushë, aranzhimet e lartpërmendura nuk do të krijojnë detyrime shtesë për Beogradin që të pranojë kërkesat për riatdhesim të personave me dokumente kosovare në kontekstin e marrëveshjeve ekzistuese për riatdhesim në mes Beogradit dhe BE-së;

11. Grupi zbatues nën kryesimin e BE-së do të themelohet deri në mes të qershorit dhe të fillojë përgatitjet për sigurimin e zbatimit të aranzhimeve të lartpërmendura dhe të gjitha punimeve të nevojshme shtesë sa më shpejt të jetë e mundur në aspektin operacional, derisa aranzhimi nën pikën 7 do të zbatohet nga 1 nëntori 2011.

Pranimi i diplomave universitare

1. Mbi bazën e konkluzioneve operationale të arritura më 2 korrik 2011 për pranimin e diplomave universitare, palët janë pajtuar të kërkojnë nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane të vërtetojnë diplomat e lëshuara nga universitetet e secilës palë në mënyrë që pala tjetër të mund t'i përdor ato për vazhdimin e arsimimit dhe/ose për punësim në sektorin publik.

2. Pas vërtetimit që diplomat universitare e lëshuara nga institucionet përgjegjëse të palëve janë në pajtim me praktikën më të mirë evropiane, certifikimin do ta bëjë Komiteti i ekspertëve akademik evropian i themeluar nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane.

3. Shtesat e diplomave dhe certifikatat nga dosjet studentore, sipas formatit të dorëzuar gjatë procesit të dialogut, i janë ofruar këtyre konkluzioneve dhe do t'i bashkangjiten diplomave universitare. Organet e secilës palë do të vendosin cilat dokumente janë valide për këtë proces, me kusht që rezultati i pranimit të kualifikimit është arritur në bazë të diplomës.

4. BE-ja do të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar zbatimin e konkluzioneve të lartpërmendura duke filluar më 1 janar 2012.

Mitrovica



Peisazhi i Mitrovicës



Kënd lojrash i rinovuar nga skuadra përgatitore e Mitrovicës Veriore



Barrikadat në urën mbi lumin Ibër

Gorazhdeci



Qendra e fshatit



*Shefi i Zyrës për Komunitetet në Gorazhdec,
Slobodan Petrović*



Shkolla filllore



Shkolla



Shkolla-brenda



Shkolla - palestra

Graçanicë



Qendra e Graçanicës



Laboratori



Shkolla nëntë vjeçare

Novobërd



Hyrja në ndërtesën e komunës së Novobërdës



Poster dygjuhësh në ndërtesën e komunës



*Kryetari i Novo Bërdës Bajrush Imeri (djathtas)
dhe Zëvendës Kryetari Radovan Denić*



Klllokoti



Vendndodhja aktuale e komunës së Klllokotit



Rezorti me ujëra termale në Klllokot



Ndërtimi i komunës së Klllokotit



Rezorti me ujëra termale i Klllokotit

Parteshi



Pamje nga ndërtesa e komunës së Parteshit



Shkollë në Partesh



Komuna e Parteshit



Spitali i ri në Partesh

Rahoveci



Vreshtat e Hoçës së Madhe



Lagje e banuar nga serbë



*Shefi i Zyrës së Komuniteteve në Rahovec,
Slaviša Kolašinac*



Pamje të brendshme nga qendra kulturore

Ranilluga



Pamje të brendshme të qendrës kulturore ku të rinjtë po bëjnë prova

Peja



Në afërsi të Patriarkanës së Pejës



Patriarkana e Pejës



Kabineti i drejtorit të gjimnazit

Shtërcë



Zëvendës Kryetari i Komunës paralele të Shtërcës, Slavisha Staletović



Zëvendës drejtori i gjimnazit në Shtërcë, Živko Šarkočević

